

SONDAZHI I DREJTUAR NGA OSBE PËR DHUNËN NDAJ GRAVE NË MAQEDONINË E VERIUT

MIRËQENIA DHE SIGURIA E GRAVE

**MAQEDONIA E
VERIUT**
RAPORTI I REZULTATEVE





This project is funded
by the European Union



www.osce.org

ISBN 978-3-903128-22-4

Aktiviteti i përshkruar në këtë raport u realizua në përputhje me standardet ndërkombëtare për cilësinë e sondazhit të tregut, ISO 20252:2012, si dhe me kushtet e Ipsos MORI, të cilat mund të gjenden në <http://www.ipsos-mori.com/terms>.

© OSBE 2019

OSBE me përkushtim maksimal u angazhua në hartimin e materialeve të këtij publikimi. Megjithatë, nuk pranon kurrfarë përgjegjësie për saktësinë dhe tërësinë e informacioneve, udhëzimeve dhe këshillave që ofrohen, ose për gabimet e shtypit. Pikëpamjet, opinionet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e prezantuara këtu janë të autorëve dhe të bashkëpunëtorëve dhe jo domosdoshmërisht e pasqyrojnë politikën zyrtare ose qëndrimin e OSBE-së dhe vendeve-pjesëmarrëse të saj.

Të gjitha fotografitë e përdorura në këtë botim janë publikisht të disponueshme.

SONDAZHI I DREJTUAR NGA OSBE PËR DHUNËN NDAJ GRAVE NË MAQEDONINË E VERIUT

MIRËQENIA DHE SIGURIA E GRAVE

MAQEDONIA E
VERIUT
RAPORTI I REZULTATEVE



Organization for Security and
Co-operation in Europe

Sfondi

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), si organizatë më e madhe rajonale e sigurisë në botë, trajton një spektër të gjerë të sfidave që kanë të bëjnë me sigurinë, duke e përfshirë këtu edhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe avancimin e barazisë gjinore. Organizata fokusohet kryesisht mbi promovimin e bashkëpunimit rajonal të sigurisë, si dhe mbi parandalimin e konflikteve, menaxhimin e krizave dhe menaxhimin pas konfliktit. OSBE ka 57 vende-anëtare dhe mbulon një rajon i cili shtrihet në mbarë Evropën dhe i përfshinë SHBA-në, Kanadanë dhe Azinë Qendrore, si dhe Mongolinë. Përmes Sekretariatit, tre institucioneve të specializuara dhe 16 operacioneve në terren, OSBE punon në zgjidhjen e shumë sfidave të sigurisë dhe u ndihmon vendeve pjesëmarrëse në zbatimin e angazhimeve të tyre gjithëpërfshirëse politike.

OSBE e njeh dhunën ndaj grave dhe vajzave (DHNGV¹ si kërcënim ndaj individëve dhe si një problem më të gjerë të sigurisë dhe së këtejmi parandalimi dhe lufta kundër SHNGV është njëri nga prioritetet e saj. DHNGV nënkupton shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut që e kërcënon sigurinë dhe mbrojtjen e grave dhe vajzave në mbarë botën. Kjo prek jo vetëm jetën e tyre, por e pengon edhe pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në shoqëri, madje ndikon edhe mbi jetën e të afërmeve të tyre; dhe përfundimisht ka ndikim të përhershëm mbi shëndetin dhe mirëqenien e tyre dhe të fëmijëve të tyre, mbi komunitetet dhe shoqërinë në përgjithësi.

Pabarazia gjinore përbën bazën e dhunës gjinore ndaj grave dhe vajzave. OSBE luan një rol kyç duke punuar me palët e interesuara nacionale në ndërtimin e kapaciteteve të tyre për parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtjen e viktimave.² Me sloganin “Për një shtëpi të sigurt”, OSBE thekson se gratë dhe vajzat duhet të jenë të sigurta edhe në shtëpi edhe jashtë saj, në mënyrë që ta arrijnë potencialin e tyre të plotë dhe të kontribuojnë në zhvillimin politik, ekonomik dhe social.

Dhuna ndaj grave dhe vajzave, veç tjerash, ndodh edhe në kohë konflikti, ndërsa OSBE e porositi këtë sondazh cilësor dhe sasior me qëllim që të hedhë dritë mbi shtrirjen e formave të ndryshme të DHNGV në zonat pa konflikt dhe të konfliktit në vendet e përzgjedhura anëtare të OSBE: Shqipëria, Bosnja e Hercegovinë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Moldavia dhe Ukraina. Sondazhi u realizua edhe në Kosovë.³

Ky studim, sondazh i parë reprezentativë i këtij lloji i zbatuar në Evropën Juglindore ose Evropën Lindore që synon të siguroj të dhëna krahasuese nga i gjithë rajoni, përfshin pikëpamjet dhe përvojat gjinore të grave nga grupet minoritare.⁴ Ai synon të ofroj të dhëna të forta në mënyrë që të hartohen politika, strategji, programe dhe aktivitete gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në prova për parandalimin dhe luftën kundër DHNG. Qëllimi i fundit i këtij studimi është të ofroj prova në favor të vendimmarrjes dhe avokimit të informuar në nivele të ndryshme dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në arritjen e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe reduktimin e DHNG në rajonet e synuara, shërbime më të mira për viktimat dhe siguri më të madhe për gratë.

- 1 Nacionet “dhuna ndaj grave” (DHNG) dhe “dhuna ndaj grave dhe vajzave” (DHNGV), të cilat përdoren në mënyrë të alternuar në këtë raport, e përfshijnë dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike nga ana e partnerëve intim dhe jo-partnerëve, si dhe ndjekjen dhe ngacmimin seksual.
- 2 Në këtë raport nocionet “e mbijetuar” dhe “viktimë” përdoren me alternativim.
- 3 Çdo përmendje e Kosovës, pa marrë parasysh se a ka të bëjë me territorin, institucionet ose popullsinë, në këtë tekst duhet të kuptohet në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë dhe Kombeve të Bashkuara.
- 4 Pyetësori i cili u përdor në këtë sondazh bazohet dhe krahasohet me pyetësorin të cilin e përdorte Agjencia Evropiane për të Drejtat Fundamentale (FRA) në 28 vende-anëtare të BE-së në vitin 2012.



Rezime ekzekutive

Hyrje

Ky Raport i paraqet gjetjet e studimit cilësor dhe sasior të OSBE-së në Maqedoninë e Veriut. Sondazhi u realizua në pranverën/verën e vitit 2018 dhe përbëhet nga:

- 15 intervista me ekspertë kryesorë, të cilët ofruan një pasqyrë të çështjeve që kanë të bëjnë me DHNG dhe akte të dhunës në kontekst të konfliktit,
- anketë për raste të dhunës tek mostra reprezentative prej 1.910 gra në moshë prej 18 deri 74 vjeçare, prej të cilave 496 e plotësuan anketën në gjuhën shqipe. Anketa përdorte model shumëfazësh, të shtresëzuar të mostrës me probabilitet të zgjedhjes rastësore,
- tetë fokus grupe me gra nga mjedise të ndryshme demografike (dy me gra shqiptare dhe dy me gra romë) për pikëpamjet e tyre rreth temës,
- katër intervista të thelluara me gra të cilat kanë përjetuar dhunë, në mënyrë që të kuptohet në detaje ndikimi i dhunës ndaj tyre (duke përfshirë një shqiptare dhe një romë).

Gjetjet kryesore

Dhuna ndaj grave konsiderohet si një fenomen mjaft i përhapur në vend. Tri nga pesë gra (60%) ishin të mendimit se dhuna ndaj grave është e zakonshme, ndërsa përafërsisht tri nga dhjetë gra ishin të mendimit se kjo është një dukuri *mjaft* e shpeshtë. Përafërsisht një nga pesë gra (17%) personalisht njohin dikë në familjen e tyre dhe shoqë të tyre të cilat kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës në familje, ndërsa kemi një përqindje të ngjashme të personave nga fqinjët e tyre të cilët kanë përjetuar dhunë. Pak më shumë se gjysma e grave (54%) kohë më parë kanë parë ose dëgjuar për fushata promovuese që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave, ndërsa shumica e tyre mendojnë se deri diku janë të informuara se si duhet të veprojnë nëse gjenden në situatë të tillë (63%). Megjithatë, një numër i vogël janë të njoftuara me shërbimet e specializuara për mbështetje që i ofrojnë organizatat joqeveritare. Pikëpamjet dhe ndërgjegjësimi ndryshojnë midis grupeve kryesore etnike në vend. Vetëm mbi dy nga pesë prej grave të anketuara të cilat flasin shqip, mendojnë se DHNG është dukuri e shpeshtë (42%), ndërsa ky grup është akoma më pak i njoftuar me organizatat joqeveritare të cilat ofrojnë mbështetje.

Katërbëdhjetë për qind e grave deklaruan se kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale që nga moshën 15 vjeçare nga ana e partnerit ose jo-partnerit (7% e grave që flasin shqip, kundrejt 16% e grave që flasin maqedonisht). Dhuna psikologjike e ushtruar nga partneri intim është dukshëm më e shpeshtë, me ç'rast 44% e grave u përgjigjën se e kanë përjetuar atë (43% e grave të cilat e kanë plotësuar anketën në gjuhën shqipe). Tri nga dhjetë gra (30%) deklaruan se janë ngacmuar seksualisht që në moshën 15 vjeçare, ndërsa një nga dhjetë (10) thanë se janë abuzuar seksualisht në 12 muajt para sondazhit (9% dhe 4%, e grave të cilat flasin në gjuhën shqipe). Shtatë për qind e grave thanë se janë ndjekur fshehurazi (4% e grave që flasin në gjuhën shqipe).

Ndonëse, shtrirja e konstatuar e dhunës në familje është në nivel të konsiderueshëm më e ulët sesa në gjithë BE, duhet të merret parasysh se trefish më shumë gra në Maqedoninë e Veriut janë të mendimit se dhuna në familje është çështje private që duhet të mbetet brenda familjes, në krahasim me gratë në BE, dhe sondazhi cilësor i realizuar për qëllimet e këtij Raporti tregoi se disa gra janë të mendimit se ndonjë dhunë "më e vogël" është sjellje normale. Këto pikëpamje ishin më të theksuara tek gratë që flasin në gjuhën shqipe, prej të cilave thuaja se shtatë nga dhjetë gra (67%) ishin të mendimit se dhuna në familje është çështje private. Ky dallim e ofron kontekstin plotësues kur shqyrtohen shkallët më të ulëta të dhunës midis grave të cilat flasin në gjuhën shqipe.

Gratë më të reja, si dhe ato që janë më të arsimuara dhe ato që jetojnë në mjedise urbane, janë më të ekspozuara ndaj ngacmimeve seksuale. Megjithatë, prevalenca më e madhe tek këto grupe të grave, po ashtu flet për tolerancën më të vogël të këtyre grave ndaj ngacmimit seksual e me këtë edhe gatishmërinë më të madhe që të flasin për përvojat e tyre.

Tek gratë të cilat jetojnë në familje me vështirësi financiare ekziston prevalencë më e madhe e dhunës, dhe veçanërisht të dhunës fizike dhe seksuale nga partneri intim (17% e atyre të cilat mendojnë se është shumë vështirë që me të ardhurat e tyre t'ia dalin në krye, përkundrajt 9% mesatarisht).

Sa u përket autorëve të dhunës, dhunën fizike dhe/ose seksuale më së shpeshti e ushtron partneri i mëparshëm: 12% e grave të cilat paraprakisht kanë pasur partner janë përgjigjur se kanë përjetuar një ose më shumë forma të kësaj natyre të dhunës, në krahasim me 7% të atyre të cilat thanë se janë viktimat të dhunës nga partneri aktual. Shtatë për qind e grave deklaruan se kanë përjetuar dhunë nga jo-partneri që në moshën 15 vjeçare.

Viktimat e dhunës fizike ose seksuale nga partneri ose jo-partneri, shpeshherë ndihen të mërzitura, të frikësuar dhe të zemëruara, dhe secilën ndjenjë e shprehën më shumë se gjysma e grave të prekura, ndërsa përafërsisht një e katërta e grave të anketuara kanë vuajtur nga vështirësitë me gjumin, me depresionin dhe ndjenjën e brishtësisë si rezultat i incidentit më serioz të dhunës që iu ka ndodhur.

Ekziston një minoritet i konsiderueshëm i cili e respekton qëndrimin tradicional të rolit të grave në shoqëri dhe në familje. Rreth një e treta e grave (37%) ishin të mendimit se miqtë e tyre do të pajtohen me atë se një grua e mirë i bindet burrit të saj edhe nëse ajo vetë nuk është dakord, ndërsa një përqindje e ngjashme (32%) mendojnë se është e rëndësishme që një burrë t'i tregojë partneres së tij se kush udhëheq.

Tri nga dhjetë gra (30%) u pajtuan se gratë që thonë se janë abuzuar, shpesh i sajojnë apo i ekzagjerojnë pretendimet për abuzim apo përdhunim. Kjo bindje është më shumë e përhapur në mjediset rurale.

Ka mundësi që këto bindje tradicionale të ndikojnë mbi probabilitetin që gratë të tregojnë se kanë përjetuar dhunë.

Megjithatë, me sa duket, këto pikëpamje tradicionale gradualisht ndryshojnë, me ç'rast gratë më të reja kanë shumë më pak gjasa që të kenë bindje patriarkale. Ato madje janë shumë më pak të pranishme tek gratë me arsim më të lartë dhe tek ato gra që jetojnë në mjedise urbane.

Vetëm dy përqind e grave të cilat kanë përjetuar dhunë nga partneri i tyre aktual e kanë denoncuar në polici atë që ato e konsiderojnë si incidenti më serioz

Një e katërta e grave të anketuara kanë jetuar në situatë të konfliktit të armatosur aktiv, prej të cilave pjesa më e madhe e kanë përjetuar konfliktin në vitin 2001. Pak më shumë se një nga dhjetë gra të cilat flasin maqedonisht (11%) dhe më shumë se dy nga pesë gra që flasin shqip (42%) në këtë sondazh u klasifikuan si “të prekura nga konflikti”. Gjatë konfliktit gratë më së shpeshti kanë qenë të prekura nga mungesa e qasjes në shërbime, veçanërisht mungesa e zbatimit të ligjit dhe qasjes në shërbimet shëndetësore. Ndërsa, gratë të cilat e kanë përjetuar konfliktin dhe vet ato kanë qenë viktime të dhunës, këtë përvojë nuk e ndërlidhin me konfliktin, dhuna nga partneri i mëparshëm është më e madhe tek gratë e prekura nga konflikti në të gjitha format e dhunës (fizike, seksuale dhe psikologjike) dhe veçanërisht dhunës seksuale. Ngjashëm me këtë, dhuna psikologjike e ushtruar nga partneri aktual është më e pranishme tek gratë e prekura nga konflikti.

Ndërsa pjesa më e madhe e grave janë përgjigjur se shumë pak dinë se çka duhet të bëjnë në rast të dhunës, në realitet janë të vogla gjasat se gratë viktime të dhunës do të tregojnë ose do ta denoncojnë incidentin në polici ose në organizatë tjetër për mbështetje. Vetëm 2% e grave, të cilat kanë pasur përvojë të kësaj natyre, në të vërtetë e kanë denoncuar në polici atë që ato e kanë konsideruar si incident më serioz. Denoncimi varion varësisht nga kategoria e autorit, me ç'rast gratë që kanë përjetuar dhunë nga personi i cili nuk është partner i tyre ose nga partneri i mëparshëm, ka shumë gjasa se do ta denoncojnë në polici ose në spital incidentin më serioz që u ka ndodhur, në krahasim me gratë që kanë përjetuar dhunë nga partneri aktual. Përderisa një numër i vogël i grave të cilat flasin në gjuhën shqipe, që raportuan se kanë përjetuar dhunë nuk mundëson një krahasim relevant statistikor, sondazhi sasior vë në dukje se gratë, të cilat flasin shqip, ka shumë pak gjasa se do të kërkojnë ndihmë nga institucioni ose organizata për mbështetje (policia ose ndonjë organizatë tjetër) sesa gratë të cilat flasin maqedonisht.

Nuk befason fakti që gratë rrallëherë u drejtohen organizatave lokale për mbështetje të viktimeve, duke e marrë parasysh shkallën e ulët të denoncimit dhe informimin përgjithësisht të pamjaftueshëm të grave për këto organizata.

Në përputhje me besimin e përhapur në masë të konsiderueshme midis grave, se dhuna në familje duhet të zgjidhet brenda familjes, gratë të cilat nuk i denoncojnë përvojat e tyre në polici, janë përgjigjur se incidenti ka qenë problem familjar: ato më shumë kanë dashur të përballen vet me situatën ose me ndonjë shoqe/mikeshë apo anëtarë të familjes. Gjetjet cilësore vënë në dukje se ekzistojnë shkaqe të ndryshme për një gjë të këtillë, duke e përfshirë edhe mungesën e besimit tek institucionet, ndjenjën e turp-it ose frikës nga reperkusionet. Edhe përkrah dallimeve të qëndrimeve midis grave më të reja dhe të moshuara, tek gratë e reja nuk ka shumë gjasa se do t'i denoncojnë rastet e dhunës në polici, qoft nga jo-partneri ose nga partneri. Pas incidentit të dhunës, gratë kanë pasur më së shumti nevojë për dikë me të cilin do të mund të bisedonin dhe i cili do mund t'u ofronte mbështetje morale.

Konkluzione

Sondazhi çon drejt këtyre konkluzioneve dhe rekomandimeve (për më shumë detaje shih: Kapitullin 7)

Dhuna ndaj grave është gjerësisht e pranuar si normale dhe e njëjta nuk denoncohet

Thuaja se gjysma e grave janë të mendimit se dhuna në familje është çështje private, ndërsa tri nga dhjetë gra mendojnë se viktimat i ekzagjerojnë pohimet për abuzim dhe përdhunim. Një numër shumë i madh i grave nuk e kanë denoncuar dhunën për shkak të turpit, shkaqeve financiare, mungesës së informacioneve dhe mosbesimit ndaj shërbimeve në dispozicion, frikës dhe njohurive të pamjaftueshme për atë se çka konsiderohet si dhunë.

Mungesa e strehëzave dhe qëndrueshmëria e shërbimeve ekzistuese

Nevojat më të mëdha të paplotësuara që kanë identifikuar gratë janë mungesa e ndihmës financiare dhe strehëzat afatgjata. Gratë dhe ekspertët kryesorë ranë dakord se nuk ka numër të mjaftueshëm të strehëzave, se nuk ka financim të qëndrueshëm dhe se ekzistojnë pengesa për qasje deri te strehëzat ekzistuese.

Nevoja për mbështetje më të madhe dhe për veprim të përkushtuar për ndihmë të grave nga grupet minoritare dhe mjediset rurale

Gratë shqiptare dhe rome kanë qëndrime dhe pikëpamje më tradicionale sesa popullata e përgjithshme. Pranimi i DHNG dhe trajtimi i dhunës si çështje private mund t'i privojë këto grupe të grave nga qasja deri te ndihma. Gratë nga mjediset rurale janë ekspozuar në rreziqe më të mëdha për shkak të distancës së tyre nga shërbimet për mbështetje dhe për shkak të mungesës së pavarësisë financiare.

Rekomandime:

Gjetjet e lartpërmendura dhe konkluzionet nga anketa dhe sondazhi cilësor, vënë në dukje rekomandime konkrete për luftimin e dhunës ndaj grave (për listën e kompletuar shih Kapitullin 7):

Monitorimi i legjislacionit dhe harmonizimi i tij me Konventën e Stambollit**Për Parlamentin dhe Qeverinë:**

1. Të silltet ligj i ri për dhunë me bazë gjinore
2. Pas sjelljes së ligjit për dhunë me bazë gjinore, të ndryshohen ligjet përkatëse me qëllim të harmonizimit të tyre me të, të ndryshohet Kodi Penal në mënyrë që të mundësohet ndjekja penale *ex-officio* e përdhunimit martesor dhe të analizohet harmonizimi i tij me Konventën e Stambollit, përfshirja e të dhënave dhe referimi i sondazhit të realizuar nga OSBE në Plan Veprimin Nacional për zbatimin e Konventës së Stambollit dhe krijimi i pozitës së veçantë në institucionet që do përqendrohet në dhunën me bazë gjinore.

Bashkëpunimi, trajnimi dhe qasja shumë sektoriale**Për Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale**

3. Të sigurohet bashkërenditje midis ofruesve të shërbimeve dhe integrim i shërbimeve në sistemin për bashkëpunim me më shumë faktorë, ndërsa punëtorëve social t'u sigurohen trajnime dhe aktivitete për ndërgjegjësim.

Për Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme

4. Të realizohen trajnime të vazhdueshme për dhunën me bazë gjinore, për dhënësit e shërbimeve, të sigurohet trajnim sistematik lidhur me Ligjin e ri për dhunën me bazë gjinore, me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, si dhe ndryshimet e Kodit Penal (viti 2019) dhe të shqyrtohet mundësia t'i drejtohen OSBE-së për mbështetje për trajnime dhe aktivitete për ndërgjegjësimin e gjyqësorit dhe nëpunësve policorë.

Shërbime të specializuara për gra, duke i përfshirë edhe grupet e pafavorizuara të grave dhe aktivitetet e ndërgjegjësimi**Për Qeverinë dhe Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale në bashkëpunim me organizatat joqeveritare**

5. Të sigurohen mjete buxhetore dhe cilësi, konsistencë dhe qasje deri te shërbimet në strehëzat e grave. Të sigurohet ndihmë financiare dhe mbështetje afatgjatë, shërbime për punësim dhe banim për viktimat e dhunës dhe shërbime relevante për grupet e pafavorizuara të grave, si dhe të grave të grupeve minoritare.
6. Të zhvillohen fushata ndërgjegjësimi për dhunën ndaj grave, si dhe fushata lokale për përhapjen e informacioneve në mesin e grupeve të pafavorizuara të grave.

Për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës


7. Të zbatohen programe mësimore në shkollat dhe institucionet parashkollore për stereotipat gjinorë dhe marrëdhëniet e shëndetshme, me fokus mbi barazinë gjinore.

Rezultate të sondazhit të drejtuar nga OSBE: Maqedonia e Veriut

U zhvillua sondazh me mostre përfaqësuese të grave në moshës prej 18 deri 74 vjeçare që jetojnë në Maqedoninë e Veriut. U realizuan gjithsej 1,910 intervista kokë më kokë nga prilli deri në gusht 2018. Të dhënat janë ponderuar në profilin e njohur të popullsisë.

PREVALENCA E LARTË E FORMAVE TË NDRYSHME TË DHUNËS NDAJ GRAVE

PREVALENCA E LARTË E FORMAVE TË NDRYSHME TË DHUNËS NDAJ GRAVE



416,000*

gra kanë përjetuar ndonjë formë të ngacmimit seksual, ndjekjes, dhunës nga partneri intim ose jo-partneri (duke përfshirë dhunën psikologjike, fizike ose seksuale që nga moshë 15 vjeçare

69,000*


gra kanë përjetuar dhunë psikologjike dhe/ose seksuale nga partneri intim

55,000*

gra kanë përjetuar dhunë psikologjike dhe/ose seksuale nga jo-partner

**shifra të përafërta

PREVALENCA E DHUNËS NGA JO-PARTNERI TE GRATË QË FLASIN MAQEDONISHT DHE TE GRATË QË FLASIN SHQIP



DHUNA NGA PARTNER INTIM




SDG 5.2.1: Dhunë fizike, seksuale ose psikologjike nga partneri intim në 12 muaj para sondazhit



■ Gratë që flasin maqedonisht ■ Gratë që flasin shqip

DHUNA PSIKOLOGJIKE NGA PARTNERI INTIM ËSHTË FORMA MË E PËRHAPUR





Bazat: Prevalenca e përgjithshme e ngacmimit seksual, ndjekjes dhe dhunës nga jo-partner bazohet në të gjitha gratë në moshë prej 18-74 (1,910); të gjitha gratë që flasin maqedonisht (1,414); të gjitha gratë që flasin shqip (496)


Prevalenca e përgjithshme e dhunës nga partneri intim bazohet në të gjitha gratë që ndonjëherë kanë pasur partner (1,778); gratë që flasin maqedonisht që ndonjëherë kanë pasur partner (1,359); gratë që flasin shqip që ndonjëherë kanë pasur partner (419)

SHKALLË E ULËT E DENONCIMIT DHE INFORMIMIT

SHUMË GRA NUK NDIHEN TË INFORMUARA PËR ATË SE ÇKA DUHET TË BËJNË NËSE PERJETOJNË DHUNË




% që kanë dëgjuar për secilën organizatë lokale për mbështetje



Baza: të gjitha gratë në moshë prej 18-74 (1,910); të gjitha gratë që flasin maqedonisht (1,414); të gjitha gratë që flasin shqip (496)

SHKALLË E ULËT E DENONCIMIT NË POLICI


% që kanë kontaktuar policinë drejtpërdrejt pas përjetimit të incidentit më serioz të dhunës




Baza: të gjitha gratë në moshë prej 18-74 vjeçare që kanë identifikuar incidentin më serioz nga secila formë e dhunës – ngacimimi seksual (648), ndjekja (171), partner aktual (109), ish-partner (216) jo-partner (181)

QËNDRIME PËRULËS DHE NËNSHTRUESE

Q: A do të ishin miqtë tuaj në përgjithësi dakord ose jo me deklaratat e mëposhtme? "Një grua e mirë i bindet burrit të saj edhe nëse ajo vetë nuk është dakord"



Q: Në çfarë mase do të ishit dakord ose jo me deklaratat e mëposhtme? "Dhuna në shtëpi është një çështje private dhe duhet të trajtohet brenda familjes"




■ Plotësisht/disi dakord ■ Plotësisht/disi jo-dakord

Baza: të gjitha gratë që flasin maqedonisht (1,414); të gjitha gratë që flasin shqip (496)

NDIKIMI I INCIDENTEVE MË SERIOZE


DHUNA SHKAKTON VUAJTJE PSIKOLOGJIKE

% që kanë përjetuar një ose më tepër pasojë psikologjike për shkak të...



DHUNA SHKAKTON VUAJTJE FIZIKE

% që kanë vuajtur nga një ose më tepër pasojë fizike për shkak të ...



Kjo nënkupton **32,500 gra*** të cilat kanë përfunduar me lëndime ose pasojë fizike, ku janë marrë parasysh vetëm rastet më të rënda që ato i kanë identifikuar, në jetën e tyre si të rritur.

*Shifra të përafërta

Baza: të gjitha gratë në moshë prej 18-74 vjeçare që kanë identifikuar incidentin më serioz nga secila formë e dhunës – ngacimimi seksual (281), ndjekja (83), partner aktual partner (85), ish-partner (59) jo-partner (107), çfarëdo dhune nga partner intim/jo-partner (212)

Përmbajtja

Sfondi	i
Rezyme ekzekutive.....	iii
1. Si të lexohen të dhënat	1
2. Konteksti juridik, institucional dhe politik.....	5
3. Pikëpamjet lidhur me rolet gjinore dhe dhunën ndaj grave	13
4. Dhuna ndaj grave në Maqedoninë e Veriut	21
5. Konflikti dhe dhuna.....	45
6. Ndikimi i dhunës mbi jetën e grave dhe pengesat për të kërkuar mbështetje	51
7. Përvojat e dhunës tek grupet e caktuara të grave.....	67
8. Konkluzionet kryesore dhe rekomandimet	73
Anekse	79



1. Si të lexohen të dhënat

Hyrje dhe objektivat kryesorë të sondazhit

Sondazhi i realizuar nga OSBE është sondazhi i parë i këtij lloji i cili e mbulon prevalencën e dhunës ndaj grave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në bazë të mostrës përfaqësuese nga popullata e rritur e grave (1.910 gra të grup moshës 18 -74 vjeç, prej të cilave 496 gra e plotësuan sondazhin në gjuhën shqipe dhe 1.414 sondazhin e plotësuan në gjuhën maqedonase). Të dhënat kryesore demografike të shfrytëzuara për këtë sondazh janë mosha e grave, statusi i punës, a kanë jetuar në mjedise rurale ose urbane dhe a kanë qenë të prekura nga ndonjë konflikt ose jo. Objektivat kryesorë të sondazhit janë të sigurojnë dëshmi për prevalencën e DHNGV dhe për pasojat e saj mbi shëndetin dhe mirëqenien e grave për qëllimet e krijimit të politikave. Pyetjet kryesore të sondazhit janë:

- Cila është shkalla e dhunës ndaj grave në Maqedoninë e Veriut?
- Cilat forma të dhunës i përjetojnë gratë në Maqedoninë e Veriut?
- Kush janë autorët e dhunës ndaj grave?
- Cilat janë pasojat e dhunës ndaj grave dhe mirëqenies së grave?
- A i denoncojnë gratë rastet në polici ose në organe dhe organizata të tjera? Nëse jo, pse jo?
- A ekzistojnë dallime midis përvojave të dhunës ndaj grave varësisht nga mosha e tyre, arsimit, statusi profesional, të ardhurat ose a janë pjesë e ndonjë grupi minoritar ose nga zonat rurale?

Sondazhi, veç tjerash, kishte për qëllim të përcaktojë nëse kjo që është thënë më lartë ndërlidhet me atë se a kanë përjetuar gratë ndonjë konflikt të armatosur në bazë të përkufizimeve të përdorura në këtë sondazh (shih: Më shumë në Kapitullin 5).

Në sondazhin e drejtuar nga OSBE, nga gratë është kërkuar ta bëjnë dallimin ndërmjet incidenteve që kanë ndodhur nga mosha 15 vjeçare dhe 12 muaj para sondazhit. Me këtë, gratë mund të bëjnë dallim ndërmjet ngjarjeve të kohë-mëparshme dhe ngjarjeve më të hershme. Veç tjerash, me anketën u siguruan të dhëna që janë drejtpërdrejtë relevante për politikën dhe praktikën aktuale, siç është denoncimi dhe reagimet ndaj viktimave.

Të dhënat u **analizuan sipas gjuhës në** të cilën u realizua anketa, e që e mundëson krahasimin midis grave të cilat flasin në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

Nga ana tjetër, grave iu parashtrua edhe pyetja se a e konsiderojnë vetveten **si pjesë të një pakice etnike, pakice emigrantësh, pakice fetare, pakice seksuale dhe pakice në kuptimin e aftësive** të kufizuar, refugjatë ose person i zhvendosur apo si të kthyerat **në vendin ku ato kanë jetuar në kohën e sondazhit**. Në përgjithësi, 8% deklaruan se i përkasin pakicës etnike lokale dhe 6% pakicës fetare (asnjë grua nuk u deklarua se është pjesë e grupeve të tjera).

Duke menduar për vendin ku jetoni (në qytetin ose fshatin tuaj), a mendoni se jeni pjesë e ndonjë prej këtyre më poshtë?	Gjithsej	Në cilën gjuhë u realizua intervista?	
		Maqedonisht	Shqip
N	1,910	1,414	496
Pakicë etnike	7.6%	10%	1%
Pakicë fetare	5.7%	4%	11%
Nuk ka	81,5%	83%	77%
Nuk e di	4.4%	3%	8%
Refuzon	1.7%	1%	3%

Siç mund të shihet në tabelë, gratë detyrimisht nuk deklarohen si pjesëtarë të pakicës etnike ose fetare sipas gjuhës në të cilën është realizuar intervista.

Krahasueshmëria e të dhënave nga zonat e përfshira me sondazhin e realizuar nga OSBE me të dhënat e BE-së

Sondazhi bazohet në metodologjinë që e përdori Agjencia Evropiane për të Drejta Themelore (FRA) për sondazhin e dhunës ndaj grave në vitin 2012 në 28 vendet-anëtare të Bashkimit Evropian.⁵ Për këtë shkak, sondazhi i realizuar nga OSBE është i krahasueshëm me sondazhin e FRA. Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) në punën e tij aktuale i përdor të dhënat e FRA dhe në të ardhmen planifikon t'i përdor edhe gjetjet nga ky sondazh. Përfundimisht, sondazhi i OSBE i përfshinë pyetjet e përzgjedhura të Eurobarometrit për qëndrimet ndaj DHNG.

Rezistenca ndaj ndarjes së përvojës

Në mënyrë që të kuptohet më mirë prevalenca ndaj DHNG, konteksti është jashtëzakonisht i rëndësishëm. OSBE këtë sondazh e plotësoi me disa pyetje lidhur me normat, qëndrimet dhe sjelljen e grave, familjeve të tyre dhe miqve (duke i përfshirë edhe burrat) në lidhje me dhunën dhe përvojën e denoncimit të keqtrajtimit. Duke i krahasuar të dhënat e OSBE me të dhënat e BE lidhur me pikëpamjet dhe normat gjinore (Eurobarometri nr. 449),⁶ ky sondazh sugjeron se kur më shumë gra mendojnë se dhuna në familje është çështje private, atëherë tendenca e grave të cilat e denoncojnë dhunën në polici dhe në organizata tjera është më e vogël në vendet ku ekziston traditë më e gjatë e ndërgjegjësimit për dhunën ndaj grave. Sondazhi cilësor konfirmon se tabuja dhe turpi në lidhje me dhunën seksuale janë mjaft të përhapura.

Sondazhi paraprak

Sondazhi i parë nacional për dhunën në familje në Maqedoninë e Veriut u realizua në vitin 2012 në kuadër të programit të emërtuar: "Fuqizimi i kapaciteteve nacionale për parandalimin e dhunës në familje."⁷ Sondazhi u realizua me një mostër prej 2.100 burra dhe gra në moshë prej 15 vjeç e më lartë. Fokusi i sondazhit nuk ishte dhuna me bazë gjinore ose dhuna ndaj grave, por dhuna në familje ndaj grave, burrave dhe fëmijëve (u përfshinë adoleshentë të grup moshës 15-18 vjeç).

5 *Violence against women: an EU-wide survey. Main results* (Vienna: European Union Agency for Fundamental Rights, 2015), e aksesuar 22 Mars 2019, <http://fra.europa.eu/en/publication/2014/violence-against-women-eu-wide-survey-main-results-report>.

6 *Special Eurobarometer 449: Gender-based Violence*, European Commission, Directorate-General on Justice and Consumers, November 2016, e aksesuar 22 mars 2019, https://data.europa.eu/euodp/data/dataset/S2115_85_3_449_ENG.

7 Lubinka Popovska, Vlado Rikalovski dhe Elizabeta Vilagomez, *Raport për Sondazhin Nacional për Dhunën në Familje* (Shkup: MagnaSken, 2012), i aksesuar më datë 4 prill 2019, https://www.academia.edu/6318311/REPORT_ON_THE_NATIONAL_SURVEY_OF_DOMESTIC_VIOLENCE.

Sipas gjetjeve të sondazhit, 39% e grave dhe 36% e burrave kanë përjetuar dhunë në familje. Prevalenca e formave të ndryshme të dhunës në familje vazhdimisht ka qenë më e lartë tek gratë, ndërsa është konstatuar se pjesa më e madhe e autorëve kanë qenë burra. Gratë dhe burrat më të rinj kanë qenë veçanërisht të ekspozuar ndaj dhunës, ndërsa prevalenca tek fëmijët (15-18 vjeç) ka qenë më e lartë sesa tek të gjitha grup moshat e tjera. Prevalenca ka qenë më e madhe tek gratë me arsim më të ulët dhe tek ato që jetojnë në mjedise rurale. Më shumë se tre të katërtat e incidenteve të dhunës nuk janë denoncuar në shërbimet publike. Në raste të denoncimit, kryesisht denoncimet janë bërë në polici, në qendrat për punë sociale dhe qendrat shëndetësore, megjithatë shkalla e kënaqësisë nga cilësia e përgjigjeve nga këto institucione ka qenë mjaft e ulët.

Maqedonia e Veriut mori pjesë në sondazhin rajonal për romët i realizuar nga ana e UNDP dhe Bankës Botërore në vitin 2017 në Ballkanin Perëndimor. Rezultatet e sondazhit e vunë në dukje pozitën veçanërisht të brishtë të grave rome dhe përhapjen e madhe të martesave të hershme (çdo e treta rome në moshë prej 20 deri 49 vjeç është martuar para moshës 18 vjeçare), e që e dëmton mirëqenien e vajzave rome.⁸

Udhëzues për interpretimin e të dhënave nga sondazhi

Aty ku shumica e përqindjeve të dhëna nuk është 100, kjo mund t'i referohet rrumbullakimit, përjashtimit të përgjigjeve "nuk e di" ose faktit se respondentet kanë pasur mundësi për më shumë përgjigje ndaj pyetjeve të caktuara.

Privatësia dhe anonimiteti

Intervistat u realizuan kokë-më-kokë nga gra anketuese të trajnuara dhe me përvojë. Intervistat u realizuan me përdorimin e tabletit dhe me parimin e pajtimit të informuar. Të anketuarave iu bë me dije se të gjitha të dhënat e grumbulluara do të jenë konfidenciale dhe të anonimizuara.

Format e përfshira të dhunës

Gjetjet e prezantuara në këtë raport mbështeten mbi pyetjet e parashtruara në sondazhin e OSBE-së për dhunën ndaj grave të cilën e ka ushtruar partneri intim ose jo-partneri, si dhe rastet e ngacmimit seksual, ndjekja, dhuna në fëmijëri dhe ndikimi i konfliktit mbi dhunën me bazë gjinore. Pyetësi bazohet në përkufizimet e përcaktuara në Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).

Në mënyrë që të matet (përcaktohet) prevalenca e çdo lloji të dhunës, grave iu parashtrua pyetja, a kanë përjetuar lloje të ndryshme të dhunës në periudha të ndryshme referente, siç është specifikuar në Kapitullin 3 dhe 4 të këtij Raporti.

- Në lidhje me dhunën **fizike** dhe seksuale, lista e pyetjeve të parashtruara në anketë mund të gjendet në faqen X të Kapitullit 4.
- Në lidhje me **dhunën psikologjike**, lista e pyetjeve që u parashtruan në anketë mund të gjendet në faqen X të Kapitullit 4.
- Në lidhje me **ngacmimin seksual**, gjatë anketës grave iu parashtruan pyetjet e listuara në faqen X të Kapitullit 4.
- Për **ndjekjen**, gjatë anketës grave iu parashtruan pyetjet e listuara në faqen X të Kapitullit 4.

Në këtë sondazh, dhuna në fëmijëri i referohet dhunës e cila ka ndodhur para moshës 15 vjeçare. Lista e pyetjeve të parashtruara për përvojat e dhunës në fëmijëri mund të gjendet në faqen X të Kapitullit 4. Pyetjet, metodologjia dhe mosha e të anketuarve në këtë sondazh të OSBE-së dallon nga anketat e pyetësorit internacional për përvojat negative në fëmijëri⁹ dhe nga Anketat e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë¹⁰ dhe prevalenca e dhunës në fëmijëri nga ato anketa nuk është e krahasueshme.

8 "Regional Roma Survey 2017: Country Fact Sheets", UNDP in Europe and Central Asia, 9 April 2018, e aksesuar më 4 prill 2019, <http://www.eurasia.undp.org/content/rbec/en/home/library/roma/regional-roma-survey-2017-country-fact-sheets.html>.

9 WorldHealthOrganization, AdverseChildhoodExperiencesInternationalQuestionnaire (ACE-IQ) i aksesuar më datë 26 Mars 2019, https://www.who.int/violence_injury_prevention/violence/activities/adverse_childhood_experiences/en/

10 UNICEF, MultipleIndicatorClusterSurvey (MICS) i aksesuar më datë 26 Mars, https://www.unicef.org/statistics/index_24302.html

Në lidhje me Kapitullin që i përkushtohet konfliktit dhe dhunës me bazë gjinore

(Kapitulli 5), për qëllimet e këtij sondazhi, nocioni **konflikt i armatosur** përkufizohet si konflikte të armatosura midis dy e më shumë grupeve të organizuara, sulme ndaj bashkësive ose pasiguri e përgjithshme e shkaktuar nga konflikti, ndërsa gratë të cilat konsiderohen si persona të prekur nga konflikti janë ato të cilat kanë jetuar në situatë të konfliktit të armatosur aktiv në një periudhë prej më së paku një jave dhe të cilat janë “përgjigjur” me “po” së paku në njërin prej pyetjeve të specifikuara në faqen X të Kapitullit 5.

Partnerë ka të bëjë me persona me të cilët respondentet janë në martesë, jetojnë bashkë ose me të cilët janë në lidhje, duke mos jetuar bashkë. Jo-partnerë ka të bëjë me të gjithë autorët, të cilët nuk janë partnerë aktual ose ish-partnerë të grave.

Incident më serioz ka të bëjë me incidentin i cili ka goditur **më së shumti gratë e anketuara, qoftë fizikisht ose psikisht.**

Pasqyra e sondazhit cilësor

Pesëmbëdhjetë ekspertë kryesorë të cilët punojnë në Maqedoninë e Veriut i paraqitën pikëpamjet e tyre për mënyrën se si punojnë institucionet qeveritare dhe OJQ-të në parandalimin e DHNG, çfarë mbështetje kanë gratë të cilat kanë përjetuar DHNG dhe cilat janë rekomandimet e tyre. Ekspertët ishin përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të institucioneve qeveritare dhe joqeveritare.

U realizuan nëntë fokus grupe me gra të grup moshave të ndryshme, gra të cilat jetojnë në mjedise urbane dhe rurale të Maqedonisë së Veriut, gra nga grupe të ndryshme të pakicave (shqiptare dhe rome) dhe 24 gra të cilat kanë përjetuar konflikt. Qëllimet e diskutimeve ishin:

- të kuptohen qëndrimet e shoqërisë ndaj grave në përgjithësi dhe të kuptohet DHNGV dhe autorët e dhunës së këtyre;
- të hulumtohet se si kanë ndryshuar pikëpamjet ndaj DHNGV me kalimin e kohës, duke përfshirë këtu edhe periudhat e konfliktit;
- të hulumtohet shkalla deri në të cilën gratë janë të njoftuara për masat ekzistuese për mbështetje, pikëpamjet e tyre për ato masa dhe për çdo gjë tjetër që mund t'i pengojë në qasjen ndaj mbështetjes së këtyre; dhe
- të përcaktohet se si mund të përmirësohet parandalimi dhe mbështetja.

Katër intervista të thelluara u realizuan me viktime të dhunës, duke i përfshirë edhe gratë me aftësi të kufizuara. Qëllimet e këtyre intervistave janë:

- të hulumtohen format e dhunës të cilat gratë i kanë përjetuar gjatë gjithë jetës dhe ndikimi i konfliktit;
- të përcaktohen shkaqet e rezistencës së grave që të flasin për përvojat e tyre dhe për të kërkuar mbështetje, si dhe të hulumtohen shkaqet pse disa gra pajtohen të flasin për përvojat e tyre, e disa jo;
- të kuptohet mbështetja të cilën e marrin, të identifikohen mangësitë gjatë dhënies së shërbimeve dhe të përcaktohen nevojat e pa-përmbushura të grave të cilat u përkasin grupeve të pakicave të caktuara (për shembull: gra të cilat i përkasin pakicës etnike ose pakicës me aftësi të kufizuara); dhe
- të kuptohet se si gratë të cilat kanë pasur mbështetje (formale ose joformale), kanë pasur sukses në këtë dhe si e njëjta ka ndikuar mbi to.

2. Konteksti juridik, institucional dhe politik

Ky kapitull ofron një pasqyrë të shkurtër të ligjeve themelore nacionale që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave¹¹, parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna, grumbullimin e të dhënave dhe ndikimin e konfliktit mbi gratë. Ky kapitull mbështetet mbi qëndrimet e 15-të ekspertëve kryesorë të cilët u intervistuan dhe mbi pasqyrën e literaturës, përfshirë këtu edhe Vërejtjet përfundimtare të Komitetit të KB të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave nga viti 2018 (CEDAW).¹²

Hyrje

Dhuna ndaj grave ndikon mbi jetën e miliona grave dhe vajzave dhe e pengon progresin drejt një sigurie të përgjithshme për të gjithë. OSBE, si organizatë më e madhe rajonale e sigurisë në botë, pranon se DHNGV nuk ndikon vetëm mbi sigurinë dhe mbrojtjen e grave, por gjithashtu i pengon të marrin pjesë në rrjedhat shoqërore ose t'i shfrytëzojnë aftësitë dhe kompetencat e tyre me potencialin e tyre të plotë.

Sondazhi i drejtuar nga OSBE u fokusua mbi dhunën gjinore ndaj grave të ushtruar nga partnerët e tyre, anëtarët e familjes, miqtë, kolegët dhe të njohur, si dhe nga autorë të panjohur.

Dhuna ndaj grave është shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të grave dhe manifestim i raporteve historikisht të pabarabarta të fuqisë midis burrave dhe grave.¹³ Meqë pabarazia gjinore buron nga baza e dhunës gjinore, është me rëndësi të merret parasysh konteksti më i gjerë i statusit të grave në rajonin e OSBE-së, me qëllim që të vlerësohet siguria dhe mirëqenia e tyre.

Në Maqedoninë e Veriut, si edhe në shumë vende të tjera të rajonit dhe botës, këto pabarazi strukturore janë evidente në fusha të ndryshme: pjesëmarrja politike dhe ekonomike; qasja deri te prona, të ardhurat dhe shërbimet; pjesëmarrja në ekonomi; standardi modest jetësor dhe kualiteti i jetës.

Gratë janë përfaqësuar në nivel të pamjaftueshëm në pozitat e ndikimit politik dhe nuk kanë influencë të njëjtë si burrat mbi politikën, ligjet dhe reformat të cilat i japin formë zhvillimit socio-ekonomik. Për shkak të sistemit të kuotave ligjore, gratë përbëjnë rreth një të tretën e parlamentit nacional (36%), megjithatë pjesëmarrja e tyre në pushtetin ekzekutiv është e ulët, me vetëm katër gra nga 25 ministra (16%). Gratë janë përfaqësuar në masë të pamjaftueshme në të gjitha institucionet qeveritare, ndërsa vetëm 7% e komunave udhëhiqen nga gra.¹⁴

Gratë nuk marrin pjesë të barabartë me burrat edhe në ekonomi. Ato janë të përfaqësuara në nivel të pamjaftueshëm në tregun e punës, ndërsa kushtet gjatë punësimit janë më pak të favorshme në krahasim me burrat. Shkalla e aktivitetit¹⁵ tek gratë në moshën e aftë për punë (15-64) është shumë më e ulët me atë të burrave (51,9% kundrejt 79%), si dhe shkalla

11 Trafikimi me qenie njerëzore dhe, më saktë, trafikimi me gra dhe vajza për eksploitim seksual është një lloj i dhunës me bazë gjinore ndaj grave. Kjo është çështje serioze e të drejtave të njeriut dhe sigurisë. Ky studim nuk përfshin pyetje për këtë lloj dhune, meqë sondazhi i trafikimit me qenie njerëzore përfshin rrezik shumë të madh për viktimat, ndërsa sondazhi i familjeve nuk është metodë adekuate e sondazhit. Sondazhi i FRA në të cilin bazohet sondazhi i drejtuar nga OSBE, nuk e trajton trafikimin me gra dhe vajza.

12 "Concluding observations on the sixth periodic report of the former Yugoslav Republic of Macedonia", United Nations Human Rights, Office of the High Commissioner, Committee on the Elimination of Discrimination against Women (CEDAW), 22 tetor–9 nëntor 2018 r., e aksesuar 22 mars 2019, https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/MKD/CO/6&Lang=En.

13 Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, viti 1994.

14 "Information submitted for consideration to the Committee on the Elimination of Discrimination against Women in its adoption of a list of issues regarding the Sixth Periodical Report of the Republic of Macedonia under the Convention on Elimination of All Forms of Discrimination against Women, 71 Pre-Sessional Working Group, 12-16 March, 2018", Reactor – Research in Action, January 2018, i aksesuar më datë 22 mars 2019, https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/MKD/INT_CEDAW_NGO_MKD_30045_E.pdf.

15 Shkalla e aktivitetit e vë në dukje pjesëmarrjen e grave në fuqinë e punës, përkatësisht pjesëmarrjen e grave të cilat janë të punësuar ose kërkojnë punë në popullsinë e përgjithshme të grave të afta për punë (15-64 vjeçare).

e punësimit (41,2% kundrejt 62,3%).¹⁶ Gratë paguhen më pak se burrat për vendet e njëjta të punës. Një sondazh për dallimet në paga midis burrave dhe grave tregon se gratë fitojnë 18% më pak sesa burrat me karakteristika të njëjta në tregun e punës (kualifikime, përvojë pune, profesion etj.), përkatësisht gratë duhet të punojnë 65 ditë më shumë në nivel vjetor që të fitojnë pagë të njëjtë.¹⁷

Nga njëra anë pjesëmarrja e grave në punën e paguar është më e ulët nga ana tjetër ato realizojnë vëllim jo-proporcional të obligimeve në familje si dhe përkujdesje familjare. Gratë në marrëdhënie bashkëshortore me fëmijë të varur deri në moshën 6 vjeçare, mesatarisht kalojnë nga 4,2 orë më shumë sesa burrat me status të njëjtë martesor dhe prindëror, sa u përket aktiviteteve familjare dhe kanë më shumë se një orë të lirë më pak në ditë.¹⁸

Dhuna ndaj grave e ushtruar nga partnerët, anëtarë të familjes, miq, kolegë ose nga autorë të panjohur plotësisht mund të kuptohet në këtë kontekst, meqë instrumentet që janë në dispozicion për zbatimin e tij janë të kufizuara ose të përforcuara me veprime në fusha të tjera në të cilat gratë nuk janë të barabarta.

2.1: Legjislacioni nacional dhe zbatimi

Maqedonia e Veriut e shpalli pavarësinë nga ish-Jugosllavia në vitin 1991. Që atëherë, ajo ratifikoi ose trashëgoi disa detyrime ndërkombëtare për barazinë gjinore, përfshirë këtu edhe Konventën e KB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW, 1980) dhe Protokollin e saj Fakultativ. Kjo u përforcua me Deklaratën e Pekinit dhe Platformën për Veprim (1995), të cilat i obliguan vendet-pjesëmarrëse të ndërmarrin veprime për arritjen e barazisë gjinore dhe të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm. Maqedonia e Veriut kohë më parë e ratifikoi Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) e cila hyri në fuqi në korrik të vitit 2018.¹⁹

Kushtetuta e vendit e garanton barazinë dhe e ndalon diskriminimin mbi cilëndo qoftë bazë, përfshirë këtu edhe diskriminimin në bazë të gjinisë dhe dhunës ndaj grave.²⁰ Legjislacioni nacional e mbulon barazinë gjinore, dhunën në familje, ngacmimin seksual, dhunën seksuale dhe fizike, përdhunimin martesor dhe denoncimin e detyrueshëm, por jo edhe grumbullimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë.²¹

16 "Labour Force Survey", Database - Eurostat, 2018, i aksesuar më datë 22 mars 2019. <https://ec.europa.eu/eurostat/web/lfs/data/database>.

17 Sonja Avlijaš et al., *Gender Pay Gap in the Western Balkan Countries: Evidence From Serbia, Montenegro and Macedonia* (Belgrade, Foundation for the Advancement of Economics, 2013), pp. 11–12, i aksesuar më datë 22 mars 2019. <https://www.fren.org.rs/sites/default/files/Gender%20pay%20gap%20in%20the%20Western%20balkan%20countries.pdf>.

18 *Sondazhi për shfrytëzimin e kohës, viti 2009* (Shkup: Enti Shtetëror i Statistikave të RM, 2011), f. 27, i aksesuar më datë 22 mars 2019, <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.11.01.pdf>.

19 "Chart of Signatures and Ratifications of Treaty 210: Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence", Council of Europe Treaty Office, status as of 22 March 2019, i aksesuar më datë 22 mars 2019, https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/210/signatures?p_auth=DR7St6oc.

20 Sipas Nenit 9 të Kushtetutës: "Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes nacionale dhe sociale, besimit politik dhe fetar; pozitës pronësore dhe shoqërore. Të gjithë qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjit. Shih: "Barazi dhe mosdiskriminim", Baza globale kushtetuese e të dhënave për barazinë gjinore, i aksesuar më datë 22 mars 2019, <http://constitutions.unwomen.org/en/search?keywords=Macedonia,theformerYugoslavRepublic>.

21 Të dhënat e ndara sipas gjinisë i përfshijnë të dhënat e përgjithshme statistikore dhe të dhënat makroekonomike të bazuara në gjini, por jo edhe dhuna ndaj grave si e tillë. Ekspertët kryesorë të intervistuar për qëllimet e këtij raporti thanë se policia dhe institucionet relevante grumbullojnë një numër të kufizuar të të dhënave, por të njëjtat nuk janë publikisht të disponueshme.

Kodi Penal në Maqedoninë e Veriut e trajton dhunën në familje dhe shkeljen e të drejtave të njeriut në përgjithësi, me ç'rast disa vepra penale konsiderohen si më të rënda nëse janë kryer në lidhje të ngushtë personale. Sipas Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje nga viti 2014, dhuna ndaj grave rregullohet si formë e dhunës në familje. Përdhunimi është vepër penale e ndëshkueshme prej një deri 15 vjet burgim. Megjithatë, që të dëshmohet përdhunimi duhet të ketë përdorim të forcës ose kërcënimit me forcë, dhe jo vetëm mos-pajtim nga viktima. Përdhunimi në martesë është vepër penale, megjithatë ndiqet vetëm sipas padisë private²² Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi nga viti 2010 e përfshinë ngacmimin seksual si formë e ndaluar e diskriminimit.²³

Komiteti i CEDAW në raportin e vitit 2018 e përshëndeti progresin e arritur në vend, përfshirë këtu edhe miratimin e legjislacionit të lartpërmendur dhe ratifikimin e instrumenteve ndërkombëtare dhe rajonale. Megjithatë, raporti përmban edhe rekomandime gjithëpërfshirëse lidhur me diskriminimin dhe dhunën ndaj grave (përfshirë këtu edhe parandalimin e martesave me ujdj dhe martesave të hershme tek bashkësia rome dhe shqiptare).²⁴

Sa i përket konkretisht dhunës ndaj grave, Komiteti kërkoi nga Qeveria, në përputhje me kërkesat e Konventës, të miratojë ligj për adresimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave, përfshirë këtu edhe përdhunimin bashkëshortor. Rekomandohet të ndryshohet Ligji për familje dhe legjislacioni tjetër relevantë, me qëllim të heqjes së ndërmjetësimit dhe pajtimit në rast të dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe ndryshim të Kodit Penal me të cilët përkufizimi i "përdhunimit" do të bazohet në mosdhënien e pajtimit. Komiteti, veç tjerash, rekomandoi që shteti t'u siguroj viktimave qasje deri te ndihma juridike falas dhe deri te strehëzat.

Ekspertët kryesorë të intervistuar për këtë Raport i mbështetën këto konkluzione dhe i vunë në dukje mangësitë e legjislacionit. Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje i vitit 2014, konkretisht nuk i referohet dhunës ndaj grave edhe përkrah Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi nga viti 2010, Raporti i Stejt Departamentit për vitin 2013 për Maqedoninë e Veriut thekson se: "Ngacmimi seksual i grave në vendin e punës edhe më tutje mbetet si problem, ndërsa viktimat, marrë në përgjithësi, nuk ngrenë padi për shkak të frikës nga publiciteti dhe humbjes së mundshme të vendit të punës".²⁵ Gjatë kohës së tryezës së validizimit të këtij sondazhi në Shkup²⁶, palët e interesuara deklaruan se Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e harton ligjin e ri për dhunë me bazë gjinore dhe se planifikohen ndryshime edhe të Kodit Penal.

Situata mbetet e njëjtë, pasi edhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vitin 2018 e njoftoi Komitetin e CEDAW: "Dhuna në familje është forma e vetme e dhunës me bazë gjinore që është rregulluar. Ligji [2014] nuk është me ndjeshmëri gjinore ... dhe nuk i njeh vajzat dhe gratë si grupe veçanërisht të cënueshme sa i përket dhunës me bazë gjinore".²⁷

22 Ekstrakte nga legjislacioni primar dhe Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut (1996, me ndryshimet e viti 2004) mund të gjenden në gjuhën anglishte në ueb-faqen e Komisionit Juridik Ligjvënës të OSBE në: <http://www.legislationline.org/documents/action/popup/id/5637>. Përdhunimi është përkufizuar në nenin 186 të Kodit Penal.

23 Sipas Nenit 7 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, ngacmimi seksual definohet si "sjellje e padëshiruar me karakter gjinor, e cila shprehet fizikisht, verbalisht ose në çdo lloj mënyre tjetër, ndërsa ka për qëllim ose pasojë cenimin e dinjitetit të personit, veçanërisht kur krijohet mjedis armiqësor, kërcënues, degradues ose përçmues".

24 "Pikëpamjet përfundimtare për raportin e gjashtë periodik për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë"

25 "Raport për të drejtat e njeriut në Maqedoni për vitin 2013", Stejt Departamenti i SHBA, 27 shkurt 2014, i aksesuar më datë 22 mars 2019, <https://www.state.gov/j/drl/rls/hrrpt/2013/eur/220304.htm>.

26 Tryezë e rumbullakët për Validizim u mbajt më datë 4 dhjetor 2018 në Shkup dhe në të kanë marrë pjesë 25 palë të interesuara nga institucione qeveritare, shoqëria qytetare dhe organizatat ndërkombëtare.

27 "Republika e Maqedonisë: Kërkesë deri te Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave gjatë miratimit të listës me pyetje në lidhje me Raportin e Gjashtë Periodik të Republikës së Maqedonisë sipas Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit të Grave", Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, 29 janar 2018, i aksesuar më datë 22 mars 2019, https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/MKD/INT_CEDAW_NGO_MKD_30018_E.pdf.

2.2: Mekanizmat institucionalë dhe bashkëpunimi

U miratuan disa strategji dhe u themeluan disa institucione të cilat e trajtojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e diskriminimit, duke e përfshirë edhe Strategjinë për Barazi Gjinore (2013-2020), Sektorin për Mundësi të Barabarta në Ministrinë për Punë dhe Politikë Sociale, Komisionin Parlamentar për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave, Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Zyrën e Avokatit të Popullit, të cilat synojnë të përfshijnë dhunën me bazë gjinore si temë të veçantë të ekspertizës.

Megjithatë, që nga shpërbërja e Trupit Nacional të Koordinimit për Dhunën në Familje në vitin 2011, Ministria e Punëve të Brendshme është institucioni i vetëm nacional shtetëror që përmendet në burimet zyrtare të KB-së si mekanizëm institucional i cili e trajton dhunën ndaj grave. Sipas Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje nga viti 2014, u inkorporuan katër protokolle, përfshirë këtu edhe Protokollin shumë sektorial me të cilin kërkohet që institucione të ndryshme të punojnë bashkërisht.²⁸ Përveç kësaj, parashikohet formimi i Qendrës Nacionale të Koordinimit Kundër Dhunës në Familje me mandat pesëvjeçar për përfshirjen e përfaqësuesve nga ministritë përkatëse, politikanëve, gjyqësorit, Avokatin e Popullit dhe organizatave qytetare. Kjo qendër u krijua, por ende nuk funksiononte në kohën kur hartohej ky raport. Si rezultat i kësaj, nuk është dorëzuar raport për aspektin funksional të ligjit, madje nuk ka as udhëzime për përmirësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve dhe organizatave të lartpërmendura të shoqërisë civile²⁹ Pas ratifikimit të Konventës së Stambollit, Qeveria e miratoi Plan Veprimin Nacional (PVN) për zbatimin e Konventës së Stambollit (2018-2023) në tetor të vitit 2018. Aktiviteti i parë i PVN të cilin Qeveria planifikon ta zbatojë është hartimi i ligjit të ri për dhunë me bazë gjinore, me qëllim të harmonizimit të legjislacionit me Konventën e Stambollit. Kjo do të shoqërohet me hapjen e qendrave të reja konsulente për autorët dhe përpilimin e moduleve për trajnimin e profesionistëve të cilët punojnë me viktima të dhunës.³⁰ Ministria e Punës dhe Politikës Sociale gjatë kohës së tryezës së validizimit i njoftoi protagonistët se ka filluar puna e EIGE për Indeksin e Barazisë Gjinore³¹.

28 "Rregullore nga ligji për mbrojtje sociale", Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i aksesuar më datë 22 mars 2019, <http://www.mtsp.gov.mk/pravilnici.nsp>.

29 Zorica Saltirovska dhe Sunçica Dimitrioska, "Funksionaliteti juridik dhe institucional në mbrojtjen e grave, viktima të dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë – gjendja aktuale dhe perspektivat e ardhshme", *Gazeta Evropiane për shkenca shoqërore për arsim dhe sondazh* 4, nr. 4 (maj-qershor 2017): 131-139, i aksesuar më datë 22 mars 2019, http://journals.euser.org/files/articles/ejser_may_august_17_nr_2/Zorica.pdf.

30 "Prezantimi i Raportit të Gjashtë Periodik i Republikës së Maqedonisë të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave", Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, 1 nëntor 2018, i aksesuar më datë 22 mars 2019, https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/MKD/INT_CEDAW_STA_MKD_32920_E.pdf.

31 Instituti Evropian për Barazi Gjinore, i aksesuar më datë 26 mars 2019, <https://eige.europa.eu/gender-equality-index/about>

2.3: Disponueshmëria e të dhënave administrative dhe të dhënave të tjera

Të dhënat administrative, sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar, pozitës gjeografike dhe përkatësisë socio-ekonomike, janë të domosdoshme për vlerësimin e saktë të gjendjes së grave, pabarazisë gjinore, shkallës dhe natyrës së dhunës ndaj grave. Pa të dhëna, nuk është e mundur të ndërmerren masa korrektuese të mbështetura në prova.

Me sa duket nuk ekziston grumbullim i detyrueshëm i të dhënave për dhunën ndaj grave në vend. Burimet e vetme nacionale të të dhënave janë gjyqësori dhe policia, por ekspertët theksuan se këto të dhëna tanimë nuk janë në dispozicion të publikut.³²

Zyra e Avokatit të Popullit për momentin e hulumton shtrirjen e dhunës në familje dhe planifikon të vendos kontakte me institucionet qeveritare, me qendrat për punë sociale, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me gjykatat, me qëllim që të ketë qasje deri te të dhënat e tyre statistikore. Avokati i Popullit, veç tjerash, shprehu gatishmërinë të bashkëpunojë me organizatat joqeveritare dhe t'i shkëmbejë të dhënat rezultuese.

Të dhënat u siguruan për raportin e CEDAW nga viti 2018, ndërkaq ekziston një përmbledhje e madhe dhe e fragmentuar e raporteve të OJQ-ve vendore, duke e përfshirë edhe HERA (e cila kryesisht e trajton mbrojtjen shëndetësore dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme), EHO Shtip dhe organizatat e saj partnere (të cilat i trajtojnë viktimat e dhunës në familje në Shtip dhe Strumicë), si dhe një numër i madh i strehëzave dhe qendrave këshillëdhënëse. Si burim tjetër i të dhënave është edhe Human Rights Watch (i cili ofron gjetje për dhunën ndaj grave nga ana e nëpunësve policorë në strehimoret për refugjatë), *Revyja për të drejtën penale dhe kriminologji, (Makedonska revija za kazneno pravo i kriminologija)*³³ si dhe disa autoritete lokale.

Komiteti i CEDAW nga viti 2018 shprehu shqetësim për mungesën e informacioneve autentike për dhunën ndaj grave dhe i bëri thirrje Qeverisë që “në mënyrë sistematike t'i grumbullojë të dhënat, të dizagreguara sipas faktorëve relevantë për rastet e dhunës me bazë gjinore dhe diskriminimit ndaj grave për të cilat është ngritur procedurë para gjykatave si dhe për numrin e urdhër-mbrojtjeve të përkohshme”.

Ekspertët kryesorë e përsëritën këtë shqetësim, veçanërisht për faktin se me sa duket nuk grumbullohen të dhëna për shkallën e aktgjyqimeve të dhunës ndaj grave, ose meqë nuk pranohen si vepër penale ose për shkak të metodës së grumbullimit të të dhënave që i përdorin gjykatat.³⁴ Kjo i pengon autoritetet dhe publikun e gjerë ta detektojnë dhunën ndaj grave, ta matin dhe ta zgjidhin problemin.³⁵

32 Saltirovska dhe Dimitrioska, “Legal and Institutional Functionality in the Protection of Women – Victims of Domestic Violence in the Republic of Macedonia – Present Situation and Future Perspectives”, European Journal of Social Sciences Education and Research 4, No. 4 (May–June 2017): 131–139, I aksesuar më datë 22 mars 2019, http://journals.euser.org/files/articles/ejser_may_august_17_nr_2/Zorica.pdf.

33 *Gazetën Maqedonase për të Drejtën Penale dhe Kriminologji e boton Shoqata për të Drejtën Penale dhe Kriminologji*. Shih: <http://journal.maclc.mk/en/revija/orhttp://journal.maclc.mk/en/>.

34 See Yordanka Gancheva, *The Costs of Domestic Violence Against Women in FYR Macedonia: A Costing Exercise for 2006* (Cape Town: Economic Policy Research Institute, 2008).

35 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale i prezantoi disa të dhëna nga Raporti i Gjashtë Periodik për Maqedoninë e Veriut për Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, (CEDAW / C / MKD / 6), 5 maj viti 2017, 22 mars 2019, https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/TBSearch.aspx?Lang=en&TreatyID=3&DocTypeID=29.

2.4: Parandalimi, mbrojtja dhe mbështetja

Aktivitetet parandaluese mund të ndihmojnë në ndërgjegjësimin, në të kuptuarit dhe luftimin efikas të dhunës. Në vend ekziston një numër i madh i aktiviteteve parandaluese:

- Zhvillimi i sistemit të drejtësisë penale me qëllim që ushtruesit e dhunës të përgjigjen për veprat që i kanë kryer, të theksuara më lartë.
- Dhënia e ndihmës përkatëse sociale, mjekësore, psikologjike dhe juridike për viktimat e dhunës ndaj grave. Strategjia aktuale nacionale ka për qëllim ta sigurojë kornizën për masa specifike – gjinore të orientuara kah parandalimi dhe mbrojtja e grave, njëkohësisht duke ofruar një spektër të gjerë të masave dhe aktiviteteve të cilat i përfshijnë të gjithë personat e tjerë të mbijetuar.
- Organizimi dhe zbatimi i fushatave informative dhe edukative, veçanërisht për luftimin e stereotipave gjinorë. Iniciativat e kohë mëparshme të rrjetit: “Gratë kundër dhunës në Evropë” (WAVE) përbëhej nga fushata e quajtur “Step Up”, protestë e Ditës Ndërkombëtare të Paqes dhe Garë e Memeve në vitin 2017, me ç’rast të rinjtë u thirrën të imagjinojnë dhe të krijojnë meme në internet me mesazhe pozitive për jetë pa frikë dhe dhunë. Fushata “Burrat e vërtetë asnjëherë nuk e godasin gruan” e UNFPA ishte një fushatë nacionale trevjeçare për ndërgjegjësim e fokusuar mbi reduktimin e dhunës ndaj grave.

Aktivitetet parandaluese kryesisht i zhvillon shoqëria civile, megjithatë ekspertët e intervistuar për këtë raport, veç tjerash, sugjerojnë se ata shpeshherë kanë pasur pengesa serioze nga barrierat kulturore, mospranimi i dhunës ndaj grave, mirëmbajtja e dobët e mekanizmave dhe protokolleve, zbatimi joadekuat i ligjeve dhe mungesa e vullnetit politik.

Nuk ekziston institucion i nivelit qendror i cili zbaton trajnim për dhunën ndaj grave. Raportet zyrtare dhe ato të organizatave joqeveritare kanë të bëjnë me trajnime për juristë, për efektivët e policisë dhe për persona të tjerë profesionistë, por në të njëjtat nuk mund të gjendet asgjë që e vë në dukje zbatimin e ndonjë strategjie aktuale ose formimin e trupit nacional të koordinimit. Së këtejmi, disa nga ekspertët e intervistuar konfirmuan se trajnimi, deri diku, ka qenë i suksesshëm sa i përket ndërgjegjësimit, megjithatë ata edhe më tutje janë të shqetësuar për shkak të mungesës së evaluimit sistematik dhe ndërhyrjeve të shpeshta të politikës. Disa nga ekspertët, po ashtu, u fokusuan mbi mungesën e motivimit tek personat profesionistë që të njoftohen me këtë temë. Sipas tyre, të shumtë ishin ata që morën pjesë, por kjo ishte sepse trajnimi ishte i detyrueshëm, e jo se kishin dëshirë.

Viktimat e dhunës ndaj grave, ose ato që i janë ekspozuar rrezikut nga dhuna, kanë nevojë për mbrojtje dhe kushte elementare. Shërbimet për mbështetje përfshijnë shtatë strehëza të financuara nga Qeveria me kapacitet të kufizuar, një strehëz për gra të ekspozuara ndaj rrezikut e administruar nga një organizatë joqeveritare, linja telefonike nacionale (në gjuhën maqedonase dhe shqipe), dy qendra krize për strehim të përkohshëm (nga 24 deri në 48 orë) për viktimat e dhunës në familje, këshillimore familjare dhe këshillimore për viktimat, dhe një numër të madh të organizatave që ofrojnë ndihmë juridike falas.

Në vitin 2018, shteti ngriti tri qendra për referimin e viktimave të dhunës seksuale, të cilat janë në dispozicion të grave me aftësi të kufizuara.

Në raportet e publikuara, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka qëndrim shumë kritik në lidhje me zgjidhjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen:

- Shteti siguron strehim vetëm për viktimat e dhunës në familje, ndërsa më pak se 5% e viktimave gra, të cilat kanë denoncuar dhunë, janë strehuar, që do të thotë se një numër i madh kanë mbetur në shtëpi – shpeshherë me autorin. Ekziston një disbalans gjeografik i qasjes në këto shërbime.
- Tri organizata ofrojnë linja telefonike nacionale falas, SOS për ndihmë, edhe pse asnjëra nga linjat telefonike nuk ofron shërbime në të gjitha gjuhët që fliten brenda bashkësive, ndërsa aty ku Shërbimet janë të disponueshme nuk janë sensitive ndaj aftësisë së kufizuar, meqë viktimat me aftësi të kufizuar ndijore nuk mund të pranojnë informacione me gjuhën e shenjave ose me Alfabetin Brail.
- Procesi i sigurimit të urdhër-mbrojtjeve është burokratik dhe përçmues. Diskriminimi ndaj grave në bazë të stereotipave gjinorë, stigmatizimit, normave patriarkale dhe dhunës gjinore e pengon dhe/ose e pamundëson qasjen e grave deri te drejtësia në bazë të barabartë me burrat”.³⁶

2.5: Pasojat e konflikteve ndaj grave

Vendi u shkëput pa dhunë nga ish-Jugosllavia. Megjithatë, konflikti në vitin 2001 ndërmjet grupit militant të shqiptarëve etnikë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) dhe forcave të sigurisë në zonën veriore dhe perëndimore të vendit përfundoi me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Përveç kësaj, vendi u përfshi edhe nga kriza e refugjatëve nga konfliktet në Bosnjë e Hercegovinë dhe Kosovë në vitet '90.

Nuk kemi të dhëna zyrtare në dispozicion të publikut për dhunën e ndërlidhur me konflikt ndaj grave në vitin 2001. Ekspertët e intervistuar për qëllimet e këtij Raporti sugjeruan se mungesa e informacioneve mund t'i referohet mungesës së mekanizmave nacional dhe qasjes sistematike. Ekspertët deklaruan se ata kanë pasur informacione për raste të dhunës ndaj grave të ndërlidhura me konfliktin, megjithatë nuk ka pasur studime formale që t'i konfirmojnë ato. Human Rights Watch u fokusua mbi dhunën e pretenduar që ka të bëjë me policinë dhe mbi dhunën ndaj grave në qendrat e refugjatëve. Ministria e Punëve të Brendshme i mohoi këto pohime.³⁷

Në vitin 2004 SEESAC njoftoi se, pas konfliktit në vitin 2001, në vend lehtësisht mund të gjendeshin armët e vogla dhe të lehta. Ndonëse, banorët lokal manifestuan shqetësim për qasjen deri te armët, megjithatë, me sa duket nuk kanë dashur të heqin dorë nga arma e tyre për shkak të shqetësimit për sigurinë personale.³⁸ Nuk ka të dhëna të reja për këto çështje, edhe pse SEESAC në vitin 2016 njoftoi se ekziston një përqindje jashtëzakonisht e lartë e grave viktime nga arma e zjarrit në krahasim me vendet e tjera të Evropës Juglindore.³⁹

36 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

37 "Sikur nuk jemi njerëz: Brutaliteti policor mbi migrantët dhe azilkërkuesit në Maqedoni", Human Rights Watch, 17 janar 2018, i aksesuar më datë 22 mars 2019, <https://www.hrw.org/mk/report/2015/09/22/281212>.

38 Suzette R. Grillot et al., *A Fragile Peace: Guns and Security in Post-conflict Macedonia* (Belgrade:

South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse for the Control of Small Arms and Light Weapons, 2004), i aksesuar më datë 22 mars, viti 2019, <http://www.seesac.org/ff/docs/SALW-Surveys/A-Fragile-Peace--Guns-and-Security-in-post-conflict-Macedonia-.pdf>.

39 Dragan Božanić, *Gender and SALW in South East Europe: Main Concerns and Policy Response* (Belgrade:

South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse for the Control of Small Arms and Light Weapons, 2016), i aksesuar më datë 22 mars 2019, http://www.seesac.org/ff/docs/Armed-Violence/Gender_and_SALW_publication_eng-web.pdf.

37%

Përafërsisht dy nga pesë gra në moshë prej 18 deri 74 vjeçare janë të mendimit se miqtë e tyre në përgjithësi pajtohen se bashkëshortja e mirë i bindet bashkëshortit, madje edhe atëherë kur ajo nuk pajtohet.

48%

Thuaja se gjysma e grave në moshë prej 18 deri 74 vjeçare pajtohen se “dhuna në familje është çështje private dhe duhet të trajtohet brenda familjes”.

19%

Përafërsisht një nga pesë gra në moshë prej 18 deri 74 vjeçare besojnë se miqtë e tyre do të pajtohen se është detyrim i gruas që të kryejë marrëdhënie seksuale me burrin e saj edhe nëse ajo nuk dëshiron. Ky mendim është më i pranishëm tek gratë më të moshuara.

60%

Tri nga pesë gra në moshë prej 18-74 vjeçare janë të mendimit se në përgjithësi, dhuna ndaj grave nga partnerët, të njohurit apo të panjohurit është shumë ose disi e zakonshme.

3. Pikëpamjet lidhur me rolet gjinore dhe dhunën ndaj grave

Dallimet e brezave të cilat i zbuloi sondazhi e vënë në dukje faktin se rolet gjinore ndryshojnë, ashtu siç ndryshojnë edhe pikëpamjet tek brezat më të rinj lidhur me bindjen e grave ndaj burrave. Megjithatë, këto ndryshime janë të ngadalshme dhe mbetet një numër i konsiderueshëm i grave në pakicë të cilat mbajnë edhe më tutje pikëpamjen tradicionale të rolit të grave në shoqëri.

Gratë të cilat morën pjesë në sondazhin cilësor diskutuan për obligimet e grave në dy fusha të veçanta: jeta familjare dhe puna, si dhe balancimi midis të dyjave. Tradicionalisht, roli i gruas është fokusuar mbi familjen, ndërsa obligimet e saj kryesore janë kujdesi për fëmijët, për partnerin dhe shtëpinë.

“Sot gratë janë në pozitë më të mirë sesa në të kaluarën, meqë ato vetë mund të marrin vendime dhe janë më të pavarura në mendimet dhe sjelljet e tyre”.

Grua, në moshë prej 18-34 vjeçare, shqiptare etnike, nga mjedisi rural

Derisa zgjerimi i rolit të gruas me përfshirjen e punës me pagesë, në përgjithësi konsiderohej si punë e mirë, gratë të cilat morën pjesë në sondazhet cilësore deklaruan se në një farë mënyre, përgjegjësitë e grave thjeshtë u dyfishuan. Ato thanë se, edhe pse gratë ndërmarrin përgjegjësi më të madhe në sigurimin e të ardhurave financiare për familjen, megjithatë partnerët e tyre nuk u dolën në ndihmë duke marrë një pjesë më të madhe të punëve të shtëpisë. Kjo do të thotë se gratë kryesisht ndjenin se prej tyre kërkohet shumë. Kjo pyetje ishte veçanërisht e rëndësishme për gratë e moshuara, të cilat u përgjigjën se një kohë të gjatë janë dëshmitare të këtyre ngjarjeve, por ishin skeptike sa i përket dobisë nga ky ndryshim për gratë.

“Amvise, e punësuar dhe kujdeset për fëmijët, ndërsa bashkëshorti është ai i cili, kur do të vijë në shtëpi, do të shtrihet, do të shkojë në shëtitje, do të dalë, ndërsa gruaja duhet të bëjë çdo gjë”.

Grua, në moshë prej 18-34 vjeçare, maqedonase etnike, nga mjedisi rural

Gratë të cilat morën pjesë në sondazhin cilësor deklaruan se kanë shumë obligime në punë dhe shtëpi, por ankohen edhe për atë se nuk janë të përfshira askund jashtë këtyre dy aktiviteteve, veçanërisht në aktivitetet argëtuese dhe sociale. Kjo kryesisht është për shkak të numrit të obligimeve dhe për shkak të normave gjinore në vend të cilat ua kufizojnë lirinë.

Gratë deklaruan se madje edhe nëse do të kishin kohë për aktivitete jashtë shtëpisë dhe punës, ato do të ishin objekt i gjykimeve të ashpra, meqë shoqëria pret që ato t'i përkushtohen plotësisht familjes. Përveç kësaj, disa gra, veçanërisht gratë e moshuara, deklaruan se edhe pse punët dukshëm u ndryshuan që t'u lejohet grave të punojnë bashkë me burrat, megjithatë jo aq sa për t'u shoqëruar me kolegë ose me miq meshkuj. Ato e përshkruajnë se çdoherë ndihen se dikush i ndjek dhe pa u menduar i etiketon e kanë dalë jashtë normave të përcaktuara.


“Mund të themi se njerëzit mund të ta falin nëse shkon e vetme në kafeteri, ... por nëse vendos të jesh në shoqëri vetëm me burra, atëherë menjëherë do të etiketohesh ... Kjo është e tmerrshme...”

Grua, në moshë prej 55-74 vjeçare, maqedonase etnike, nga mjedisi urban

Të dhënat sasiore, po ashtu, e vënë në dukje faktin se akoma ekziston një pakicë e konsiderueshme e grave që kanë mendime tradicionale për rolin e grave. Për shembull, thuaja se dy nga pesë gra (37%) besojnë se miqtë e tyre do të pajtohen se një grua e mirë i bindet burrit të saj edhe nëse ajo vetë nuk është dakord, thuaja se një e treta e grave (32%) deklaruan se miqtë e tyre do të pajtohen me atë se është e rëndësishme që një burrë t'i tregojë gruas/partneres së tij se kush udhëheq, ndërsa thuaja se një nga pesë gra (19%) deklaruan se miqtë e tyre do të pajtohen se është detyrim i gruas që të kryejë marrëdhënie seksuale me burrin e saj edhe nëse ajo nuk dëshiron. Qëndrime më patriarkale kishin gratë të cilat flasin në gjuhën shqipe, prej të cilave 57 për qind mendojnë se miqtë e tyre do të pajtohen se një grua e mirë i bindet burrit të saj edhe nëse ajo vetë nuk është dakord, ndërsa thuaja se përqindje e njëjtë (54%) mendojnë se miqtë e tyre do të pajtohen se është e rëndësishme që një burrë t'i tregojë gruas/partneres së tij se kush udhëheq. Thuaja se një nga pesë gra në moshë prej 18 deri 74 vjeçare besojnë se miqtë e tyre do të pajtohen me atë se është detyrim i gruas që të kryejë marrëdhënie seksuale me burrin e saj edhe nëse ajo nuk dëshiron.

Grafiku 3.1. Perceptime të normave shoqërore dhe të sjelljes së pranueshme

Njerëzit kanë ide të ndryshme për familjen dhe për atë se çka është sjellje e pranueshme për burrat dhe gratë në familje. Më thoni ju lutem nëse miqtë tuaj do të ishin dakord ose jo me deklaratat e mëposhtme.



3. Pikëpamjet lidhur me rolet gjinore dhe dhunën ndaj grave

Ashtu si në sondazhet cilësore edhe të dhënat sasiore e vënë në dukje zhvendosjen e pikëpamjeve tek brezat e rinj. Përveç asaj nëse duhet të ndërhyjnë të tjerët kur një burrë e keqtrajton bashkëshorten e tij, gratë e reja besojnë se miqtë e tyre kanë pikëpamje më pak tradicionale nga gratë e moshuara. Për shembull, 28% e grave në moshë prej 18-29 vjeçare dhe 29% e grave në moshë prej 30-39 vjeçare deklaruan se miqtë e tyre do të pajtohen se gruaja e mirë i bindet burrit; kjo përqindje shënon rritje deri në 45% të grave në moshë prej 50-59 vjeçare dhe 48% e grave në moshë mbi 60 vjeçare. Po ashtu, 12% e grave nën moshën 40 vjeçare deklaruan se miqtë e tyre do të pajtohen me atë se obligim i gruas është të ketë marrëdhënie seksuale me burrin, por ky qëndrim është thuaja se tre herë më i madh te gratë mbi moshën 60 vjeçare (30%).

Sipas rezultateve të sondazhit, një numër i madh i grave nuk janë të mendimit se marrëdhëniet seksuale pa pajtimin e gruas mund të arsyetohen me çdo lloj rrethanash. Respondenteve iu shpërndanë skenarë të ndryshëm dhe iu parashtrua pyetja se a mund të arsyetohet marrëdhënia seksuale pa pajtim në cilin do qoftë prej këtyre rasteve – siç është marrëdhënia seksuale në martesë ose partneritet – nëse gruaja dhe autori kanë konsumuar bashkërisht alkool ose nëse gruaja mban rroba provokative. Më shumë se gjashtë nga dhjetë gra *aspak* nuk pajtohen se marrëdhënia seksuale pa pajtimin e gruas është e arsyeshme në cilindo qoftë prej skenarëve. Megjithatë, qëndrim nuk ishte unanimitet. Për shembull, më shumë se një nga pesë gra (22%) konsiderojnë se seksi pa miratimin në martesë ose midis partnerëve të cilët jetojnë bashkë mund të jetë i arsyeshëm, ndërsa një nga gjashtë gra e aprovojnë nëse gruaja paraprakisht ka bërë flirt ose nuk ka thënë në mënyrë të qartë jo ose nuk i ka bërë rezistencë.


Njëlloj si me qëndrimet për rolin e grave, gjasat janë më të mëdha që gratë e moshuara të pajtohen me atë se seksi pa pajtim mund të arsyetohet. Kryesisht, gratë pa arsim formal dhe ato që janë deklaruar si pjesë e pakicës etnike, po ashtu kanë gjasa më të mëdha ta kenë këtë qëndrim në krahasim me shkallën mesatare.

Edhe pse gratë të cilat kanë përjetuar dhunë seksuale në përgjithësi japin mbështetje, tri nga dhjetë gra (30%) besojnë se gratë që thonë se janë abuzuar, shpesh i sajajnë apo i ekzagjerojnë pretendimet për abuzim apo përdhunim, ndërsa përqindje e ngjashme mendojnë se dhuna ndaj grave shpeshherë provokohet nga viktimi (28%). Tek gratë me arsim të lartë, gjasat janë më të vogla që t'i kenë këto pikëpamje, siç janë gratë të cilat jetojnë në mjedise urbane. Sa për krahasim, 19% e grave në BE (prej 7% në Suedi deri në 43% në Maltë) janë të mendimit se gratë i ekzagjerojnë pohimet për abuzim ose përdhunim, ndërsa mesatarisht 15% e grave në BE janë të mendimit se dhuna shpeshherë shkaktohet nga viktimi, nga 6% në Holandë deri në 58% në Letoni, sipas Barometrit Special 449 të Komisionit Evropian për dhunë me bazë gjinore.⁴⁰

40 "Barometri Special 449: Dhuna me bazë gjinore".

Grafiku 3.2: Pikëpamje lidhur me dhunën ndaj grave

Sa shpesh mendoni se ndodh dhunë ndaj grave nga ana e partnerëve, nga ana e personave të njohur ose të panjohur në Maqedoninë e Veriut?



Thuaja se gjysma e grave (48%) konsiderojnë se dhuna në shtëpi është një çështje private dhe duhet të trajtohet brenda familjes, prej të cilave 31% plotësisht pajtohen me këtë. Sa për krahasim, në BE, vetëm 14% e grave do të pajtoheshin me atë se dhuna në familje është çështje private.⁴¹ Kjo shkallë varion nga 2% në Suedi deri në 31% në Rumani, që e vë në dukje faktin se aty ku ekziston traditë më e gjatë e ndërgjegjësimit në lidhje me barazinë gjinore, ekziston transparencë më e madhe që të debatohet dhuna në familje jashtë familjes.

Thuaja se gjysma e grave konsiderojnë se dhuna në shtëpi është një çështje private dhe duhet të trajtohet brenda familjes

3. Pikëpamjet lidhur me rolet gjinore dhe dhunën ndaj grave

Gratë pa arsim formal kanë më shumë gjasa të besojnë se dhuna në familje është çështje private (66%), si dhe gratë të cilat jetojnë në mjedise rurale (60%). Ngjashëm me këtë, gratë të cilat flasin shqip kanë gjasa më të mëdha ta kenë këtë pikëpamje, me ç'rast 67% pajtohen me këtë. Rrjedhimisht me këtë, gratë të cilat flasin shqip kanë më shumë gjasa të mendojnë se miqtë e tyre nuk do të pajtohen me atë se nëse burri e keqtrajton bashkëshorten e tij, të tjerët duhet të ndërhyjnë (53% e grave të cilat flasin shqip nuk pajtohen kundrejt 29% mesatarisht).

Gratë të cilat morën pjesë në sondazhin cilësor deklaruan se dhuna ndaj grave në të gjitha format është një dukuri e shpeshtë në vend, veçanërisht dhuna nga partneri intim (DHPI). Llojet e dhunës të cilat i theksuan gratë e përfshijnë dhunën fizike, psikologjike, emocionale, ekonomike/financiare dhe dhunën seksuale.

Dhuna psikologjike konsiderohet si formë më e shpeshtë e dhunës, ndërsa gratë që morën pjesë në sondazhin cilësor deklaruan se kjo dhunë për çdo ditë ndodh në marrëdhëniet intime, por më së shpeshti mbetet e pazbuluar. Sa i përket dhunës psikologjike, u shqyrtuan disa lloje të sjelljeve, duke e përfshirë edhe agresionin verbal (siç janë ofendimet), kontrollin e sjelljes, përcënimin dhe kërcënimeve ndaj grave ose anëtarëve të familjes së tyre.

“[Autorët e dhunës] më së shpeshti tentojnë ta thyejnë shpirtin tuaj, ta çrregullojnë gjendjen tuaj mendore”.

Grua, në moshë prej 35-50 vjeçare, shqiptare etnike, nga mjedisi urban

Disa lloje të dhunës fizike dhe seksuale, po ashtu konsiderohen si të zakonshme, siç është goditja me shuplakë ose detyrimi i partnerit për seks. Veprat më të dhunshme, siç është rrahja ose përdhunimi, konsiderohen më pak të pranueshme.

“Marrëdhënia seksuale me bashkëshortin madje edhe nëse atë moment nuk e dëshironi një gjë të këtillë, deri diku nënkupton dhunë seksuale, por zakonisht kjo bëhet për shkak të qetësisë dhe paqes në shtëpi”.


Grua, në moshë prej 55-74 vjeçare, maqedonase etnike, nga mjedisi urban

Kjo pasqyrohet edhe në gjetjet e sondazhit: tri nga pesë gra janë të mendimit se dhuna ndaj grave (nga partnerë ose jo-partnerë) është e zakonshme në vend (60%, me rënie në 42% tek gratë që flasin shqip). Sipas sondazhit të FRA në vitin 2012, kjo shkallë është më ulët se mesatarja e BE-së prej 78%⁴² (Grafiku 3.3). Përafërsisht një nga gjashtë gra personalisht njohin dikë në rrethin e familjes ose të miqve (17%) ose në fqinjësinë e tyre (16%), të cilat kanë qenë viktimat e dhunës.

⁴² “Survey on Violence against Women in EU (2012)”, European Union Agency for Fundamental Rights, 17 janar 2019, i aksesuar më datë 22 mars 2019, <http://fra.europa.eu/en/publications-and-resources/data-and-maps/survey-data-explorer-violence-against-women-survey>.

Grafiku 3.3: Perceptime lidhur me prezencën gjithnjë e më të madhe të dhunës ndaj grave

Sa shpesh mendoni se ndodh dhunë ndaj grave nga ana e partnerëve, nga ana e personave të njohur ose të panjohur në Maqedoninë e Veriut?



Në sondazhin cilësor, gratë që kanë përjetuar dhunë deklaruan se një formë e dhunës ishte e pranishme pothuajse në çdo marrëdhënie intime midis partnerëve dhe se gratë e fshehin këtë, meqë nuk duan ta prishin familjen. Ato theksuan detyrën e tyre që ta durojnë dhunën, duke e përfshirë edhe kontrollin mbi sjelljen, dhunën fizike dhe dhunën seksuale, për të mirë e fëmijëve të tyre dhe nuk mendojnë se situata e tyre është e pazakonshme. Në të vërtetë ato thanë se kjo është dukuri mjaft e zakonshme.

“Mikeshat durojnë dhe nuk janë të përgatitura ta denoncojnë dhunën dhe të kërkojnë ndihmë. Ato çdoherë thonë: “Do të jetë më mirë”. Për shkak të fëmijëve, ne çdoherë durojmë për të mirën e fëmijëve. Kështu e imagjinojmë jetën.”

Viktimë e dhunës, maqedonase

Gratë rome të cilat morën pjesë në sondazhin cilësor, shprehën bindje se dhuna nga partneri intim është dukuri mjaft e shpeshtë në bashkësinë e tyre. Ato deklaruan se shumica e formave të dhunës, duke e përfshirë edhe dhunën fizike, kanë qenë pjesë të jetës së përditshme të gruas rome. Një viktimë e dhunës tha se kjo është pjesë normale e jetës me gjenerata dhe se shumica e grave thjeshtë e kanë fshehur atë që u ka ndodhur, meqë nuk kanë mundur ta imagjinojnë se punët mund të jenë më ndryshe.

“Gratë janë keqtrajtuar. Ato thjeshtë e fshehin këtë, nuk i tregojnë (askujt). Nëna, gjyshe dhe vajza ... çka mund t’ju tregoj, madje edhe vajzat keqtrajtohen. Ato thjeshtë e fshehin këtë.”

Viktimë e dhunës, rome

3. Pikëpamjet lidhur me rolet gjinore dhe dhunën ndaj grave

Për më tepër, shumica e grave besojnë se dhuna ndaj grave ka qenë çdoherë problem në vend, ndërsa disa gra deklaruan se gjendja është përkeqësuar. Kryesisht, gratë e moshuara janë të mendimit se dhuna ndaj grave është bërë problem më i madh pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Sipas tyre kjo ndodhë për dy shkaqe. Ato mendojnë se shkak i parë është fakti se burrat kanë qenë më të prekur nga privatizimi sesa gratë, për shkak të së cilit, sipas fjalëve të tyre, mijëra njerëz mbetën pa punë ose janë bërë tepriçë teknologjike dhe kjo ka ndikuar negativisht mbi vetëbesimin e burrave dhe mbi pozitën e tyre në familje dhe shoqëri. Kjo, siç thanë ato, kontribuoi në rritjen e tendencës së sjelljes së dhunshme të burrave dhe të tjerëve si mënyrë për ruajtjen e ndjenjës së fuqisë. Shkak i dytë, sipas tyre, ishin institucionet më të dobëta pas shpërbërjes së Jugosllavisë, me ç'rast përgjigja institucionale ndaj dhunës nuk ishte edhe aq efektive si më parë. Në të vërtetë, burrat druan më pak nga pasojat e ushtrimit të dhunës.

“Kah mesi i vitit 1990 ishte koha kur privatizimi kishte ndikim më të madh mbi burrat dhe gratë. Nëse që të dy bashkëshortët mbeteshin pa punë, grua ka pasur mundësi më të mëdha për të gjetur punë, ndërsa burri ka qenë më përzgjedhës dhe ka refuzuar të kryej punë të cilën nuk e ka dashur. Kështu që burrat kanë qëndruar në shtëpi pa punë. Ishte krizë e madhe në nivel emocional e që rezultoi me shumë probleme ... “

Grua, në moshë prej 55-74 vjeçare, maqedonase etnike, nga mjedisi urban



Një nga katërbëdhjetë gra në moshë prej 18 deri 74 vjeçare pohuan se kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jo-partneri që në moshën e saj 15 vjeçare.



Një nga dhjetë gra në moshë prej 18 deri 74 vjeçare të cilat në të kaluarën kanë pasur partner deklaruan se kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga ana e partnerit intim nga mosha 15 vjeçare.



Dhuna psikologjike e ushtruar nga partneri ka ndikuar në më shumë se dy nga pesë gra të cilat në të kaluarën kanë pasur partner në jetën e tyre.



Tri nga dhjetë gra në moshë prej 18 deri 74 vjeçare pohuan se janë ngacmuar seksualisht nga mosha 15 vjeçare.

4. Dhuna ndaj grave në Maqedoninë e Veriut

4.1: Dhuna fizike dhe seksuale nga partneri intim

Thuaja se gjysma (45%) e grave në vend, të cilat në të kaluarën kanë pasur partnerë, deklaruan se kanë përjetuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale nga ana e partnerit intim nga mosha 15 vjeçare. Në pjesën më të madhe, kjo dhunë është psikologjike (deklaruan 44% e të gjitha grave, përkatësisht 44% e grave të cilat flasin në gjuhën maqedonase dhe 43% e grave të cilat flasin në gjuhën shqipe), megjithatë përafërsisht një nga dhjetë gra (gjithsej 9%, prej të cilave 10% e grave të cilat flasin në gjuhën maqedonase dhe 5% e grave të cilat flasin në gjuhën shqipe) gra të cilat në të kaluarën kanë pasur partner thonë se kanë përjetuar dhunë fizike⁴³ nga partneri aktual ose nga partneri i mëparshëm, ndërsa 3% (po ashtu gra të cilat flasin në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe) deklaruan se kanë përjetuar dhunë seksuale.⁴⁴ Gjasat janë më të mëdha që gratë të tregojnë për dhunën në lidhjen paraprake sesa për lidhjen aktuale.

Gjasat janë dukshëm më të mëdha, që gratë të cilat nuk dinë të gjinden (15%) ose aspak nuk dinë të gjinden (21%) me të ardhurat e tyre aktuale, të tregojnë se kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim nga mosha 15 vjeçare (10%) si dhe ato të cilat momentalisht janë të papunësuar (14%). Gratë të cilat jetojnë në mjedise rurale (7%) dhe ato puna kryesore e të cilave është përmbushja e obligimeve familjare (5%) kanë tendencë më të vogël të tregojnë se kanë përjetuar dhunë, nga mesatarja.

43 Në lidhje me **dhunën fizike** të anketuarave në sondazh iu parashtruan pyetjet vijojnë vijimë: A ju ka ndodhur që dikur / partneri aktual / partneri i mëparshëm ndonjëherë 1) ju ka shtyrë? 2) ju ka goditur me shuplakë? 3) ka hedhur send të fortë ndaj jush? 4) ju ka kapur ose ju ka tërhequr për flokësh? 5) ju ka rrahur me grushte ose me send të fortë, apo ju goditur me shqelma? 6) ju ka djegur? 7) ka bërë përpjekje t'jua zë frymën ose t'u mbys? 8) Ju ka prerë ose shpuar, apo ka qëlluar drejt jush? 9) Jua ka përplasur kokën në diçka? Në këtë raport prevalenca e dhunës fizike bazohet në deklaratat e grave të anketuara të cilat thanë se kanë përjetuar më së paku një nga këto forma të dhunës, së paku në një rast. Prevalenca e dhunës fizike ka të bëjë me partnerin aktual, ish-partnerët, për çdo partner intim (aktual ose paraprak) dhe për jo-partnerë. Periudha referente për dhunën nga jo-partneri është nga mosha 15 vjeçare deri në periudhën prej 12 muajve para sondazhit, ndërsa për dhunën nga partneri periudha referente ka të bëjë me kohën e marrëdhënies së tyre ose në 12 muajt para sondazhit.

44 Në lidhje me **dhunën seksuale**, gratë u pyetën: Nga mosha juaj 15 vjeçare dhe gjatë 12 muajve të fundit, sa shpesh dikush 1) ju ka detyruar në marrëdhënie seksuale në atë mënyrë që ju ka mbajtur nën tryzni ose në ndonjë mënyrë ju ka lënduar? 2) Përveç kësaj, të kryeni marrëdhënie seksuale duke ju mbajtur me forcë ose duke ju lënduar në ndonjë mënyrë. Me marrëdhënie seksuale? 3) Përveç kësaj, të merrni pjesë në ndonjë formë aktiviteti seksual kur ju nuk dëshironit ta bënit ose kur nuk ishit në gjendje të refuzonit? 4) Keni pranuar të kryeni aktivitet seksual sepse kishit frikë nga ajo që mund t'ju ndodhte nëse do të refuzonit? Prevalenca e dhunës seksuale mbështetet mbi të anketuarit të cilët thanë se kanë përjetuar më së paku një prej këtyre formave të dhunës së paku në një situatë. Prevalenca e dhunës seksuale ka të bëjë me partnerin aktualë, me ish-partnerët, me partnerin intim (aktual ose paraprak) dhe me jo-partnerë. Periudhat referente janë të njëjta si ato më lartë.

Grafiku 4.1: Prevalenca e dhunës fizike dhe seksuale nga partneri intim




Tabela 4.1: Prevalenca e dhunës fizike dhe seksuale sipas gjuhës

Sa shpesh ju ka ndodhur diçka e këtillë? Partneri juaj aktual/i mëparshëm ka ushtruar...

	Gratë që flasin maqedonisht % ka ndodhur ndonjëherë		Gratë që flasin shqip % ka ndodhur ndonjëherë	
	%	Nr. Gratë	%	Nr. Gratë
Dhunë fizike				
Partner aktual	7	(1,120)	3	(400)
Partner i mëparshëm	10	(581)	28	(33*)
Cilido partner	10	(1,359)	5	(419)
Dhunë seksuale				
Partner aktual	2	(1,120)	1	(400)
Partner i mëparshëm	4	(581)	19	(33*)
Çfarëdo partneri	3	(1,359)	3	(419)
Dhunë fizike dhe seksuale				
Partner aktual	8	(1,120)	4	(400)
Partner i mëparshëm	11	(581)	36	(33*)
Cilido partner	11	(1,359)	5	(419)

BAZA: Të gjitha gratë në Maqedoninë e Veriut të grup moshës 18-74 vjeç me një partner aktual, partner të mëparshëm, ose çfarëdo partner, në kursiv

BURIM: Sondazhi i drejtuar nga OSCE për dhunën ndaj grave (2018)

*Kujdes: madhësi e ulët e BAZËS

Shifrat në të kuqe tregojnë se dallimi është statistikisht i rëndësishëm

Dallimet e prevalencës sipas vendeve

Është me rëndësi të theksohet se vendet me tradita më të gjata të politikave për barazi gjinore dhe të fushatave të ndërgjegjësimit (vendet nordike dhe Evropa Perëndimore) kanë shkallë më të lartë të grave të cilat flasin për përvojat e dhunës.

Për shembull, sipas sondazhit të FRA në BE, tre vendet në të cilat gjasat janë më të mëdha që gratë të tregojnë se kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri ose jo-partneri nga moshë 15 vjeçare është Danimarka (52%), Finlanda (47) dhe Suedia (36%). Prevalenca është më e ulët në Kroaci (21%), Austri (20%) dhe Poloni (19%).

Prevalenca e theksuar e dhunës nga partneri intim është më e ulët nga ajo në BE, ku mesatarisht 20% e grave thonë se kanë përjetuar dhunë fizike (nga 11% në Austri, Kroaci dhe Spanjë deri në 31% në Letoni) dhe 7% thonë se kanë përjetuar dhunë seksuale (nga 3% në Kroaci dhe Portugali deri në 11% në Danimarkë, Finlandë dhe Holandë).

Gratë të cilat morën pjesë në sondazhet cilësore shprehën besimin se DHPI është dukuri mjaft e shpeshtë në vend, megjithatë gjasat janë të vogla që gratë që e kanë përjetuar të flasin për atë ose ta denoncojnë. Së këtejmi, gratë të cilat morën pjesë në sondazhet cilësore thanë se janë të mendimit se dhuna fizike dhe seksuale konsiderohet si më pak e zakonshme dhe më pak e pranueshme nga dhuna psikologjike në shoqëri, madje thanë se viktimat disa vepra i konsiderojnë si të padëshiruara por të parëndësishme siç është shuplaka ose detyrimi i grave për seks. Veprat siç është rrahja dhe përdhunimi konsiderohen si forma më pak të pranuar të DHPI, megjithatë gratë të cilat morën pjesë në sondazhin besojnë se madje edhe këto lloje të dhunës nuk janë të pazakonshme dhe mbase gratë të cilat i kanë përjetuar nuk do t'i denoncojnë.

Gratë rome dhunën fizike e përshkruajnë si një dukuri mjaft të shpeshtë në komunitetin e tyre. Ato thanë se bashkëshorti mund ta godas bashkëshorten madje edhe për punë të parëndësishme, si për shembull, gjella e zier më shumë se ç' duhet ose gjella me pak kripë. Ato besojnë se gjasat që ato të përjetojnë dhunë të këtyllë janë të mëdha në krahasim me gratë e tjera të vendit dhe thanë se nuk besojnë se njerëzit brenda ose jashtë komunitetit të tyre janë shqetësuar për këto përvoja.

“Kjo për ne është si “mirëmëngjes”, “mirëdita”, do të shajë, do të godasë, do të ngrihesh, do ta dëgjosh dhe kaq. Askush nuk pyet si ndihesh.”

Grua, në moshë prej 20-40 vjeçare, rome etnike, nga mjedisi urban

Goditja me shuplakë ose shtyrja janë format më të shpeshta të dhunës së ushtruar nga partnerët aktual dhe nga ish-partnerët (Tabela 4.2). Kjo është e krahasueshme me rezultatet e BE, ku mesatarisht, këto lloje të dhunës fizike kanë qenë më të pranishme.

Dhjet përqind e grave të cilat kanë ose kanë pasur partner intim ndonjëherë, thanë se kishin përjetuar dhunë fizike ose seksuale nga partneri

Tabela 4.2: Forma të dhunës fizike nga partneri intim

Sa shpesh partneri juaj aktual / partneri i mëparshëm ua ka bërë këtë?

	Partner aktual % ka ndodhur ndonjëherë	Partner i mëparshëm % ka ndodhur ndonjëherë
Ju ka qëlluar me shuplakë?	5	7
Ju ka shtyrë apo ju ka rrëzuar?	3	7
Ju ka goditur me një objekt të fortë?	1	3
Ju ka kapur ose ju ka shkukur flokët?	1	4
Ju ka rrahur me grusht ose me objekt të fortë, ose ju ka shqelmuar?	1	4
Ju ka djegur?	0	0
Është përpjekur t'ju marrë frymën ose t'ju mbysë?	0	2
Ju ka prerë ose ju ka goditur me thikë, ose ju ka qëlluar me armë zjarri?	0	1
Ju ka përplasur kokën pas diçkaje?	0	2

BAZA: Të gjitha gratë në Maqedoninë e Veriut të grup moshës 18-74 vjeçare me partner aktual (1,520) ose partner të mëparshëm (614)
BURIM: Sondazhi i drejtuar nga OSCE për dhunën ndaj grave (2018)

Në mesin e grave të cilat momentalisht kanë partnerë, 2% deklaruan se kanë përjetuar dhunë seksuale, ndërsa prevalenca e dhunës seksuale nga partneri i mëparshëm është 4%. Dhunën seksuale të cilën e kanë përjetuar 3% e grave të cilat në të kaluarën kanë pasur partner paraqitet në disa forma (Tabela 4.3).

Tabela 4.3: Forma të dhunës seksuale nga partneri intim

Sa shpesh partneri juaj aktual / partneri i mëparshëm ua ka bërë këtë?

	Partner aktual % ka ndodhur ndonjëherë	Partner i mëparshëm % ka ndodhur ndonjëherë
Përveç kësaj, është përpjekur t'ju detyrojë të kryeni marrëdhënie seksuale duke ju mbajtur me forcë ose duke ju lënduar në ndonjë mënyrë?	1	4
Ju ka detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale duke ju mbajtur me forcë ose duke ju lënduar në ndonjë mënyrë?	1	3
Përveç kësaj, ju ka detyruar të merrnit pjesë në ndonjë formë aktiviteti seksual kur ju nuk dëshironit ta bënit ose kur nuk ishit në gjendje të refuzonit?	1	2
Keni pranuar të kryeni aktivitet seksual sepse kishit frikë nga ajo që ndonjë nga partnerët tuaj të mëparshëm mund t'ju bënte nëse do të refuzonit?	1	3

BAZA: Të gjitha gratë në Maqedoninë e Veriut të grup moshës 18-74 vjeçare me partnerin aktual (1,520) ose partneri i mëparshëm (614)
BURIM: Sondazh i drejtuar nga OSCE për dhunën ndaj grave (2018)

Në diskutimet cilësore, gratë deklaruan se dhuna seksuale në marrëdhënie është gjerësisht dhe shpesh e pranuar në shoqëri si sjellje normale. Gratë deklaruan se seksi me detyrim ose nën trysni me partnerin është i padëshiruar, por marrë në përgjithësi konsiderohet si dukuri e pranueshme në shoqëri. Ato thanë se asnjëherë as që do të mendojnë ta denoncojnë rastin kur janë detyruar të bëjnë seks me partnerin e tyre, meqë konsiderojnë se ideja e përdhunimit në martesë është absurde. Pikëpamjet e këtilla ndikojnë mbi prevalencën e ulët të sondazhit në krahasim me shkallën mesatare në BE,⁴⁵ për të gjitha llojet e dhunës.

“Ata do t’ju tallin nëse tregoni se ju ka përdhunuar bashkëshorti Ja, me automatizëm, duhet të shkoni me bashkëshortin në krevat; pa marrë parasysh se a ju pëlqen ose jo, por duhet.”

Grua, në moshë prej 35-54 vjeçare, maqedonase etnike, nga mjedisi urban

Gratë të cilat kanë përjetuar DHPI seksuale theksuan situata në të cilat dhuna ka zgjatur në vazhdimësi për disa vite dhe është përdorur si formë e kontrollit nga ana e partnerëve të tyre. Një grua ka treguar se si shpeshherë ka qenë nën trysni dhe madje periodikisht edhe e detyruar të bëjë seks me partnerin e saj dhe nuk i është lejuar të përdor asnjë mjet kontracëpsioni. Si rezultat i kësaj, ajo 17 herë ka mbetur shtatzënë gjatë martesës së saj, që ka rezultuar me dy fëmijë dhe 15 aborte.

“Çdo vit mbesja shtatzënë. Nuk më lejonte të pijë hapa kontracepsioni, ... të mbrohem nga shtatzënia. Pata 15 aborte dhe linda dy fëmijë, gjithsej 17, nga dy çdo vit.”

Viktimë e dhunës, maqedonase

Shabllone të dhunës nga partneri intim⁴⁶

Të dhënat sugjerojnë se dhuna në marrëdhënien aktuale ka tendencë që vazhdimisht të përsëritet, përkatësisht gratë të cilat kanë përjetuar dhunë nga partneri intim kanë tendencë më të madhe të tregojnë se dhuna ka ndodhur më shumë se një herë dhe se nuk ka qenë incident i izoluar dhe se ka ndodhur në periudha të gjata kohore.

Nga gratë të cilat deklaruan se incidenti i parë i dhunës fizike dhe/ose seksuale nga partneri aktual e kanë përjetuar pesë ose më shumë vjet para sondazhit, 21% e kanë përjetuar incidentin e fundit në 12 muajt para sondazhit, ndërsa 12% thanë se incidenti i fundit ka ndodhur para një deri katër vite.

Thuaja se nëntë nga dhjetë gra kanë jetuar me partnerin aktual në kohën e incidentit të tyre të parë të dhunës nga ana e partnerit aktual (87% në krahasim me 82% në BE), ndërsa 47% nga ish-partnerët kanë jetuar me të anketuarën në kohën e incidentit të parë të dhunës (ose kërcim për dhunë), në krahasim me 65% në BE.

Në mesin e të anketuarave, të cilat kanë qenë shtatzënë gjatë kohës së marrëdhënies së tyre me partnerin e tyre dhe të cilat kanë përjetuar dhunë (ose kërcënime për dhunë) gjatë kohës lidhjes, 16% e viktimave të dhunës nga partneri aktual thanë se dhuna fizike ose seksuale ka ndodhur gjatë shtatzënisë, në krahasim me 20% në vendet e BE-së. Ekuivalenca e dhunës së ish partnerit është 46% (në krahasim me 42% në BE), por duke e pasur parasysh bazën shumë të ulët (23 gra të anketuara), këto të dhëna duhet të merren me rezervë.

Në anketën e grave, të cilat kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale nga ana e partnerit intim, u kërkua të japin detaje plotësuese për një incident të cilin e konsiderojnë si më serioz gjatë jetës. Ato të cilat kanë përjetuar dhunë nga partneri aktual, si incidente më serioze i theksuan goditjet ose shtyrjen (përmendur nga 42%, përkatësisht 20%). Goditjet (30%) dhe shtyrjet (23%), gjithashtu, janë në mesin e llojeve më të shpeshta të dhunës të cilat paraqiten si incidenti më serioz i dhunës nga partneri i mëparshëm, por më shpesh përmenden kërcënimet për dhunë fizike, nga ana e 31% e të anketuarave (në krahasim me 17% për dhunë nga partneri aktual). Grabitja ose tërheqja e flokëve ka dyfish më shumë gjasa të jetë incidenti më serioz i dhunës nga partneri i mëparshëm në krahasim me incidentin më serioz të dhunës nga partneri aktual (17% kundrejt 9%).

46 Përderisa shkalla e denoncimit / prevalenca e dhunës fizike dhe seksuale, e shqyrtuar më lartë, nuk i përfshinë kërcënimet për dhunë e këtyllë, çështjet e tjera lidhur me atë se kur ka ndodhur dhuna e këtyllë, dhe detajet për incidentet më të rënda përfshijnë kërcënime për dhunë.

Tabela 4.4: Incidente më serioze të dhunës nga partneri intim

Do të kisha dashur të mendoni për incidentin më serioz nga partneri aktual/partneri i mëparshëm. Çka nga kjo që është theksuar në kartelë ju ka ndodhur në atë kohë? Si incident “më serioz” mendojmë për incidentin i cili ka pasur ndikim më të madh ndaj jush.

	Partner aktual %	Partner i mëparshëm %
Ju kanë qëlluar me shuplakë	42	30
Ju kanë shtyrë apo ju kanë rrëzuar	20	23
Ju kanë kërcënuar se do t'ju lëndonin fizikisht	17	31
Ju kanë kapur ose ju kanë shkukur flokët	9	17
Ju kanë goditur me një objekt të fortë	9	8
Ju kanë rrahur me grusht ose me objekt të fortë, ose ju kanë shqelmuar	8	9
Ju kanë detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale duke ju mbajtur me forcë ose duke ju lënduar në ndonjë mënyrë.	5	7
Keni pranuar të kryeni aktivitet seksual sepse kishit frikë nga ajo që mund t'ju ndodhte nëse do të refuzonit.	5	5
Janë përpjekur t'ju marrin frymën ose t'ju mbysin	4	6
Janë përpjekur t'ju detyrojnë të kryeni marrëdhënie seksuale duke ju mbajtur me forcë ose duke ju lënduar në ndonjë mënyrë.	3	6
Ju detyruan të merrni pjesë në ndonjë formë aktiviteti seksual kur ju nuk dëshironit ta bënit ose kur nuk ishit në gjendje të refuzonit.	3	4
Ju kanë përplasar kokën pas diçkaje	1	3
Ju kanë kërcënuar me akte të dhunshme seksuale (siç është përdhunimi, shtatzënia e detyruar etj) në mënyrë të tillë që vërtet ju ka frikësuar?	0	4
Ju kanë djegur	0	1
Ju kanë prerë ose ju kanë goditur me thikë, ose ju kanë qëlluar me armë zjarri	0	1

BAZA: Të gjitha gratë në Maqedoninë e Veriut të grup moshës 18-74 vjeçe që kanë përjetuar dhunë nga një partner aktual (116) ose partner i mëparshëm (76)

BURIM: Sondazh i drejtuar nga OSCE për dhunën ndaj grave (2018)

Dhuna fizike dhe seksuale në 12 muajt para sondazhit

Tre për qind e grave deklaruan se kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale në 12 muajt e fundit para sondazhit (nuk ka dallim ndërmjet grave që flasin maqedonisht dhe grave që flasin shqip). Forma më e përhapur e dhunës nga partneri aktual në 12 muajt e fundit para sondazhit janë goditjet ose shtyrja, 1% e grave deklaruan se kanë përjetuar një dhunë të këtyllë nga partneri aktual.

Së këtejmi, pak më pak se gjysma (47%) e incidenteve më serioze nga partneri aktual kanë ndodhur më shumë se një vit para sondazhit, më shumë se një e treta (38%) e incidenteve më serioze kanë ndodhur në 12 muajt para sondazhit.

4.2: Dhuna psikologjike nga partneri intim

Gratë të cilat morën pjesë në sondazhet cilësore deklaruan se dhuna psikologjike është forma më e shpeshtë e DHPI në vend dhe se shoqëria në përgjithësi e injoron këtë lloj të dhunës. Gratë shprehën bindje se shoqëria dhunën psikologjike e konsideron si diçka që nuk është serioze ose e dëmshme. Megjithatë, ato thanë se dhuna psikologjike e ushtruar nga partneri është njëra nga format më të dëmshme të dhunës dhe se mund të ndikojë në të gjitha segmentet e jetës së gruas. Dhuna psikologjike, siç thonë ato, mund ta frikësojë gruan, t'ia çrregullojë gjumin, t'ia cenojë vetëbesimin dhe ta pamundësojë të kënaqet në të gjitha segmentet e tjera të jetës së saj.

Dhuna psikologjike të cilën e kanë përshkruar gratë e ka përfshirë sjelljen e kontrolluar (për shembull, t'i tregohet gruas si të vishet dhe t'i kontrollohet telefoni), keqtrajtim verbal, përcënim dhe kërcënime. Keqtrajtimi verbal perceptohet si një dukuri mjaft e shpeshtë dhe si pjesë e jetës së përditshme tek një numër i madh grave. Sjellja e kontrolluar perceptohet si diçka e keqe, por megjithatë është një dukuri mjaft e shpeshtë, dhe diçka të cilën pritet që gratë ta durojnë.

“Kolegia ime ka një burrë shumë xheloz. Ai i bën shumë punë të çuditshme ... ajo vazhdimisht është nën trysni, e pyet për çdo gjë që bën, e kontrollon telefonin e saj, madje ia kontrollon edhe kartelën e saj të punës që të shoh se kur hyn dhe kur del nga puna, ia kalkulon kohën e nevojshme që të kthehet në shtëpi ... ndërsa ajo edhe më tutje e duron këtë...”

Grua, në moshë nga 55-74 vjeçare, maqedonase etnike, nga mjedisi urban

Gratë të cilat morën pjesë në sondazhin cilësor, po ashtu tregojnë për shqetësimet e tyre në lidhje me mënyrën e shfrytëzimit të teknologjisë nga ana e burrave që të ushtrojnë dhunë psikologjike. Tani, grujat jo vetëm që është e detyruar nga partneri të ketë marrëdhënie seksuale, por ka mundësi edhe të regjistrohet derisa bën seks ndërsa regjistrimi të shfrytëzohet kundër saj.

“Me teknologjinë aktuale, regjistrimet, video-regjistrimet të marrëdhënieve seksuale, çka do qoftë [mund të përdoren si shantazh]. Kjo është shqetësuese.”

Grua, në moshë nga 35-54 vjeçare, maqedonase etnike, nga mjedisi urban

Dhunën psikologjike gratë e përshkruajnë si formë të torturës së përditshme që shfrytëzohet në marrëdhëniet e tyre. Ato thanë se dhuna psikologjike është çdoherë e pranishme krahas të gjitha llojeve të tjera të dhunës që i përjetojnë gratë dhe se ka ndikim afatgjatë mbi shëndetin mendor të gruas.

“Dhuna psikologjike është torturë. Nëse ka torturë, ndërsa ai shfrytëzon dhunë fizike, është normale që ajo të ketë çrregullime psikologjike”.

Grua, në moshë nga 18-34 vjeçare, shqiptare nga mjedisi rural

Duke e pasur parasysh ndikimin e dhunës psikologjike, shqetëson fakti se gjetjet e sondazhit vunë në dukje se dhuna psikologjike është forma më e shpeshtë e dhunës nga partneri intim, me ç'rast më shumë se dy nga pesë gra të cilat në të kaluarën kanë pasur partner (44%) deklaruan se kanë përjetuar dhunë të këtyllë (44% e grave të cilat flasin në gjuhën maqedonase në krahasim me 43% të grave të cilat flasin në gjuhën shqipe), që është e ngjashme me mesataren e BE-së prej 43%. Përqindja më e madhe e grave që janë në lidhje në Maqedoninë e Veriut deklaruan se kanë përjetuar dhunë psikologjike nga partneri intim në 12 muajt para sondazhit.⁴⁷

Më tepër se dy gra nga pesë thanë se kishin përjetuar dhunë psikologjike nga partneri i tyre aktual ose ish partneri

Format e ndryshme të dhunës psikologjike që u përfshinë me pyetjet u kategorizuan në katër llojet gjithëpërfshirëse si vijojnë.⁴⁸

Dhuna ekonomike, e cila e përfshinë pengimin e pasjes në dispozicion të financave familjare, si dhe pengimin e blerjes autonome dhe ndalim që partneri të punoj jashtë shtëpisë.

Kontrollimi i sjelljes, përfshinë situata me ç'rast partneri përpiket ta pengoj gruan që të takohet me miqtë e saj, *e kufizon në shfrytëzimin e faqeve në mediat sociale (siç është Facebook, Twitter etj.)*, përpiket ta kufizoj kontaktin me familjen ose familjarët e saj, insiston ta dijë se ku gjendet me atë që e tejkalon kujdesin e zakonshëm, hidhërohet nëse flet me ndonjë burrë tjetër, dyshon se nuk është besnike, *ia ndalon përdorimin e mjeteve të kontracepsionit ose në mënyrë tjetër i kufizon vendimet për planifikimin e familjes, e pengon ta kryej arsimin ose të regjistrohet në ndonjë kurs të ri edukativ, dëshiron që ai të vendos për veshmbathjet e saj ose pret që ajo t'i kërkoj leje që të shkoj te mjeku.*

Sjellje ofenduese, përfshinë situata me ç'rast partneri në përgjithësi ia ndalon gruas të largohet nga shtëpia ose ia ndalon të largohet nga shtëpia pa u shoqëruar nga ndonjë familjar, ia merr çelësat e automobilin dhe e mbyll me dry, e përçmon ose nënçmon para të tjerëve ose edhe kur janë vet, me qëllim e frikëson ose ia fut frikën (për shembull, me ngritje zëri ose me thyerje të gjësendeve), e detyron të shikoj material pornografik kundër vullnetit të saj, i kërcënohet se do ta lëndoj fizikisht, ose do ta vras dikë të cilin ajo e do (përveç fëmijëve të saj), i kërcënohet se do ta lëndoj fizikisht, me akte të detyrueshme seksuale (si përdhunimi, shtatzënia me detyrim etj.) *e lëndon ose i kërcënohet se do ta lëndoj gjatë vizitës, marrjes dhe kthimit të fëmijëve të saj (vetëm partneri i mëparshëm).*

I shfrytëzon fëmijët e gruas që ta shantazhojë ose i keqtrajton fëmijët e saj, ku përfshihet kërcënimi se do t'ia marrë fëmijët, se do t'i lëndoj fëmijët, se do t'i dëmtoj ose i kërcënohet rreth kujdestarisë mbi fëmijët e saj (vetëm partneri i mëparshëm).


47 Shih: Aneksi 3, SDG 5.2.1 për detajet për atë se si llogaritet prevalenca e dhunës psikologjike në 12 muajt para sondazhit.

48 Pyetjet për format e dhunës psikologjike në kurziv nuk janë përfshirë në sondazhin e FRA.

Grave të cilat janë në lidhje iu parashtrua pyetja, a thua ndonjëra nga këto punë ndodh ngandongjëherë, shpeshherë ose gjatë gjithë kohës, ose asnjëherë, ndërsa gratë të cilat kanë pasur lidhje në të kaluarën u pyetën se a thua dikush nga ish-partnerët e tyre ndonjëherë ua ka bërë ndonjërin nga këto punë.⁴⁹

Marrë në përgjithësi, 36% e grave të cilat në të kaluarën kanë pasur partnerë kanë përjetuar sjellje të kontrolluara, me ç'rast kjo formë e dhunës është më shumë e përhapur në lidhjet aktuale sesa në lidhjet paraprake. Rreth një e katërta e grave të cilat në të kaluarën kanë pasur partnerë kanë përjetuar sjellje ofenduese (24%), ndërsa 10% kanë përjetuar dhunë ekonomike. Në mesin e grave, të cilat në të kaluarën kanë pasur partnerë dhe të cilat kanë fëmijë, 4% deklaruan se janë shantazhuar me fëmijët e tyre ose fëmijët e tyre janë abuzuar nga partneri.

Grafiku 4.2: Prevalenca e formave të ndryshme të dhunës psikologjike nga partneri intim



Nuk ekzistojnë dallime në prevalencën e këtyre katër llojeve të dhunës psikologjike midis grave të cilat flasin në gjuhën shqipe dhe grave të cilat flasin në gjuhën maqedonase.

Sa i përket llojeve specifike të dhunës psikologjike, format më të shpeshta që u përmendën se janë ushtruar nga ana e partnerëve aktual janë: partneri hidhërohet nëse gruaja flet me ndonjë burrë tjetër (19%), insiston ta dijë se ku është (16%), e nënçmon (14%), do të vendos çfarë rrobash të vesh gruaja (10%) dhe përpiqet ta pengojë të takohet me miqtë e saj (10%).

Këto lloje të dhunës psikologjike janë po ashtu format më të shpeshta për të cilat gratë deklaruan se janë ushtruar nga ish-partnerët. Këtu, në mënyrë plotësuese theksuan: ka dyshuar se po e tradhtonte (19%), ka bërë punë për ta frikësuar (12%) dhe e ka përçmuar para të tjerëve (10%).

Këto rezultate korrespondojnë me gjetjet në BE, ku tre format më të pranishme të dhunës psikologjike janë: përçmim kur janë vetë, ta dijë ku ndodhet gruaja në mënyrë që e tejkalon kujdesin e zakonshëm dhe i hidhërohet nëse flet me ndonjë burrë ose grua tjetër.

49 Në lidhje me kërcënimet nga dhuna fizike ose seksuale, gratë u pyetën se sa herë partneri i tyre aktual dhe/ose -partneri i mëparshëm e ka bërë një gjë të këtillë dhe sa shpesh në 12 muajt para sondazhit.

4.3: Ndjekje

Prevalenca e ndjekjes përcaktohet si përqindje e grave të cilat deklaruan se kanë përjetuar së paku një nga tetë llojet e ndjekjes.⁵⁰ Marrë në përgjithësi, 7% e grave deklaruan se kanë përjetuar ndjekje nga mosha 15 vjeçare (8% e grave të cilat flasin në gjuhën maqedonase dhe 4% e grave të cilat flasin në gjuhën shqipe), ndërsa 2% thanë se janë ndjekur në 12 muajt para sondazhit (njëlloj për të dy grupet). Kjo shkallë është më e ulët se mesatarja e BE prej 18%. Atje rezultatet lëvizin nga 8% në Rumani deri në 33% në Suedi.

Në Maqedoninë e Veriut gratë më të reja (11%), nxënësit (17%), ato që janë punësuar (10%), ato me arsim të lartë (10%), ato që jetojnë në mjedise urbane (9%) dhe ato të cilat kanë pasur partner në të kaluarën (12%) kanë gjasa më të mëdha sesa mesatarisht të tregojnë se janë ndjekur.

Ai që e kryen ndjekjen shpeshherë është i panjohur (53%), megjithatë viktimat e ndjekjes si autorë shpeshherë i theksuan edhe ish-partnerët ose ish-të dashurit (30%).

Tek më shumë se një e treta e incidenteve më serioze (28%), ndjekja ka zgjatur disa ditë, por thuajse gjysma e rasteve kanë zgjatur më së paku disa muaj (48%). Në 13% të rasteve ndjekja ka zgjatur mbi 10 vjet.

Forma më shpesh e përjetuar e ndjekjes, është kur personi është paraqitur në telefon dhe ka ofenduar, është kërcënuar ose ka heshtur, për të cilën 4% nga të gjitha gratë deklaruan se e kanë përjetuar që në moshën 15 vjeçare. Pas kësaj, vijon ndjekja e qëllimshme gjithandej, qëndrimi apo pritja para shtëpisë, shkollës ose vendit të punës; dhe dërgimi i mesazheve elektronike, mesazheve SMS ose instant mesazheve. Secila nga këto forma u përmendën nga 2% e grave të anketuara. Këto lloje të ndjekjes po ashtu janë llojet më shpesh të treguara, më së shpeshti si incidente më serioze. Gjashtë për qind e atyre që janë ndjekur deklaruan se një gjë e këtillë ju ndodhë edhe më tutje.

Autorët e incidenteve më serioze përsëri në të shumtën e rasteve janë persona të cilët gratë nuk i njohin (35%) ose partneri i mëparshëm ose i dashuri (29%). Sa i përket incidentit më serioz, autorët më së shpeshti kanë vepruar vet (69%), por njëra nga pesë viktimat nuk e ka ditur se sa persona kanë qenë të përfshirë.

Në më shumë se shtatë nga dhjetë raste, përvoja më serioze me ndjekjen, ka ndikuar që gruaja të ndihet e shqetësuar (71%). Ndjenja e mërzitjes (51%), ndjenja e zemërimit (43%) dhe ndjenja e frikës (39%) janë po ashtu reaksione të zakonshme emocionale. Pasojat psikologjike afatgjate përfshijnë vështirësi gjatë gjumit (25% e grave në rastin më serioz) ndjenjën e brishtësisë (14%) dhe depresionit (13%).

Sa i përket incidentit më serioz të ndjekjes, 70% e grave për një gjë të këtillë kanë biseduar me miqtë ose familjarët; në BE, 77% e grave e kanë bërë të njëjtën. Në më shumë raste, gratë deklaruan se diçka kanë ndërmarrë: 48% i janë kundërvënë autorit (43% në BE), 21% i kanë mbyllur llogaritë në rrjetet sociale (7% në BE), ndërsa 20% e kanë ndërruar numrin e telefonit/adresën e e-postës (23% në BE). Në Maqedoninë e Veriut janë shpërngullur më pak gra (6%) sesa në BE (14%). Në 30% të rasteve, gruaja i është kërcënuar autorit me padi gjyqësore, ngjashëm me përqindjen që e kanë bërë të njëjtën në BE (32%). Thuaja se një nga pesë gra (18%) kanë shkuar personalisht në polici, përsëri ngjashëm me shkallën në BE.

50 Në lidhje me ndjekjen, grave në anketë iu parashtruan pyetjet në vijim: Nga mosha juaj 15 vjeçare/në 12 muajt e fundit, a ekziston person që ju ka bërë një ose më shumë gjëra prej këtyre: 1) Ju ka dërguar emaille, mesazhe (SMS) ose mesazhe çasti që ishin ofenduese ose kërcënuese? 2) Ju ka dërguar letra ose kartolina që ishin ofenduese ose kërcënuese? 3) Ju ka bërë telefonata ofenduese, kërcënuese ose telefonata të heshtura? 4) Ka postuar komente ofenduese rreth jush në internet? 5) Ka ndarë fotografi ose video intime tuajat, në internet ose me celular? 6) Është vërtitur ose ka pritur për ju jashtë shtëpisë suaj, vendit tuaj të punës ose shkollës, pa ndonjë arsye legjitime? 7) Ju ka ndjekur qëllimisht nga mbrapa? 8) Ka ndërhyrë qëllimisht në pronën tuaj ose e ka dëmtuar atë? Prevalenca e ndjekjes/përgjimit të fshehtë bazohet nga të anketuarit të cilët kanë denoncuar se kanë përjetuar një ose më shumë forma të ndjekjes/përgjimit të fshehtë të përmendura më lartë.

Tri nga dhjetë gra kanë përjetuar dhunë seksuale që nga mosha 15 vjeçare


4.4: Ngacmimi seksual

Tri nga dhjetë gra (30%) kanë përjetuar një ose më shumë forma të ngacmimit seksual⁵¹ (siç është prezantuar në Grafiku 4.3) në një moment të caktuar të jetës nga mosha 15 vjeçare e deri më sot, ndërsa një nga dhjetë gra (10%) deklaruan se janë ngacmuar seksualisht në 12 muajt para sondazhit.

Prevalenca individuale e ngacmimit seksual është në masë të konsiderueshme më e ulët nga mesatarja në BE prej 55%, dhe lëvizë nga 24% në Bullgari, 41% në Kroaci deri në 81% në Suedi. Marrë në përgjithësi, vendet me tradita më të gjata të politikave për barazi gjinore dhe fushatave të ndërgjegjësimit (vendet Nordike dhe Evropa Perëndimore) kanë shkallë më të lartë të grave të cilat deklaruan se kanë përjetuar ngacmim seksual.

Duke i perceptuar konkretisht format më të rënda të ngacmimit seksual⁵², 17% e grave kanë pasur përvoja të kësaj natyre nga mosha 15 vjeçare, ndërsa 5% kanë pasur përvoja të kësaj natyre në 12 muajt para sondazhit (4% dhe 1%, midis grave të cilat flasin në gjuhën shqipe). Kjo përsëri është një shkallë shumë më e ulët se ajo në BE, ku mesatarisht 45% e grave deklaruan se kanë përjetuar më së paku një nga gjashtë format më serioze të ngacmimit seksual nga mosha 15 vjeçare.

Grafiku 4.3: Prevalenca e ngacmimit seksual




51 Sa i përket ngacmimit seksual, gratë në sondazh u pyetën: Sa shpesh nga koha kur keni pasur 15 vjet e deri më tani / në 12 muajt e kaluar keni përjetuar ndonjë nga këto veprime: 1) Prekje, përçafime ose puthje të padëshiruara? 2) Komente apo shaka me kuptim seksual që ju kanë bërë të ndiheni e ofenduar? 3) Ftesa të papërshtatshme për të dalë në takime? 4) Pyetje të bezdisshme rreth jetës suaj private që ju kanë bërë të ndiheni e ofenduar? 5) Komente të bezdisshme rreth pamjes suaj fizike që ju kanë bërë të ndiheni e ofenduar? 6) Vështrime të papërshtatshme ose lakmitare që ju kanë bërë të ndiheni e frikësuar? 7) Dikush që ju dërgon ose ju tregon figura, fotografi apo dhurata me përmbajtje seksuale që ju kanë bërë të ndiheni e ofenduar? 8) Dikush ju është ekspozuar në mënyrë të pahijshme? 9) Dikush ju ka detyruar të shikoni ose të vështroni materiale pornografike kundër dëshirës suaj? 10) Emaile ose SMS të padëshiruara me përmbajtje seksuale të cilat ju kanë ofenduar? 11) Veprime të papërshtatshme që ju kanë ofenduar në uebsajtet e rrjeteve sociale si në Facebook, ose në bisedat në internet. Lidhur me çdo formë të ngacmimit seksual, gratë mund të tregojnë se sa shpesh e kanë përjetuar të njëjtën: asnjëherë, një herë, dy deri pesë herë ose gjashtë herë ose më shumë herë. Prevalenca e ngacmimit seksual bazohet te të anketuarat të cilat kanë deklaruar se kanë përjetuar të paktën një nga ngacmimet e theksuara. U zgjidhën gjashtë forma të ngacmimit seksual për shkak të rëndësisë së tyre, ndërsa në këtë raport janë theksuar si “forma më të rënda” të ngacmimit seksual.

52 Format më serioze të ngacmimit seksual janë theksuar si “prekje e padëshiruar”, “përçafim ose puthje”, “komente të bezdisshme rreth pamjes suaj fizike që ju kanë bërë të ndiheni e ofenduar”, “dikush ju është ekspozuar në mënyrë të pahijshme”, “dikush ju ka detyruar të shihni ose shikoni materiale pornografike kundër vullnetit tuaj” dhe “E-mesazhe ose SMS-mesazhe të padëshiruara eksplicite seksuale që ju kanë ofenduar”. Prevalenca e formave më të rënda të ngacmimit seksual bazohet tek të anketuarat të cilat kanë treguar se kanë përjetuar të paktën një nga gjashtë format e këtylla të ngacmimit seksual në të paktën një rast.

Gratë të cilat flasin në gjuhën maqedonase kanë shumë më shumë gjasa të kenë përjetuar ngacmim seksual në krahasim me gratë që flasin në gjuhën shqipe, nga mosha 15 vjeçare dhe në 12 muajt para sondazhit, siç mund të shihet në Grafikon 4.4.

Grafiku 4.4: Prevalenca e ngacmimit seksual sipas gjuhës



Prevalenca individuale e ngacmimit seksual nga mosha 15 vjeçare është më e lartë tek gratë në moshë prej 18 deri në 39 vjeçare (40%), tek ato me arsim të lartë (44%), tek nxënëset/studentet (47%) ose tek ato që janë me punë të paguar (40%) dhe tek ato të cilat në të kaluarën kanë pasur partner (49%). Grupet e njëjta, kanë gjasa të mëdha të tregojnë se kanë përjetuar ngacmim seksual në 12 muajt para sondazhit, me ç'rast prevalenca është mjaft e lartë tek nxënëset/studentet (32%) dhe tek gratë pa fëmijë (22%).

Format më të pranishme të ngacmimit seksual që i kanë përjetuar gratë nga mosha 15 vjeçare janë vështrime të papërshtatshme ose lakmitare që i ka bërë të ndihen të frikësuar me ç'rast nuk janë ndier mirë, të raportuara nga 16% e respondenteve, të pasuara nga pyetje të bezdisshme rreth jetës private që i kanë bërë të ndihen të ofenduar (10%), prekje, përqafime ose puthje të padëshiruara (10%); komente të bezdisshme rreth pamjes fizike (10%). Në BE, vështrime të papërshtatshme ose lakmitare është po ashtu forma më e shpeshtë e ngacmimit seksual, e deklaruar nga 30% e grave, ndërsa prekja, përqafimi ose puthja e padëshiruar theksohet nga 29% e grave. Në shumicën e rasteve të ngacmimit, gratë të cilat kanë përjetuar përvoja të kësaj natyre, me sa duket, kanë pasur më shumë se një përvojë të kësaj natyre.

Tabela 4.5: Forma të ngacmimit seksual

Ndonjëherë ndoshta keni përjetuar që disa persona të sillen ndaj jush në mënyrë të bezdisshme dhe ofenduese. Sa shpesh, nga mosha juaj 15 vjeçare e deri më sot keni përjetuar ndonjë nga situatat në vijim:

	Asnjëherë %	Një herë %	2-5 herë %	6+ herë %
Prekje, përqafime ose puthje të padëshiruara?	90	4	4	2
Vështrime të papërshtatshme ose lakmitare që ju kanë bërë të ndiheni e frikësuar?	82	5	7	4
Komente apo shaka me kuptim seksual që ju kanë bërë të ndiheni e ofenduar?	92	2	3	2
Dikush që ju dërgon ose ju tregon figura, fotoGratëfi apo dhurata me përmbajtje seksuale që ju kanë bërë të ndiheni e ofenduar?	98	1	1	0
Ftesa të papërshtatshme për të dalë në takime?	94	2	3	2
Pyetje të bezdisshme rreth jetës suaj private që ju kanë bërë të ndiheni e ofenduar?	88	3	5	3
Komente të bezdisshme rreth pamjes suaj fizike që ju kanë bërë të ndiheni e ofenduar?	88	2	5	3
Emaille ose SMS të padëshiruara me përmbajtje seksuale të cilat ju kanë ofenduar?	90	1	2	0
Veprime të papërshtatshme që ju kanë ofenduar në uebsajtet e rrjeteve sociale si në Facebook, ose në bisedat në internet	76	2	3	2
Dikush ju është ekspozuar në mënyrë të pahijshme?	95	3	1	1
Dikush ju ka detyruar të shikoni ose të vështroni materiale pornografike kundër dëshirës suaj?	99	0	0	0

BAZA: 1.858 gra të grup moshës 18-74 vjeçe në Maqedoninë e Veriut
BURIM: Sondazhi i drejtuar nga OSCE për dhunën ndaj grave (2018)

Në sondazhet cilësore, gratë ngacmimin seksual e përshkruan në një shkallë ose vazhdimësi, nga niveli më i ulët (siç është fishkëllima ose hedhja fjalë nga grupe të njerëzve në rrugë) deri në incidente më të rënda, përfshirë këtu edhe prekjën. Pati pikëpamje të ndryshme për atë se çka është e pranueshme, ndërsa mendimi i përgjithshëm ishte se kujdesi më i vogël dhe kujdesi i padëshiruar seksual jo aq serioz është i pranueshëm. Disa nga pjesëmarrëset madje thanë se këtë e nxit vet gruaja, përkatësisht se është e natyrshme që sjellja e burrit të korrespondojë me mënyrën e sjelljes së gruas dhe të veshjes. Pikëpamjet e këtilla mund të ndihmojnë që të sqarohet prevalenca më e ulët në krahasim me BE, meqë disa lloje të sjelljeve, të cilat janë identifikuar si ngacmim seksual, në disa vende të BE-së, si të këtilla nuk perceptohen në Maqedoninë e Veriut.

Gratë, të cilat morën pjesë në sondazhin cilësor, treguan edhe për përvojat e tyre lidhur me ngacmimin seksual onlajn. Ato thanë se gjithnjë e më shpesh ngacmohen nga burrat në platformat e mediave sociale, veçanërisht nga burrat më të rinj, për të cilët gratë besojnë se kërkojnë seks. Ato shprehën bindje se onlajn burrat janë më të guximshëm të flasin për punë të cilat nuk do t'ia thoshin në fytyrë.

“Unë jam mjaft aktive në rrjetet sociale, ndërsa ndonjëherë pranoj mesazhe nga djem më të rinj se djali im. “Kjo është bota virtuale dhe mënyra se si ia lejojnë vetvetes të të drejtohen dhe të të shohin si objekt seksual.”

Grua, në moshë prej 35-54 vjeçare, maqedonase etnike, nga mjedisi urban

Për më shumë se një nga pesë gra (22%), incidenti më serioz i ngacmimit seksual që e kanë përjetuar nga mosha 15 vjeçare e përfshinë shikimin e pahijshëm ose shikimin epsharak dhe pas kësaj vijon prekja e padëshiruar, përçafimi ose puthja e padëshiruar (13%).

Autorët e ngacmimit seksual shpeshherë janë të panjohur: tri nga pesë gra deklaruan se kanë qenë viktimë të personit të panjohur (60% në krahasim me 68% në BE). Në mesin e autorëve të njohur, më së shpeshti përmendet miku/i njohuri ose fqiu (36% në krahasim me 31% në BE), pastaj vijon ndonjë i njohur tjetër i gruas, pa precizuar se cili⁵³ (19% në krahasim me 35% në BE). Autorët e incidentit më serioz e ndjekin skemën e njëjtë.

Së këtejmi, autorët e ngacmimit seksual zakonisht janë burra, megjithatë nuk është çdoherë kështu. 63% e grave të cilat deklaruan se kanë përjetuar ngacmim seksual, si autorë i apofrofuan burrat. Vetëm 6% e të anketuarve deklaruan se autorët kanë qenë gra, ndërsa 24% deklaruan se janë përfshirë edhe burra edhe gra.


Në më shumë se shtatë nga dhjetë incidente më serioze, është përfshirë vetëm një autor (71%). Në 8% të rasteve janë përfshirë dy autorë, ndërsa në 16% janë përfshirë tre ose më shumë autorë.

53 Kategoritë janë: “partneri aktual”, “partneri i mëparshëm”, “udhëheqës/ epror”, “kolegë / bashkëpunëtor”, “klient / blerës / pacient”, “arsimtar/instruktor/ trajner”, “nxënës tjetër/ student tjetër”, “mjek / punonjës shëndetësor”, “familjar / anëtar i familjes (përveç partnerit)”, “familjar / anëtar i familjes së partnerit”, “Dikush me të cilin keni dal/ dikush të cilin sapo e keni njoftuar”.

4.5: Dhuna fizike dhe seksuale nga ana e jo-partnerëve

Gjashtë për qind e grave në moshë prej 18 deri 74 vjeçare deklaruan se kanë përjetuar një ose më shumë forma të dhunës fizike nga jo-partneri nga moshja 15 vjeçare (2% në 12 muajt para sondazhit), ndërsa 2% kanë përjetuar një nga format e dhunës seksuale (0.1% në 12 muajt para sondazhit) (Grafiku 4.5). Kjo shkallë është shumë më e ulët nga ajo në BE, ku mesatarisht 20% deklaruan se kanë përjetuar dhunë fizike nga ana e jo-partnerit nga moshja 15 vjeçare (nga 10% për qind në Austri, Greqi, Poloni dhe Portugali deri në 36% në Danimarkë). Gjashtë për qind e grave në BE deklaruan se kanë përjetuar dhunë seksuale nga ana e jo-partnerit, ndërsa shkalla lëvizë nga 1% në Greqi dhe Portugali deri në 12% në Suedi.

Grafiku 4.5: Prevalenca e dhunës fizike dhe seksuale nga jo-partneri



Prevalenca individuale e dhunës nga jo-partneri është më e ulët tek gratë të cilat flasin në shqip në krahasim me gratë të cilat flasin në maqedonisht. Tre për qind e grave të cilat flasin shqip, deklaruan se kanë përjetuar dhunë fizike nga jo-partneri (në krahasim me 7% të grave që flasin maqedonisht), ndërsa më pak se 0,5% e grave deklaruan se kanë përjetuar dhunë seksuale nga jo-partneri që në moshën 15 vjeçare (në krahasim me 2% të grave të cilat flasin në gjuhën maqedonase).

Tabela 4.6: Prevalenca e dhunës fizike dhe seksuale nga jo-partneri, sipas gjuhës

	Gratë që flasin maqedonisht % ka ndodhur ndonjëherë	Gratë që flasin shqip % ka ndodhur ndonjëherë
Dhunë fizike		
Që nga mosha 15 vjeçare	7	3
Në 12 muaj para fillimit të sondazhit	2	0
Dhunë seksuale		
Që nga mosha 15 vjeçare	2	0
Në 12 muaj para fillimit të sondazhit	0	0
Dhunë fizike dhe seksuale		
Që nga mosha 15 vjeçare	8	3
Në 12 muaj para fillimit të sondazhit	2	0

BAZA: 1,414 gra që flasin maqedonisht dhe 496 gra që flasin shqip në Maqedoninë e Veriut

BURIM: Sondazh i drejtuar nga OSCE për dhunën ndaj grave (2018)

Shifrat në të kuqe tregojnë se dallimi është statistikiisht i rëndësishëm

Në sondazhet cilësore dhuna fizike dhe seksuale nga jo-partneri konsiderohet si formë më serioze dhe formë më pak e zakonshme e dhunës në vend, ndërsa një numër i vogël i të anketuarave i treguan përvojat e tyre personale sa i përket dhunës së kësaj natyre. Një viktimë e këtij lloji të dhunës e përshkroi përvojën e saj me rastin e përdhunimit nga person i panjohur në moshë 15 vjeçare. Përvoja e saj është prezantuar në vijim si pjesë e këtij sondazhi.

Studim i rastit –Storia e T – Pjesa 1

- T është 20 vjeç. Kur ishte 15 vjeçe, takoi një djalë me të cilin ishte miqësuar. Një ditë, ai e çoi në një hotel në pronësi të babait të tij. Me arsyetimin se ajo do të shkonte për të marrë diçka, e la atë vetëm në një nga dhomat që ta priste.
- Pas disa çastesh, në dhomë ka hyrë një person më i moshuar dhe e kishte përdhunuar.

“Ai ma zuri frymën. Mendoja se njeriu do të më mbysë, do të më vrasë. Dhe atëherë [ejakuloi dhe u tërhoq], edhe sot e kësaj dite neveritem kur e dëgjoj atë zë. Kam sulm paniku.”


- Kur njeriu ishte larguar, T ishte larguar nga hoteli përmes dritares dhe nëpër disa ballkone për t'u arratisur.

Format më të përhapura të dhunës fizike nga ana e jo-partnerit janë shtyrja dhe shuplakat, të theksuara nga 3% e grave të cilat e kanë përjetuar nga moshë 15 vjeçare (shumë më ulët se mesatarja e BE-së prej 13%) dhe nga 1% e grave në 12 muajt para sondazhit. Për asnjërën nga format e dhunës seksuale nuk u prononcuan më shumë se një për qind e grave.

Mesa duket përvoja e dhunës nga jo-partneri ka ndodhur vetëm një herë dhe jo më shumë. Incidentet më serioze të dhunës (përkatësisht një përvojë e cila ka ndikuar më së shumti ndaj gruas, duke i përfshirë këtu edhe kërcënimet për dhunë) nga jo-partnerë kanë tendencë që të jenë incidente fizike dhe jo seksuale (Grafiku 4.6), që është e ngjashme me prevalencën e të gjitha incidenteve të dhunës që i përjetojnë viktimat e jo-partnerëve. Format e dhunës të cilat më së shpeshti identifikohen si të kryera gjatë kohës së incidentit më serioz janë kërcënimet se do të lëndohen fizikisht dhe shtyrja, deklaruan një nga pesë gra të cilat në të kaluarën janë ballafaquar me ndonjë dhunë nga jo-partneri.

Grafiku 4.6: Incidentet më serioze të dhunës nga jo-partnerët ndaj grave

Do të doja të mendonit rreth incidentit më serioz nga partneri juaj aktual. Cilat nga gjërat në këtë kartelë ndodhën në atë kohë? Me 'më serioz' kuptojmë një incident që pati ndikimin më të madh te ju.




Pjesa më e madhe e këtyre incidenteve më serioze kanë ndodhur në mjedise private, me ç'rast thuaja se gjysma (47%) nga të gjitha incidentet më të rënda sipas grave të anketuara kanë ndodhur në shtëpinë e saj, ndërsa madje 16% kanë ndodhur në ndonjë shtëpi ose banesë tjetër. Në BE vetëm 27% e incidenteve më serioze kanë ndodhur në shtëpinë e gruas, në krahasim me numrin shumë më të madh të incidenteve që kanë ndodhur në vende publike. Për shembull, 18% e incidenteve kanë ndodhur në rrugë, ndërsa 16% kanë ndodhur në shkollë ose në vendin e punës, e që korrespondon me faktin se pjesa më e madhe e grave në BE janë të punësuar.⁵⁴

54 Gjatë kohës së sondazhit të FRA, vetëm 4% e grave në BE kanë thënë se asnjëherë nuk kanë punuar, në krahasim me 23% në këtë sondazh.

Grafiku 4.7: Lokacioni i incidenteve më serioze të dhunës nga jo-partneri

Duke menduar rreth incidentit më serioz, ku ndodhi ai?



4.5.1. Autorë

Një numër i madh i grave *nuk pajtohen* se gratë kanë probabilitet më të madh të përdhunohen nga një i panjohur sesa nga ndonjë person i njohur (55%).

Analiza e autorëve të dhunës seksuale nga jo-partneri është e kufizuar për shkak të numrit të vogël të grave të cilat denoncojnë raste të këtilla. Në mesin e atyre të cilat kanë denoncuar dhunë të kësaj natyre, autorët më së shpeshti janë të njohur për gratë, por ato nuk kanë treguar nëse i takojnë ndonjëres nga kategoritë e theksuara (shtatë raste); miku, i njohuri ose fqinji (katër raste); ose dikush me të cilin keni dal/dikush sapo e keni takuar (tre raste). Mjeku ose punëtori shëndetësor, familjar i partnerit të tyre dhe nëpunësi policor u përmendën nga një person, ndërsa pesë gra deklaruan se autori ka qenë dikush të cilin nuk e njohin. Gjashtë persona (rreth një e treta e grave) refuzuan të tregojnë se kush ka qenë autori.

Shumica e grave që e kanë mbijetuar dhunën fizike nga jo-partneri, autorët e tyre i identifikuan si dikë të cilin e kanë njohur. Më së shpeshti përmendet familjari i partnerit të tyre (21%), ndërsa 17% i theksuan familjarët e tyre. Familjarët janë autorët më shpesh të apostrofuar të dhunës nga jo-partneri në BE (31%). Pastaj, person i njohur ose fqinji (18%) dhe ndonjë nxënës ose student (17%) janë autorët e tjerë më shpesh të apostrofuar të njohur për viktimitë. Dymbëdhjetë për qind e viktimave deklaruan se nuk e njohin autorin, e që është më pak nga mesatarja e BE-së prej 23 për qind.

Burrat janë identifikuar si autorë të dhunës fizike nga jo-partneri nga 70% e grave të cilat kanë përjetuar dhunë fizike nga jo-partneri, me ç'rast 60% nga të mbijetuarat theksuan vetëm një burrë, ndërsa 10% thanë se kanë qenë të përfshirë edhe burra edhe gra. Gratë theksohen nga 31% (21% theksojnë vetëm gra). Të tjerat (9%) nuk e kanë njohur ose nuk dëshironin të zbulojnë gjininë e autorit. Dy e treta e atyre që e kanë mbijetuar dhunën seksuale deklaruan se autori ka qenë burrë (64%), ndërsa pjesa tjetër nuk e dinin ose nuk dëshironin të tregojnë.⁵⁵

Në më shumë se katër nga pesë incidentet e theksuara më serioze (83%), autorët kanë vepruar vetë. Një e pesta e incidenteve më serioze janë kryer nga dikush që ka qenë nën ndikim të alkoolit ose drogës (20%).

4.6: Përvoja e dhunës nga fëmijëria

Nëntë për qind e grave deklaruan se kanë përjetuar dhunë fizike, seksuale ose psikologjike në fëmijëri,⁵⁶ kjo shkallë është mjaft më e ulët, për shembull, prej Kroacisë dhe Bullgarisë (30% dhe 31%). Prevalenca individuale është akoma më e ulët tek gratë të cilat flasin në gjuhën shqipe: 2% deklaruan se kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës në fëmijëri, në krahasim me 11% të grave të cilat flasin në gjuhën maqedonase.

Për 7% të grave, forma më e shpeshtë e dhunës në fëmijëri është dhuna fizike (9% e grave të cilat flasin në gjuhën maqedonase dhe 1% e grave të cilat flasin në gjuhën shqipe), ndërsa prevalenca e dhunës psikologjike dhe seksuale është 2% dhe 1% në mënyrë përkatëse. Prevalenca e dhunës seksuale është e krahasueshme në të dyja grupet, por tek gratë që flasin në gjuhën maqedonase ka shkallë pak më të larta të dhunës psikologjike në fëmijëri (3% kundrejt 1%). Pastaj, gratë në mjediset urbane e vunë në dukje shkallën më të lartë të dhunës fizike dhe seksuale në fëmijëri në krahasim me ato të mjediseve rurale (9% kundrejt 5% të dhunës fizike dhe 1% kundrejt 0% të dhunës seksuale).

Të gjitha format e dhunës në fëmijëri janë më të shpeshta në BE, me ç'rast 27% e grave në BE deklaruan se kanë përjetuar dhunë fizike, 12% dhunë seksuale, ndërsa 10% dhunë psikologjike para moshës 15 vjeçare. Vendet në të cilat gratë ndjejnë se dhuna familjare është çështje private dhe në të cilat ekziston kultura e heshtjes, kanë tendencë të kenë shkallë më të ulëta të grave të cilat i shkëmbejnë këto përvoja me të tjerë nga vendet me traditë më të gjatë të ndërgjegjësimit sa i përket dhunës ndaj grave.


Forma më e përhapur e dhunës fizike në fëmijëri, për të cilën 7% e grave deklaruan se e kanë përjetuar, është goditja me shuplakë dhe tërheqja e flokëve, me ç'rast u janë shkaktuar lëndime.

55 Duke e marrë parasysh bazën e vogël (n = 30), këto gjetje duhet të interpretohen me kujdes.

56 Dhuna në fëmijëri ka të bëjë me dhunën e cila ka ndodhur para moshës 15 vjeçare. Në lidhje me dhunën fizike para moshës 15 vjeçare, grave u parashtruan pyetjet në vijim: Para moshës 15 vjeçare, sa shpesh personi i rritur i cili është në moshë 18 vjeçare ose më i vjetër, ju ka bërë këtë si vijon: 1) Ju ka goditur me shuplakë ose ju ka shkulur flokët aq sa keni ndier dhembje? 2) Ju ka goditur aq fortë sa që keni ndier dhembje? 3) ju ka goditur me shqelme me çka ju ka lënduar? 4) Ju ka rrahur shumë me një objekt si shkop, bastun, thupër apo rrip, sa që keni ndier dhembje? 5) Ju ka shpuar ose ju ka prerë me diçka sa që keni ndier dhembje? Në lidhje me dhunën seksuale para moshës 15 vjeçare, grave u janë parashtruar pyetjet si vijojnë: Para moshës tuaj 15 vjeçare, sa shpesh, ndonjë person i rritur, përkatësisht dikush që ka pasur 18 vjet dhe më shumë – ju ka bërë diçka nga kjo si vijon, edhe pse ju nuk keni dashur ta bëni një gjë të tillë: 1) Ju ekspozoi gjenitalet e veta kur ju nuk donit që ta bënte këtë? 2) Ju detyroi të pozonit e zhveshur përpara ndonjë personi apo në fotografi, video apo kamerë uebi në internet kur ju nuk donit që ta bënit këtë? 3) Ju preku pjesët intime (organet gjenitale ose gjoksin) kur ju nuk donit që ta bënte këtë? 4) Ju detyroi të kryenit marrëdhënie seksuale me të kur ju nuk donit që ta bënit këtë? Lidhur me dhunën psikologjike para moshës 15 vjeçare, grave ua kanë parashtruar pyetjet si vijojnë: Para moshës tuaj 15 vjeçare, sa shpesh ndonjë anëtar i rritur i familjes ju ka bërë diçka nga këto: 1) Ju ka thënë se nuk ju donte njeri? 2) Ju ka thënë se do të donte që të mos kishit lindur fare? 3) Ju ka kërcënuar se do t'ju braktiste apo do t'ju nxirrte nga shtëpia? Para moshës tuaj 15 vjeçare, sa shpesh ndonjë i rritur – përkatësisht, dikush i cili ka pasur 18 vjet dhe më shumë – Ju është kërcënuar se do t'ju lëndoj keq ose do t'ju vras? Prevalenca e dhunës në fëmijëri bazohet tek të anketuarat të cilat raportuan se kanë përjetuar së paku një nga pozicionet e cekura për dhunë fizike, seksuale ose psikologjike ose cilado qoftë nga këto të tria.

Grafiku 4.8: Përvoja të dhunës fizike para moshës 15 vjeçare

Përpara se të mbushnit 15 vjet, sa shpesh një person i rritur - pra, dikush që ishte 18 vjeç e më shumë - ju ka bërë ndonjë gjë nga këto të përmendurat më poshtë?



Anëtarët e familjes dhe veçanërisht prindërit, janë autorë të mundshëm të dhunës në fëmijëri. Në pjesën më të madhe të incidenteve, me ç'rast një grua tha se si fëmijë e kanë goditur ose e kanë tërhequr për flokë, me ç'rast është lënduar, autori ka qenë babai i saj (54%). Autori tjetër i mundshëm i kësaj forme të dhunës në fëmijëri është nëna e gruas (23%), pastaj pason vëllai dhe vëllai nga njëri prind (19%). Ngjashëm me këtë, në 47% të rasteve kur fëmija është goditur keq dhe është lënduar, autori ka qenë babai i saj. Në 19% të rasteve, autori ka qenë nëna e saj, ndërsa në 18% të rasteve autori ka qenë vëllai ose vëllai nga njëri prej prindërve.

Gratë të cilat kanë përjetuar dhunë në fëmijërinë e tyre shumë më shpesh janë ballafaquar me dhunë si të rritura. Tek ato që kanë përjetuar dhunë në fëmijëri, 43% në moshë të rritur kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri ose jo-partneri, në krahasim me 10% prej atyre që nuk kanë përjetuar dhunë në fëmijëri.

43% e grave që kanë përjetuar dhunë në fëmijëri, në moshë të rritur kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim

Kjo pasqyrohet në sondazhin cilësor: të mbijetuarat e dhunës të cilët morën pjesë në sondazhin cilësor kanë pasur tendencë të kenë përvoja nga dhuna si fëmijë dhe si të rritura. Dhuna në fëmijëri është ushtruar nga njëri ose nga të dy prindërit dhe ka zgjatur shumë vite. Disa nga gratë të cilat morën pjesë në këtë sondazh shprehën bindje se këto përvoja nga fëmijëria kanë pasur lidhje të drejtpërdrejt me përvojat e tyre të mëvonshme, meqë nga njëra anë janë detyruar nga familja e tyre të hyjnë në lidhje e cila është bërë e dhunshme ose nga ana tjetër meqë vetë ato kanë hyrë në lidhje me burrë të cilin nuk e kanë njohur, por këtë e kanë bërë thjeshtë që të shpëtojnë nga familja e tyre.

“Nuk e njihja. U pajtova [të martohem me të] vetëm që të dal nga shtëpia [ime]. Ai e pa se jam keqtrajtuar, kështu që edhe ai filloi ta bëjë të njëjtën gjatë muajit të parë [të jetës sonë të përbashkët].”

Viktimë e dhunës, rome



Thuaja se një nga pesë gra mund të përcaktohen si të prekura nga konflikti (11% e grave të cilat flasin në gjuhën maqedonase dhe 42% e grave të cilat flasin në gjuhën shqipe).

5. Konflikti dhe dhuna

5.1: Përvoja që kanë të bëjnë me konfliktet

Konflikti i armatosur është përkufizuar për qëllimet e këtij sondazhi si luftime të armatosura midis dy ose më shumë grupeve të organizuara, sulme ndaj komuniteteve ose si pasiguri e përgjithshme e shkaktuar nga konflikti.

Edhe pse vendi u shkëput pa dhunë nga ish-Jugosllavia, vendi në vitin 2001 u ballafaqua me konflikt midis grupit militant të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare të shqiptarëve etnikë dhe forcave të sigurisë së vendit në zonën veriore dhe perëndimore të vendit. Si rezultat i kësaj, thuaja se një e katërta (23%) e grave deklaruan se kanë jetuar në gjendje ku ka pasur konflikt të armatosur aktiv në një periudhë prej më së paku një jave gjatë jetës së tyre, por jo të gjitha mund të klasifikohen si drejtpërdrejt të prekura nga konflikti. Kjo më shumë është e përhapur tek gratë të cilat flasin në gjuhën shqipe, prej të cilave 50% deklaruan se kanë përjetuar konflikt të armatosur aktiv (në krahasim me 13% të grave të cilat flasin në gjuhën maqedonase).

Nga ato të cilat kanë jetuar në periudhë konflikti më së paku një javë, shumica e tyre (82%) kanë përjetuar së paku një prej përvojave për të cilat u pyetën në këtë sondazh. Përgjigjja më e shpeshtë ishte se kanë dëgjuar të shtëna nga armë ose shpërthim të bombave (66%), ndërsa më së paku një javë kanë jetuar në vend në të cilin kanë qenë të stacionuara ose kanë lëvizur me një numër më të madh të pjesëtarëve të forcave të armatosura (54%), kanë qenë dëshmitare të drejtpërdrejta të luftimeve (48%), nuk kanë mundur të punësohen për shkak të konfliktit (30%) ose e kanë pasur të domosdoshme të largohen nga shtëpia e tyre (27%). Gratë të cilat flasin në gjuhën shqipe kishin më shumë gjasa të tregojnë se kanë përjetuar një pjesë të madhe të këtyre situatave (Tabela 5.1).

57 Përkufizimi për "të prekur nga konflikti" është të jetohej në situatë ku ka pasur konflikt të armatosur aktiv në periudhë prej më së paku një javë dhe nëse përgjigjja është "po" në së paku një nga pyetjet në vijim: "A dëgjuat të shtëna armësh, zhurmë bombash ose bombardimesh në zonën ku jetonit në kohën e konfliktit?" "A keni jetuar për të paktën një javë në një vend ku ishin vendosur ose lëviznin persona të shumtë të armatosur (ushtarakë të zakonshëm ose grupe të tjera të armatosura). Kjo mund të përfshijë banorët vendas pjesëmarrës në konflikt." "A keni qenë dëshmitare e luftimeve në zonën ku jetonit në kohën e konfliktit?" "A u shkatërruan ose u dëmtuan rëndë pronat (p.sh. shtëpia, makina, bagëtia) e familjes suaj për shkak të konfliktit?" "A u rrëmbyen pronat (p.sh. shtëpia, makina, bagëtia) e familjes suaj nga personat e grupeve të armatosura?" "A ishte e pamundur të gjenit punë në zonën ku jetonit për shkak të konfliktit? (zyrat/fabrikat u mbyllën ose u shkatërruan, ishte tepër e rrezikshme)?" "A mori pjesë ndonjë anëtar i familjes suaj apo bashkëshorti ose partneri juaj në konfliktin e armatosur apo mori pjesë në luftime si pjesëtar i një grupi të armatosur?" "A morët pjesë aktive në luftime gjatë konfliktit?" "A u arrestuan apo u burgosën civilë nga zona ku ju jetonit?" "A vdiqën civilë në zonën ku ju jetonit për shkak të konfliktit?" "Ju personalisht, a u sulmuat apo u plagosët fizikisht për shkak të konfliktit?" "A ju desh të iknit nga shtëpia juaj gjatë (ndonjë prej) konflikteve që përjetuat?"

Tabela 5.1: Përvoja nga konfliktet

Ju lutem më thoni nëse keni përjetuar ose jo ndonjë nga gjërat më poshtë gjatë konfliktit/konflikteve të armatosur/a që keni përjetuar?

	Po (%)	Gratë që flasin maqedonisht	Gratë që flasin shqip
A dëgjuat të shtëna armësh, zhurmë bombash ose bombardimesh në zonën ku jetonit në kohën e konfliktit?	66	57	74
A keni jetuar për të paktën një javë në një vend ku ishin vendosur ose lëviznin persona të shumtë të armatosur (ushtarakë të zakonshëm ose grupe të tjera të armatosura). Kjo mund të përfshijë banorët vendas pjesëmarrës në konflikt.	54	34	71
A keni qenë dëshmitare e luftimeve në zonën ku jetonit në kohën e konfliktit?	48	29	64
A u shkatërruan ose u dëmtuan rëndë pronat (p.sh. shtëpia, makina, bagëtia) e familjes suaj për shkak të konfliktit?	12	8	16
A u rrëmbyen pronat (p.sh. shtëpia, makina, bagëtia) e familjes suaj nga personat e grupeve të armatosura?	6	3	9
A ishte e pamundur të gjenit punë në zonën ku jetonit për shkak të konfliktit?	30	20	39
A mori pjesë ndonjë anëtar i familjes suaj apo bashkëshorti ose partneri juaj në konfliktin e armatosur apo mori pjesë në luftime si pjesëtar i një grupi të armatosur?	20	30	11
A morët pjesë aktive në luftime gjatë konfliktit?	1	0	2
A u arrestuan apo u burgosën civilë nga zona ku ju jetonit?	11	7	15
A vdiqën civilë në zonën ku ju jetonit për shkak të konfliktit?	14	12	15
Ju personalisht, a u sulmuat apo u plagosët fizikisht për shkak të konfliktit?	1	0	1
A ju desh të iknit nga shtëpia juaj gjatë (ndonjë prej) konflikteve që përjetuat?	27	30	24

BAZA: 191 gra që flasin maqedonisht dhe 242 gra që flasin shqip në Maqedoninë e Veriut që kanë përjetuar një konflikt të armatosur

BURIM: Sondazhi i drejtuar nga OSCE për dhunën ndaj grave (2018)

Shifrat në të kuqe tregojnë se dallimi është statistikisht i rëndësishëm

Si përfundim, përafërsisht një nga pesë gra (19%) mund të konsiderohen si drejtpërdrejt të prekura nga konflikti, e që sipas përkufizimit nënkupton se kanë jetuar në periudhë kohore të konfliktit dhe të cilat kanë përjetuar së paku një nga përvojat që kanë të bëjnë me konfliktin e theksuar në Tabelën 5.1. Thuaja se të gjitha këto gra sot jetojnë në rajonin e Pollogut dhe të Shkupit dhe në rajonin Verilindor të vendit.

Ato që janë përcaktuar si drejtpërdrejt të prekura nga konflikti, po ashtu u pyetën për pasoja të tjera nga të jetuarit në konflikt, nga qasja në shërbimet publike e deri në humbjen e anëtarëve të familjes dhe përvojat e dhunës. Marrë në përgjithësi, pak më shumë se gjysma e të anketuarave kanë përjetuar së paku një prej këtyre përvojave (53%, kjo shkallë është pak më e lartë tek gratë të cilat flasin në gjuhën shqipe 58%), prej të cilave më të shpeshtat kanë të bëjnë me mungesën e shërbimeve. Pak më shumë se një e treta (34%) prej atyre që sipas definicionit janë drejtpërdrejt të prekura nga konflikti deklaruan se një kohë të gjatë në vendin ku kanë jetuar nuk janë zbatuar ligjet, ndërsa 23% deklaruan se shërbimet shëndetësore që i kanë shfrytëzuar paraprakisht nuk i kanë pasur të disponueshme ose nuk kanë pasur qasje deri te të njëjtat (Tabela 5.2). Këto dy çështje kanë qenë problem për ato që sot jetojnë në rajonin e Pollogut, ndërsa ato të rajonit Verilindor dhe të Shkupit kishin më shumë gjasa të kenë ndier mungesën e burrave në familje të cilët kanë qenë larg nga shtëpia për shkak të konfliktit.

Tabela 5.2: Përvojat e grave të prekura drejtpërdrejt nga konflikti

Ju lutem më thoni nëse keni përjetuar ose jo ndonjë nga gjërat më poshtë gjatë konfliktit/konflikteve të armatosur/a që keni përjetuar.

	Po (%)	Gratë që flasin maqedonisht	Gratë që flasin shqip
Nuk kishte organe të zbatimit të ligjit (polici apo organizatë tjetër për zbatimin e ligjit dhe rendit) në zonën lokale, për një kohë të gjatë	34	18	45
Shërbimet shëndetësore (duke përfshirë shërbimet shëndetësore të grave) që ju më përpara keni përdorur, ishin të padisponueshme ose të paarrtshme për një periudhë të gjatë kohe.	23	13	31
Burrat në familjen tuaj (bashkëshortët, baballarët, vëllezërit) ishin larg nga shtëpia dhe familja, (sepse atyre u duhej të shpëtonin, luftuan në konflikt, ishin arrestuar, kishin humbur)	13	25	4
Një anëtar i afërt i familjes tuaj apo bashkëshorti/partneri juaj u plagos apo vdiq si pasojë e luftimeve/dhunës?	4	7	2
Gratët në familjen tuaj duhej të shkonin në vende të rrezikshme (p.sh. përmes vijës së frontit/kufirit ose pranë eksplozivëve si minat) për të punuar ose për të marrë gjërat bazë për familjen (dru zjarri, ushqim, ujë të pijshëm, karburant etj.)	2	3	2
Pjesëtarët e grupeve të armatosura me dashje përdornin kërcënime, përhapnin fjalë apo ushtronin faktikisht dhunë kundër grave për të terrorizuar popullatën vendase në zonën ku jetonit	2	4	1
Pjesëtarët e grupeve të armatosura ngacmuan Gratët vendase në zonën ku jetonit ju.	1	1	0
Pjesëtarët e grupeve të armatosura përdornin praktika shumë poshtëruese kundër grave vendase në zonën ku jetonit, të tilla si zhveshje lakuriq e grave në publik, gjymtime të trupit të tyre, kryerje e kontrolleve trupore në zonat intime pa ndonjë arsye etj.	0	1	0
Rrethanat i detyronin Gratët të ofronin shërbime seksuale në këmbim të mallrave të domosdoshëm për jetesën ose për të garantuar sigurinë e familjes së tyre në zonën ku jetonit.	0	1	0

BAZA: 191 gra që flasin maqedonisht dhe 242 gra që flasin shqip në Maqedoninë e Veriut që kanë përjetuar një konflikt të armatosur
BURIM: Sondazhi i drejtuar nga OSCE për dhunën ndaj grave (2018)
 Shifrat në të kuqe tregojnë se dallimi është statistikisht i rëndësishëm


Sot, 12% e grave të cilat kanë përjetuar konflikt të armatosur dhe vuajnë nga sëmundje ose nga aftësia e kufizuar, këtë ia përshkruajnë konfliktit të cilin e kanë përjetuar. Ky numër varion në masë të madhe nga gjuha të cilën e flasin, meqë shkalla tek gratë të cilat flasin në gjuhën maqedonase është 21%, dhe vetëm 2% tek gratë të cilat flasin në gjuhën shqipe.

5.2: Konflikti dhe dhuna ndaj grave

Grave, të cilat drejtpërdrejt janë përfshirë nga konflikti, iu parashtrua pyetja nëse përvojat e tyre nga ngacmimi seksual i partnerit ose jo-partnerit dhe dhunës fizike ose seksuale kanë qenë të ndërlidhura me konfliktin e armatosur ose jo. Sipas gjetjeve të sondazhit, shumica e grave ishin të mendimit se midis të dyjave nuk ka kurrfarë lidhje. Ngjashëm me këtë, gratë të cilat morën pjesë në sondazhin cilësor, përvojat e tyre nuk i ndërlidhën me konfliktin dhe më gjerë. Ato nuk mendojnë se konflikti ka ndikuar mbi normat ose qëndrimet gjinore.

Prevalenca e ngacmimit seksual dhe dhunës fizike dhe/ose seksuale nga jo-partneri nuk dallon midis grave të cilat kanë qenë apo nuk kanë qenë të prekura nga konflikti. Megjithatë, dhuna psikologjike, fizike dhe seksuale nga partneri i mëparshëm në masë të konsiderueshme është më e lartë tek gratë e prekura nga konflikti, veçanërisht sa i përket dhunës seksuale, e që megjithatë e vë në dukje lidhjen ndërmjet dhunës dhe përvojës nga konflikti. Dhuna psikologjike e ushtruar nga partneri aktual është më e pranishme tek gratë e prekura nga konflikti.

Grafiku 5.1: Prevalenca e dhunës nga partneri i mëparshëm tek gratë e ndikuara nga konflikti



Tek gratë partnerët aktual të të cilave kanë luftuar gjatë konfliktit, nuk kishin tendencë më të madhe të tregojnë se kanë përjetuar dhunë nga partneri aktual nga gratë, partnerët e të cilave nuk kanë luftuar në asnjë konflikt.

Një përqindje e grave të intervistuar deklaruan se personalisht ato janë sulmuar ose dikush u është kërcënuar me armë zjarri nga moshja e tyre 15 vjeçare. Kjo nënkupton gjithsej 16 të anketuara, prej të cilave tri thanë se autori ka qenë partneri i tyre. Në mesin e atyre të cilat kanë përjetuar dhunë nga partneri ose jo-partneri ky numër është rritur në 3%, të atyre të cilat thanë se janë sulmuar ose se dikush u është kërcënuar me armë zjarri (gjithsej pesë të anketuara).



Katër në dhjetë gra që identifikuan incidentin më të rëndë të dhunës fizike dhe/ose seksuale të shkaktuar nga partneri intim ose jo partneri, pësuan një ose më shumë lëndime fizike si rezultat i incidentit.



Më shumë se gjysma e grave të cilat kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim kanë pasur reagim psikologjik afatgjatë ndaj incidentit më serioz që e kanë përjetuar.



3%

Policia është informuar për vetëm 3% të rasteve të identifikuara si incident më serioz i dhunës aktuale nga partneri.

6. Ndikimi i dhunës mbi jetën e grave dhe pengesat për të kërkuar mbështetje


Ky kapitull ofron një pasqyrë të ndikimit të dhunës mbi mirëqenien e grave, po qe se ato do t'ia denonconin dikujt përvojat e tyre dhe nëse e kanë bërë këtë, atëherë sa janë të kënaqura nga përgjigjja. Gjatë bisedës, grave iu parashtrua pyetja e ndikimit ndaj tyre të incidentit më serioz të dhunës fizike ose seksuale, si dhe të kërcënimeve për dhunën e këti-llë. Si incident më serioz u përcaktua incidenti i cili ka pasur ndikim më të madh psikologjik ose fizik mbi gratë.

6.1: Reagimet psikologjike dhe lëndimet fizike

Gratë të cilat kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale (Kapitulli 4) reagojnë në mënyra të ndryshme emocionale. Thuaja se të gjitha deklaruan se kanë ndjerë së paku një prej emocioneve të dhëna në Tabelën 6.1 si reagim ndaj incidentit më serioz të cilin e kanë përjetuar. Pavarësisht nëse dhuna është ushtruar nga partneri aktual, nga partneri i mëparshëm ose nga ndonjë tjetër, reagimet më të shpeshta emocionale të incidentit më serioz ka qenë frika, mllefi, ngacmimi dhe ndjenja e pakëndshme. Këto reagime zakonisht i ndjejnë gjysma ose shumica e grave të prekura. Si reagim i shpeshtë i dhunës nga partneri intim, mes tjerash, u theksua edhe tronditja dhe turpi. Reagimet e njëjta më së shpeshti vërehen edhe në BE, ku tre reagimet e para emocionale ndaj dhunës janë mllefi, frika dhe tronditja.

Tabela 6.1: Reagime emocionale të dhunës fizike dhe/ose seksuale (incidenti më serioz)

Duke menduar rreth incidentit më serioz, a patët ndonjë nga ndjenjat e mëposhtme si rezultat i kësaj?




Emocione të ngjashme u theksuan edhe nga respondentet në lidhje me incidentin më serioz të ngacmimit seksual. Përsëri, thuaja se çdo grua e cila deklaroi se ka përjetuar shqetësim të këtyllë, ka përjetuar së paku një nga emocionet në Tabelën 6.1, ndërsa më shpesh u përmendën ndjenja e pakënaqësisë (58%) dhe shqetësimit (54%).

Numri më i madh i viktimave të dhunës fizike dhe/ose seksuale, po ashtu, e kanë ndjerë ndikimin të së paku një prej pasojave psikologjike afatgjate të theksuara në Tabelën 6.2 si rezultat të incidentit më serioz. Këtu, ndikimi i dhunës nga jo-partneri është më i shprehur nga ndikimi i dhunës nga partneri aktual. Madje 70% të atyre që treguan për njërin nga incidentet më serioze të dhunës nga jo-partneri thanë se për shkak të kësaj vuajnë nga pasojat psikologjike afatgjate, ndërsa numri shënon rënie në 49% dhe 60%, tek gratë tek të cilat incidentin më serioz të dhunës e ka ushtruar partneri aktual ose partneri i mëparshëm.

Lloje të ngjashme të pasojave psikologjike, siç është ndjenja e brishtësisë, probleme me gjumin dhe depresionin, kanë të bëjnë me tre llojet e autorëve. Ky rezultat është i ngjashëm me rezultatet e BE-së, ku reagimet më të shpeshta kanë qenë shqetësimi, depresioni dhe brishtësia. Sulmet e panikut ka mundësi që të jenë rezultat i dhunës nga jo-partneri në krahasim me dhunën nga partneri, ndërsa dhuna e partnerit shpeshherë ka rezultuar në mungesë të vetëbesimit.

Tabela 6.2: Pasojat psikologjike të dhunës fizike dhe /ose seksuale (incidenti më serioz)

Duke menduar rreth incidentit më serioz, a patët ndonjë nga vuajtjet e mëposhtme si rezultat i kësaj?



6. Ndikimi i dhunës mbi jetën e grave dhe pengesat për të kërkuar mbështetje

Një numër më i vogël i grave i vunë në dukje pasojat psikologjike afatgjate të incidentit më serioz të ngacmimit seksual, me ç'rast dy të tretat e grave deklaruan se nuk kanë pasur reagim afatgjatë (67%). Megjithatë, përafërsisht një nga pesë gra (18%) deklaruan se përvoja i ka bërë të ndjehen të brishta, ndërsa pak më shumë se një nga dhjetë (11%) deklaruan se incidenti iu ka shkaktuar vështirësi në gjumë. Në BE, një nga gjashtë gra (14%) vuajnë nga ankthi, ndërsa një nga pesë (20%) ndjehen të brishta. Në këtë drejtim është i rëndësishëm edhe konteksti kulturor, veçanërisht pranimi i gjerë i të ashtuquajturit kujdes i parëndësishëm, i padëshiruar seksual, i përshkruar në Kapitullin 3.

Në lidhje me incidentin më serioz të dhunës nga jo-partneri, gjysma e të anketuarave (45%) deklaruan se kanë pësuar lëndim trupor ose pasojë si rezultat të dhunës. Një nga katër gra (27%) kanë pasur mavijosje ose gërvishtje. Lëndimet më të rënda janë më të rralla, 8%, kanë pasur plagë, nyje të përdredhura ose djegie, 7% kanë pasur kocka të thyera ose dhëmbë të thyer dhe 6% kanë pasur tronditje ose ndonjë lëndim tjetër të trurit.

Incidenti më serioz i dhunës nga partneri i mëparshëm, po ashtu ka rezultuar me lëndim fizik ose me pasoj tek përafërsisht gjysma e të mbijetuarave (48%). Më të shpeshta janë nxirja dhe gërvishtjet. Tek 11% e të anketuarave, incidenti më serioz ka rezultuar me shtatzëni, ndërsa 6% kanë pasur abort spontan.

Pasojat fizike nga incidenti më serioz i dhunës nga partneri aktual janë më të rralla: 80% e të anketuarave deklaruan se nuk janë lënduar, ndërsa 16% thanë se kanë pasur të nxira ose gërvishtje, ndërsa 4% kanë mbetur shtatzënë.

Tabela 6.3: Lëndime fizike të cilat rezultojnë nga dhuna fizike dhe / ose seksuale (incidenti më serioz)

Duke menduar rreth incidentit më serioz, a patët ndonjë nga ndjenjat e mëposhtme si rezultat i tij?

	Parnteri aktual	Partneri i mëparshëm	Jo partneri
	%	%	%
Të nxira, gërvishtje	16	33	27
Shtatzëni	4	11	0
Plagë, ndrydhje, djegie	4	2	8
Lëndime të brendshme	3	3	0
Përplasje ose lëndime të tjera të trurit	2	2	6
Fraktura, kocka të thyera, dhëmbë të thyer	1	4	7
Abort	0	6	0
Infeksion ose një sëmundje seksualisht e transmetueshme	0	2	0
Tjetër	0	0	3
Asnjë lëndim	80	51	47

BAZA: Të gjitha gratë në Maqedoninë e Veriut të grup moshës 18-74 vjeçare të cilat kanë përjetuar dhunë fizike dhe / ose seksuale që nga moshë 15 vjeçare dhe të cilat kanë identifikuar incidentin më të rëndë: dhunë nga partneri aktual (85), partneri i mëparshëm (59) ose jo partneri (107)

BURIM: Sondazh i drejtuar nga OSBE për dhunën ndaj grave (2018)

Në sondazhin cilësor, gratë të cilat kanë përjetuar dhunë nga partneri intim ose nga jo-partneri treguan për ndikimin e dhunës psikologjike dhe fizike. Në disa raste, gratë kanë mbetur me aftësi të kufizuar të përhershme fizike, si rezultat të dhunës që e kanë pësuar. Pa marrë parasysh rëndësinë e lëndimeve fizike që i kanë pësuar, megjithatë, gratë shprehën bindjen se ndikimi psikologjik nga përvojat e tyre ka qenë më i dëmshmi për të njëjtat.

Burimin më të dëshiruar të informatave, këshillave dhe mbështetjes pas incidentit më serioz të dhunës fizike dhe/ose seksuale që e kanë përmendur gratë, ka qenë dikush me të cilin do të kishin mundur të bisedojnë dhe do t'u ofronte mbështetje morale

Studimi i rastit: Stora e T- Pjesa 2

- Pasi u përdhunua nga një person i panjohur në moshën 15 vjeç, T u largua në shtëpi, ka fërkuar trupin në ujë të nxehtë, por ka ndjerë se nuk ka mundur të pastrohet
- Së shpejti pas kësaj, ka filluar të vet-lëndohet dhe disa herë ka tentuar të vetëvritet.

“Ndihesha shumë e ndyrë, desha ta pastroj trupin tim, desha disi të lëndohem. U përpoqa në të gjitha mënyrat e mundshme ... Piva hapa, tentova t'i pres venat.”

- Në një rast, hodhi veten para një makine dhe si pasojë kaloi gjashtë muaj në karrocë.

“Mendova, si shans të fundit për të shpëtuar e kam të hidhem para automobilit, dhe se kjo do të jetë më pak e dhimbshme [që të vdes]. Do të shkel automobili, kjo edhe nuk dhemb. Bam! Do të të godas dhe do të vdesësh. Nuk mund t'ia dal më me këto probleme, nuk mund të duroj.”

- Pasi ka dalë nga spitali, T ka filluar të marrë drogë dhe është marrë me varësinë dhe traumën që e kapërcetuar.

6. Ndikimi i dhunës mbi jetën e grave dhe pengesat për të kërkuar mbështetje


6.2: Mbështetja të cilën e dëshirojnë viktimat e dhunës

Të anketuarat, të cilat kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale, u pyetën se a kanë pasur nevojë për ndonjë ndihmë pas incidentit më serioz të cilin e kanë përjetuar.

Viktimat thanë se pas përjetimit të incidentit më serioz të dhunës fizike dheose seksuale nga ana e partnerit, më së shumti kanë dashur të kenë pranë tyre dikë me të cilin kanë mundur të bisedojnë dhe i cili ka mundur t'u ofroj ndihmë morale. Për viktimat e dhunës nga partneri (34%) dhe viktimat e dhunës nga jo-partneri (31%) më me rëndësi ka qenë të kenë mbrojtje nga dhuna dhe ngacmimi i mëtutjeshëm. Përkundrajt kësaj, vetëm 4% e grave mbi të cilat është ushtruar dhunë nga partneri aktual, deklaruan se kanë pasur nevojë për mbrojtje pas incidentit më serioz, dhe ato kishin tendencë më të ulët të thonë se kanë pasur nevojë për ndihmë mjekësore.

Tabela 6.4: Lloje të informacioneve, këshillave dhe mbështetjes pas incidentit më serioz

Çfarë lloj informacioni, këshillash ose mbështetje do të donit pas incidentit?



	Partneri aktual	Partneri i mëparshëm	Jo partneri
	%	%	%
Dikë me të cilin të flisja/mbështetje morale	29	36	34
Mbështetje financiare	8	11	13
Ndihmë në lidhje me kërkesën për përfitim kompensimi/sigurimesh	4	4	5
Ndihmë për denoncimin e incidentit/marrëdhëniet me policinë	4	10	14
Ndihmë praktike	4	15	11
Ndihmë mjekësore	4	12	14
Mbrojtje nga viktimizimi/ngacmimi i mëtejshëm	4	34	21
Informacion nga policia	3	6	12
Informacion rreth sigurisë/parandalimit të krimit	1	6	10
Asnjë prej këtyre/nuk doja asnjë mbështetje	53	28	34

BAZA: Të gjitha gratë në Maqedoninë e Veriut të grup moshës 18-74 vjeçare të cilat kanë përjetuar dhunë fizike dhe / ose seksuale që nga moshja 15 vjeçare dhe të cilat kanë identifikuar incidentin më të rëndë: dhunë nga partneri aktual (85), partneri i mëparshëm (59) ose jo partner (107)

BURIM: Sondazh i drejtuar nga OSBE për dhunën ndaj grave (2018)

Viktimat e dhunës, që morën pjesë në intervistat e thelluara, deklaruan se problemet më të mëdha të pazgjidhura janë mbështetja financiare dhe strehimi afatgjatë i grave të cilat vendosin ta braktisin lidhjen e dhunshme. Ato thanë se, për momentin, që një grua ta braktis lidhjen e dhunshme mundësia e vetme është që familja e saj të jetë e gatshme ta pranojë atë dhe fëmijët e saj dhe t'i mbështesë derisa ajo të gjejë një punë. Ato shprehën bindje se gratë të cilat nuk kanë pasur mbështetje nga familjet e tyre nuk kanë mundur ta braktisin lidhjen e dhunshme, meqë nuk kanë pasur ku të shkojnë dhe nuk kanë pasur mjete për jetesë për vet ato ose për fëmijët e tyre. Ato thanë se grave duhet t'u ofrohen më shumë shërbime dhe mbështetje që të sigurojnë strehim dhe të gjejnë punë.


**“[Gruaja duhet] të sigurohet [përgjatë gjithë jetës], dhe jo vetëm të ndihmo-
het dy ose tre muaj, dhe pastaj të nxirret në rrugë. Dhe jo vetëm kaq, por ajo
ka nevojë për shtëpi dhe për ushqim. Ja, unë jam me aftësi të kufizuar dhe
punoj. Nuk turpërohem. Kam dy duar, dy këmbë, sy, pse të mos punoj?”**

Viktimë e dhunës, maqedonase etnike, person me aftësi të kufizuar

Gratë e përfshira me anketën u pyetën – pa marrë parasysh nëse kanë përjetuar dhunë ose jo – sa ndihen të informuara për atë se çka duhet të bëjnë nëse ndonjëherë përjetojnë dhunë. Qëndrimet ishin të ndara, me ç'rast thuaja se një e treta (32%) deklaruan se ndihen se janë shumë mirë të informuara ose mirë të informuara, ndërsa një numër pak më i madh i grave (35%) u përgjigjën se nuk janë të informuara mirë ose aspak nuk dinë se ç'të bëjnë. Pjesa tjetër prej 31% deklaruan se deri diku ndihen të informuara. Tek gratë më të reja ka më shumë mundësi të ndjehen shumë mirë të informuara ose më mirë të informuara nga gratë e moshuara. Kjo, po ashtu, vlen edhe për gratë me arsim të lartë, për dallim nga ato me arsim më të ulët (61% kundrejt 33% tek ato me arsim të mesëm). Gratë të cilat punojnë me pagesë kanë më shumë gjasa të ndihen të informuara (49%), ndërsa ato që janë të papunësuar ose pensionistet kanë më pak gjasa (26%). Gratë në mjediset urbane kanë më shumë gjasa të thonë se janë të informuara në lidhje me atë se çka duhet të bëjnë sesa ato në zonat rurale (36% kundrejt 24%), ndërsa vetëdija është po ashtu më e lartë tek gratë të cilat flasin gjuhën maqedonase sesa tek gratë të cilat flasin gjuhën shqipe (36% kundrejt 22%).

Grafiku 6.1: Vetëdija për atë se çka duhet të bëhet pas përjetimit të dhunës

Sa e mirëinformuar ndiheni rreth asaj që duhet të bëni nëse përjetoni dhunë?



6. Ndikimi i dhunës mbi jetën e grave dhe pengesat për të kërkuar mbështetje

Grave të përfshira në këtë sondazh iu parashtrua pyetja se a janë të njoftuara për ekzistimin e tri organizatave për mbështetje. Njohuritë për këto organizata janë të vogla, përkatësisht vetëm pak më shumë se një e treta e grave (36%) ishin të njoftuara për ndonjërin prej këtyre tri organizatave të testuara. Më saktë, rreth një e katërta deklaruan se kanë dëgjuar për NGCE (26%, dhe 19% e grave të cilat flasin në gjuhën shqipe) dhe HERA (24%, 13% e grave të cilat flasin shqip), ndërsa vetëm 13% deklaruan se janë të njoftuara me ESE (10% e grave të cilat flasin shqip). Këto njohuri të vogla ndoshta kontribuojnë për shfrytëzimin mjaft të ulët të këtyre shërbimeve nga ana e grave të cilat kanë përjetuar dhunë, siç është përshkruar në Pjesën 6.3 në vijim.


6.3: Denoncimi i rasteve të dhunës dhe ngacmimit

Grave të përfshira në këtë anketë iu parashtrua pyetja nëse policia ose organizatat e tjera janë njoftuar për incidentin më serioz të dhunës fizike ose seksuale ose të kërcënimit që e kanë përjetuar.

Madje edhe sa i përket incidentit më serioz të dhunës fizike dhe/ose seksuale, në shumicën e rasteve policia nuk ka pasur njohuri për këtë, veçanërisht për dhunën nga partneri aktual (Grafiku 6.2).

Grafiku 6.2. Kontakti me policinë pas incidentit më serioz të dhunës

A e mori vesh policia për incidentin [më serioz]?



Nuk është i mundshëm krahasimi i kontakteve me policinë ndërmjet grave të cilat flasin në gjuhën maqedonase dhe grave të cilat flasin në gjuhën shqipe, meqë vetëm 17 gra të cilat flasin në gjuhën shqipe treguan për incidentin më serioz të dhunës nga partneri ose jo-partneri. Megjithatë, gratë që konsiderohen si pjesë e pakicës në vendin ku jetojnë, kishin më pak gjasa të tregojnë se e kanë denoncuar në polici incidentin më serioz të dhunës, qoftë nga partneri aktual, nga partneri i mëparshëm ose nga jo-partneri (10%⁵⁸ kundrejt 33% mesatarisht). Sipas vendbanimit, gratë nga mjediset rurale të cilat kanë përjetuar dhunë nga partneri intim ose nga jo-partneri kishin gjasa të njëjta me gratë e mjedisëve urbane, të tregojnë se kanë kontaktuar me policinë pas incidentit më serioz (22% kundrejt 21%). Përveç kësaj, nuk ka dallime të konsiderueshme sa i përket vendbanimit kur bëhet fjalë për denoncimin e incidenteve tek shërbimet e tjera, siç janë shërbimet mjekësore ose sociale.

58 Duke e marrë parasysh bazën e vogël (n = 30), këto gjetje duhet të interpretohen me kujdes.

Rezistenca që dhuna të denoncohet në polici nga gratë që bëjnë pjesë në pakicën etnike u analizua në sondazhin cilësor të gratë me origjinë shqiptare. Sipas këtyre grave, viktimat e dhunës zakonisht përvojën e vet e ndanë dhe kërkon mbështetje vetëm nga ndonjë mik i afërt ose nga ndonjë anëtar i familjes, në vend që ta kontaktojnë policinë. Këto gra deklaruan se nuk iu besojnë nëpunësve policorë dhe i konsiderojnë si joefikas dhe apatik. Ato, veç tjerash, mendojnë se miqtë dhe familja e viktimës, sigurisht se do ta këshillonin të durojnë një kohë të caktuar, në vend që të kërkojnë divorcin. Kjo, mes tjerash, ka të bëjë me faktin se kur një grua do ta braktisë bashkëshortin e saj nuk do të ketë vend ku të shkojë, nëse familja e saj e lindjes nuk e pranon të kthehet pas, ndërsa sipas tyre, prindërit në përgjithësi nuk e mbështesin këtë veprim, veçanërisht në komunitetin mysliman shqiptar.

“Nëse prindërit e mi nuk më kuptojnë [se pse dua të divorcohem], nuk mund të luftoj e vetme, meqë [nuk] do të kem ku të jetoj”,

Grua, në moshë prej 18-34 vjeçare, shqiptare etnike, nga mjedisi rural

Në të njëjtën vijë me atë se gratë, të cilat flasin në gjuhën shqipe kanë më shumë gjasa të pajtohen me atë se dhuna në familje është çështje private dhe duhet të zgjidhet brenda familjes (67% kundrejt 42% të grave të cilat flasin në gjuhën maqedonase) gratë me origjinë etnike shqiptare në sondazhin cilësor deklaruan se denoncimi varet nga përkatësia etnike. Ato thanë se gratë maqedonase janë më të gatshme të kërkojnë ndihmë nga ndonjë organizatë, janë më mirë të informuara për shërbimet e disponueshme dhe në këtë drejtim do të kishin mbështetje nga familja e tyre. Nga ana tjetër, mendonin se një shqiptare do të druante të kërkojë ndihmë, fillimisht si rezultat i edukimit të saj kulturor dhe bindjes se gratë janë më pak të vlerësuara në shoqëri.

“[Gratë maqedonase] janë më përparimtare, më mirë i njohin ligjet, kanë më shumë mundësi. Familja [e tyre] i mbështet [ta ngrenë] zërin, ndërsa ne nuk e kemi [këtë mbështetje].”

Grua, në moshë prej 18-34 vjeçare, shqiptare etnike, nga mjedisi rural

Sondazhi zbuloi se gratë, pavarësisht se cilit grup i përkasin, i shmangen kontaktit me shërbime të tjera. Thuaja se nëntë nga dhjetë gra, që e treguan incidentin më serioz të dhunës nga partneri aktual, nuk kanë kontaktuar me policinë ose me ndonjë organizatë tjetër (86%), ndërsa e njëjta vlen edhe për incidentet më serioze të dhunës nga partneri i mëparshëm 66% dhe për incidentet më serioze të dhunës nga jo-partneri me 61 %.

86% e grave që kanë përjetuar dhunë seksuale dhe/ose fizike dhe që e treguan incidentin më serioz nuk i janë drejtuar policisë ose ndonjë organizate tjetër pas atij incidenti

Tabela 6.5: Kontaktet pas incidentit më serioz të dhunës ndaj grave

A keni kontaktuar ndonjë nga shërbimet e mëposhtme pas incidentit?

	Partneri aktual	Partneri i mëparshëm	Jo partneri
	%	%	%
Spitalin?	9	17	19
Doktorin, qendrën shëndetësore ose ndonjë institucion tjetër të kujdesit shëndetësor?	8	15	12
Shërbimet sociale	6	14	1
Polici (vet-denoncuar)	2	21	28
Organizatë kishtare/fetare?	1	2	7
Strehimoren e grave?	0	2	0
Organizatë që ofron mbështetje për viktimat?	0	1	0
Shërbim ligjor/avokat?	0	11	8
Organizatë/shërbim tjetër që ofron mbështetje?	0	2	0
Nuk është kontaktuar ndonjë organizatë ose policia	86	66	61

BAZA: Të gjitha gratë në Maqedoninë e Veriut të grup moshës 18-74 vjeçare të cilat kanë përjetuar dhunë fizike dhe / ose seksuale që nga moshë 15 vjeçare dhe të cilat kanë identifikuar incidentin më të rëndë: dhunë nga partneri aktual (85), partneri i mëparshëm (59) ose jo partneri (107)

BURIM: Sondazh i drejtuar nga OSBE për dhunën ndaj grave (2018)

Motivi kryesor për shkak të të cilit nuk kanë denoncuar në polici incidentet më serioze të dhunës, siç deklaruan të mbijetuarat korrespondojnë me atë se më shumë duan që ato vetë ta luftojnë këtë, ose ndoshta me miqtë dhe familjen, përkatësisht prioritet i tyre është incidenti të mbetet brenda familjes. Motiv tjetër është mundësia që incidenti të konsiderohet si i parëndësishëm, për shkak të turpit ose ndjenjës së pakëndshme, si dhe për shkak të frikës nga autori, siç është theksuar në Tabelën 6.6.

Gjetjet në sondazhin cilësor, në masë të madhe, korrespondojnë me sjelljen faktike e cila është evidentuar përmes sondazhit. Pjesëmarrëset shprehën bindje se dhuna nga jo-partneri me sa duket është e natyrës seksuale, ndërsa gruaja nuk e denoncon nga turpi, meqë pjesërisht ose plotësisht do të konsiderohet si përgjegjëse për atë që i ka ndodhur, madje edhe në raste të përdhunimit nga ndonjë person i panjohur. Ngjashëm me këtë, gratë që morën pjesë në sondazhin cilësor e ishin të qëndrimit se ka pak gjasa që një grua të denoncojë përvoja të DHPI. Ato thanë se nëse një grua do të kërkonte këshillë, ajo me gjasë do të përpiqej të bisedojë me mikeshat. Megjithatë, dhuna nga partneri perceptohet si diçka aq e rëndomtë saqë gratë nuk presin se ndonjë mikeshë e tyre të cilës do t'ia tregonin rastin do të shqetësohej shumë.

Sa u përket burimeve konkrete të mbështetjes, gratë me origjinë shqiptare theksuan se të kërkojë ndihmë nga psikiatri konsiderohet si diçka shumë e turpshme në komunitetin e tyre. Ato e arsyetuan këtë me faktin se ndryshe nga maqedonaset etnike, për një shqiptare etnike, vizita tek psikiatri është tabu-temë, ndërsa çdo grua që e ka bërë këtë do të etiketohet menjëherë nga komuniteti si mendërisht e sëmurë. Ato thanë se për maqedonaset etnike nuk është tabu-temë të kërkojë ndihmë nga psikiatri.

“Vizita tek psikiatri në shoqërinë tonë është tabu-temë, dhe të gjithë do të të konsiderojnë si të çmendur [nëse e bënë një gjë të këtillë].”


Grua, në moshë nga 35-50 vjeçare, shqiptare etnike, nga mjedisi urban

Nga ana tjetër, ato shpjeguan se edhe pse janë të vetëdijshme se gruaja e cila vuan nga dhuna fizike duhet të shkojë në spital, prapëseprapë nuk mendonin se shumë gra të komunitetit të tyre, të cilat kanë përjetuar dhunë, e kanë bërë këtë. Siç thanë ato, në vend të kësaj, gruaja do të përpiqet të përballë vet ose të kërkojë ndihmë nga familja e saj e lindjes. Në raste të rralla, kur megjithatë ndonjë grua ka shkuar në spital, ato thanë se ka shumë gjasa të ketë gënjyer për shkaqet e lëndimeve. Njëri nga shkaqet për një gjë të këtillë është frika se mjeku do ta raportojë incidentin në polici dhe se kjo do të shkaktojë probleme shtesë për gruan.

6. Ndikimi i dhunës mbi jetën e grave dhe pengesat për të kërkuar mbështetje

Tabela 6.6: Motivet për të cilat viktimat nuk e kanë kontaktuar policinë

Pse nuk kontaktuat me policinë?

	0%  62%		
	Partneri aktual	Partneri i mëparshëm	Jo partneri
	%	%	%
Arrita që ta zgjidhja vetë / përfshiva një shok ose shoqe / çështje familjare	50	62	36
Ishte diçka tepër e vogël / jo shumë serioze / nuk më kishte ndodhur kurrë	30	16	21
Kisha frikë nga personi që ma bëri	11	6	16
Kisha turp, siklet	15	18	15
Nuk mendova se do të bënin diçka	9	6	10
Nuk mendova se mund të bënin diçka	4	5	4
Nuk doja që ta merrte vesh njeri / doja ta mbaja të fshehtë	4	7	3
Nuk mund ta kontaktoj policinë për shkak të konfliktit	0	1	2
Shkova diku tjetër për ndihmë	4	6	2
Nuk do të më besonin	4	4	2
Mendova se ishte gabimi im	4	6	2
Isha tepër e ngarkuar emocionalisht për të kontaktuar me policinë	3	4	2
Nuk desha që partneri im të arrestohet ose të ketë probleme me policinë	3	11	-
Frika nga ndëshkimi nga dikush tjetër përveç partnerit	1	2	1
Dikush tjetër më ndaloi ose më dekurajoi mua	1	0	1
Nuk dëshiroja që lidhja të përfundonte	1	1	-
Kisha frikë se do të humbja fëmijët	1	-	-
Partneri im nuk më ka lejuar	1	0	-
Dikush tjetër e kishte denoncuar atë, ose policia e mori vesh për të vetë	0	0	3
Arsye tjetër	2	0	5

BAZA: Të gjitha gratë në Maqedoninë e Veriut të grup moshës 18-74 vjeçare të cilat kanë përjetuar dhunë fizike dhe / ose seksuale, por që nuk kanë kërkuar mbështetje nga organizatat pas incidentit më të rëndë: partner aktual (83), partner i mëparshëm (46), jo partner (82)

BURIM: Sondazh i drejtuar nga OSBE për dhunën ndaj grave (2018)

Motivet që i prezantuan, për shkak të të cilave gratë nuk i kontaktojnë shërbimet e tjera janë të ngjashme me ato që i kanë prezantuar për mos-kontaktimin me policinë.

Motivet e mos-denoncimit për të gjitha grupet etnike u diskutuan detajisht në sondazhin cilësor. Temat e përbashkëta detajisht janë përshkruar në Fushën 6.1 dhe më detajisht shqyrtohen në vijim

Kutia 6.1 Barrierat e denoncimit të DHNG të identifikuara në sondazhin cilësor përfshijnë:

1. **Turpin** - turpi se është sulmuar nga jo-partner ose turpi t'i kundërvihet partnerit të saj
2. **Shkaqet financiare** - nëse familja e gruas nuk e pranon, atëherë ajo nuk do të mund të kujdeset për vetveten dhe fëmijët e saj.
3. **Mungesën e informacioneve për shërbimet e disponueshme** - gratë nuk ishin të sigurt se ku duhet të drejtohen për ndihmë.
4. **Mosbesimin ndaj shërbimeve** - mendim i keq, turp për shkak të sulmit nga jo-partneri ose turp për t'iu kundërvënë partnerit para shërbimeve, për shkak të presupozimit se me gjasë nuk do të japin përgjigje profesionale ose të favorshme.
5. **Frikën** - se autori do ta kuptojë dhe kjo do ta rëndojë dhunën.
6. **Mosnjohjen e asaj që konsiderohet dhunë** - presupozime se shumica e llojeve të dhunës nuk do të kuptohen

Sipas grave të cilat morën pjesë në sondazhin cilësor, turpi është pengesa më e madhe për shkak të së cilës gratë nuk e denoncojnë dhunën. Gratë e anketuara deklaruan se nëse i besohen ndonjë familjareje, si për shembull nënës së tyre, ajo do ta nxisë që formalisht të mos e denoncojë dhunën për shkak të turpit që do t'ia shkaktojë edhe gruas edhe familjes. Turpi, me sa duket, ka të bëjë me faktin se nga një grua pritët ta durojë vuajtjen dhe të mos e braktisë martesën.

“Gratë mësohen të jenë të qeta dhe të durojnë padrejtësi, me qëllim që t'i mbrojnë fëmijët e tyre. Çdo veprim që do ta ndërmerr gruaja që ta pengojë dhunën konsiderohet si i turpshëm.”

Viktimë e dhunës, shqiptare etnike, nga mjedisi urban

Veç tjerash, gratë mund të ballafaqohen edhe me vështirësi financiare nëse tentojnë **ta braktisin partnerin e tyre**. Sipas grave të cilat morën pjesë në sondazhin cilësor, vetëm një grua e pavarur nga aspekti financiar, mund ta braktisë bashkëshortin. Ato pastaj besojnë se kjo është pak e mundshme, meqë gratë fitojnë më pak se burrat dhe kanë më pak gjasa të posedojnë pronë personale ose të kenë trashëgimi. Madje edhe në rastin kur çifti bashkëshortor ka blerë pronë, gruaja nuk ka të drejtë të kërkojë një pjesë të pronës. Kjo do të thotë se gruaja duhet të llogarisë në familjen e saj që të kujdeset për atë nëse e braktisë bashkëshortin, ndërkaj gratë çdoherë nuk mund ta llogarisin në këtë mbështetje.

“Ai tha: “nuk guxon të vijë më në shtëpinë time”. [Ai tha] unë kam vjedhur nga ai. Si mund të vjedhë në shtëpinë time: Unë jam invalid dhe punoj, veç kësaj edhe jam rrahur.”

Viktimë e dhunës, maqedonase etnike, person me aftësi të kufizuar

Gratë të cilat morën pjesë në sondazhin cilësor, mesa duket, **nuk ishin mjaft të njoftuara** se ku mund të kërkojnë mbështetje (siç u theksua më lartë, informimi për organizatat e specializuara për mbështetje për të cilat u pyetën në këtë sondazh, është i keq). Gratë, në mjediset rurale, shprehën bindje se nuk ka shërbime të disponueshme për mbështetjen e grave. Gratë në mjediset urbane u njoftuan me ekzistimin e strehëzave për gra, megjithatë i vunë në dukje pengesat e shumta për shfrytëzimin e tyre. Fillimisht ato shprehën bindjen se strehëzat janë vetëm për mbështetje emergjente me afat të shkurtër që do të thotë se gratë të cilat në momente të caktuara i janë ekspozuar dhunës ndoshta do të duhet të kthehen të jetojnë me autorin, megjë nuk do të kenë rrugëdalje tjetër. Disa gra, po ashtu ishin të mendimit se strehëzat janë të disponueshme vetëm brenda ditës, dhe mund të ndodhë që të jenë të mbyllura kur do t'iu duhen. Disa nga gratë, madje e vunë në pikëpyetje sigurinë e strehëzave, megjë lokacionet e tyre janë publikisht të njohura dhe se kjo i ekspozon gratë në rrezik.

“S’ke ku të fshihesh. Shkoni tek shërbimet sociale, kurse personat zyrtarë do t’jua bëjnë fjalën dhe i gjithë qyteti do ta kuptoj historinë tuaj. Ata do t’ia tregojnë mikeshës, ajo mikeshë do t’ia tregoj mikeshës tjetër, ajo mikeshë do t’i tregoj burrit, dhe ai do të vijë dhe do të dërmojë.”

Grua, në moshë prej 35-50 vjeçare, maqedonase etnike, nga mjedisi rural

Të anketuarat kishin mendim të keq për nëpunësit të cilët punojnë në shërbimet përkatëse (siç është policia ose punonjësit shëndetësorë) dhe thanë se ka pak gjasa ta denoncojnë dhunën tek ata. Kjo, zakonisht mbështetet në përvojat negative personale ose në përvojat e njerëzve që i njohin. Ato thanë se ofruesit e shërbimeve madje nuk do të shprehin ngushëllime për situatën e tyre, dhe as nuk do t’u japin ndonjë përgjigje të favorshme.

Gratë romë deklaruan se ka mundësi që policia të mos i përgjigjet rastit të DHPI në komunitetin rom. Disa madje thanë se ka pasur raste që policia t’i akuzojë se ua shpenzojnë kohën ose se bëjnë zhurmë ose se nuk bëjnë asgjë që ta parandalojnë DHPI që përsëri të ndodh në të ardhmen.

“Është një grua me gjashtë fëmijë të cilën disa herë e rrahën dhe e nxorën nga shtëpia. Shkoi në polici, dy ose tri herë, dhe e denoncoi [bashkëshortin e saj]. Meqë policia e lëshoi ... ju shkoni e denonconi, por policia nuk bën asgjë ... ai tanimë e ka përgjakur, e ka dërmuar ... por ajo nuk ka ku të shkojë.”

Grua, në moshë prej 20-40 vjeçare, romë etnike, nga mjedisi urban

Një barrierë tjetër e madhe është frika **se denoncimi do ta përkeqësojë dhunën**. Kjo ndërlikohet me mosbesimin ndaj shërbimeve për shkak të presupozimit se ato sigurisht nuk do ta ruajnë konfidencialitetin nëse viktimat kërkojnë një gjë të këtillë. Kjo, nga ana tjetër, do t’i zbrapsë të gjithë ato që dëshirojnë ta denoncojnë dhunën në emër të dikujt tjetër, megjë gratë konsiderojnë se autori do të mund të vë kontakt me policinë dhe të zbulojë kush e ka denoncuar. Kjo mungesë e konfidencialitetit e vë në rrezik gjithsecilin që do të përpiquej të denoncojë dhunën.

“Shoqëria nuk reagon ... frika na pengon të reagojmë, ndërsa kultura jonë – në vende tjera ata vetëm do ta thërrasin policinë – por këtu, nëse e kuptojnë kush ka denoncuar, personi do të jetë në rrezik.”

Grua, në moshë prej 55-74 vjeçare, maqedonase etnike, nga mjedisi urban

Në kuptimin më të gjerë, gratë të cilat morën pjesë në sondazhin cilësor deklaruan se në shoqëri nuk është mjaft e qartë çka nënkupton dhuna. Ato thanë se “dhuna më e vogël fizike dhe dhuna seksuale në marrëdhënie konsiderohet si sjellje normale dhe se dhuna psikologjike nuk konsiderohet fare si dhunë. Gratë shprehën bindjen se vetëm dhuna serioze fizike, e cila ka rezultuar me lëndime të dukshme mund të merret seriozisht, madje edhe kjo varet nga pikëpamjet e personit të cilin e kanë denoncuar.

Nëse një grua ka nevojë për ndihmë që ta braktisë bashkëshortin ose partnerin e saj, sipas grave në sondazhin cilësor, më së miri do të ishte të kërkojë ndihmë nga anëtarët e familjes. Ato thanë se familja e lindjes së gruas ka gjasa të jetë burim i mbështetjes praktike dhe emocionale në situata të këtilla, por vetëm nëse gruaja ka përjetuar dhunë serioze fizike. Ato besojnë se gruaja nuk do të ketë kurrfarë ndihme që ta braktisë partnerin për shkak të dhunës psikologjike, seksuale ose financiare.

“Disa familja madje do të thonë se vet e ka kërkuar; disa të tjera mund të thonë se nuk kanë “fëmijë për ta hedhur”, dhe do ta pranojnë vajzën e tyre të kthehet në shtëpi.”

Grua, në moshë prej 55-74 vjeçare, maqedonase etnike, nga mjedisi urban

Madje edhe në raste të dhunës fizike, gratë pjesëmarrëse deklaruan se gruaja ndoshta edhe nuk mund të mbështetet në familjen e saj të lindjes, meqë DHPI mund të perceptohet si një dukuri normale dhe të pritët nga gruaja të vazhdojë të jetojë me bashkëshortin e saj. Gratë e intervistuar thanë se ka pasur dallim sa i përket nivelit të përgjegjësisë që e kanë ndier familjet e lindjes ndaj vajzave të tyre, me ç'rast disa ishin të mendimit se ndonjë familje nuk do të ndjejë obligim ndaj vajzës së tyre pasi të martohet, meqë ajo pastaj perceptohet si pjesë e një familjeje tjetër, familje në të cilën është martuar.

“Një fakt mirë i njohur është se në vendin tonë, burrave iu takon e gjithë pasura e prindërve të tyre. Pra, nëse gruaja vendosë ta braktisë martesën e dhunshme, ajo thuaja se asnjëherë nuk ka pronë në emër të saj që të shpërngulet, ndërsa prindërit e saj jo çdoherë i japin mbështetje, veçanërisht në komunitetin mysliman. Së këtejmi, për shkak të idesë neveritëse që të jesh i pastrehë, shpeshherë gratë vendosin ta vazhdojnë jetën në martesën e dhunshme dhe pa harmoni.”

Grua, në moshë prej 18-34 vjeçare, shqiptare etnike, nga mjedisi rural

Viktimat e dhunës që morën pjesë në sondazhin cilësor deklaruan se askujt nuk i tregojnë për përvojat e tyre tanimë disa vjet. Kur më në fund i kanë treguar dikujt, ky zakonisht ka qenë ndonjë anëtar i familjes që të kërkojnë mbështetje praktike për ta braktisur partnerin e dhunshëm ose i kanë treguar ndonjë mikeshe për shkak të mbështetjes emocionale. Gratë e ndërmarrin këtë hap vetëm pasi të përjetojnë dhunë serioze fizike ose seksuale, ndonjëherë edhe pas disa viteve. Gratë, të cilat i kanë denoncuar më vonë përvojat e tyre në polici, në Qendrën për Punë Sociale ose në organizatë joqeveritare, këtë e kanë bërë meqë janë inku-rajuar nga miqtë ose familjarët. Asnjë grua nuk i është drejtuar drejtpërdrejt burimit formal për mbështetje, pa e shkëmbyer përvojën e saj me ndonjë burim joformal.

Denoncimi i ngacmimit seksual

Thuaja se gjysma e atyre që janë ballafaquar me ngacmim seksual nuk kanë biseduar me askënd për përvojën e tyre (47%). Sipas tyre, ato kanë menduar se mund t'ia dalin vet me këtë problem, i kanë treguar mikeshës ose kanë menduar se kjo është çështje familjare (68%) ose meqë kanë menduar se është tepër e parëndësishme ose asnjëherë nuk u ka shkuar ndërmend t'i tregojnë dikujt (32%).

Për ato gra të cilat kanë treguar për ngacmimin seksual, njerëzit më të shpeshtë me të cilët kanë biseduar kanë qenë anëtarët e familjes/familjarë ose miqtë (19%), pastaj partneri/i dashuri i tyre (11%). Gratë nuk mendojnë t'u drejtohen shërbimeve, policisë ose organizatave speciale për mbështetje.

6.4: Kënaqësia nga shërbimet

Shkalla e ulët e denoncimit në polici, si dhe në organizatat e tjera e kufizojnë shkallën deri te e cila mund të vlerësohet kënaqësia nga shërbimet. Në numrin e vogël të grave, të cilat e kanë denoncuar incidentin më serioz të *ngacmimit* seksual, numri i të pakënaqurave është më i madh nga numri i grave të kënaqura nga përgjigjet e policisë. Sa i përket incidentit më serioz të *dhunës nga jo-partneri* mendimet janë të ndara, me ç'rast 51% deklaruan se janë të kënaqura dhe 42% se janë të pakënaqura. Këto rezultate deri në një shkallë i pasqyrojnë mendimet e prezantuara në sondazhin cilësor në lidhje me efektivitetin e shërbimeve për mbështetje.

Në mesin e viktimave të dhunës në sondazhin cilësor të cilat i kanë denoncuar përvojat e tyre ose kanë kërkuar ndihmë formale, kënaqësia varion. Gratë të cilat i kanë denoncuar përvojat e tyre në polici, zakonisht kanë qenë të pakënaqura nga mënyra e veprimit të policisë ndaj rastit dhe e kanë pasur ndjenjën se ankesa e tyre është injoruar plotësisht ose se nuk është vepruar aq sa duhet për rastin në fjalë. Gratë deklaruan se policia ka refuzuar ta shqyrtojë rastin e dhunës, meqë ka kaluar shumë kohë dhe kanë qenë të mendimit se nuk ka prova ose thjeshtë meqë viktima ka shkuar në stacionin e policisë pa dokument identifikimi.

Përvojat nga Qendra për Punë Sociale dhe mbështetja e OJQ-ve kanë tendencë që të jenë më pozitive. Gratë janë mjaft falënderuese për mbështetjen psikologjike që e kanë pasur që t'i luftojnë përvojat e tyre. Megjithatë gratë u ankuan se nuk ka mbështetje praktike, si për shembull strehimi afatgjatë, mbështetje financiare ose ndihmë në gjetje të punës dhe kjo paraqet pengesë të rëndësishme për gratë të cilat e braktisin marrëdhënien e dhunshme dhe fillojnë një jetë të re.



7. Përvojat e dhunës tek grupet e caktuara të grave

Gjatë sondazhit u mblodhën një sërë detaje nga të anketuarit, në mënyrë që të sigurohet një analizë më e detajuar e shkallës së luftimit të dhunës nga grupet e ndryshme të grave. Qëllimi ishte të përcaktohet prevalenca dhe rreziku nga dhuna tek disa grupe të caktuara. Ky kapitull fokusohet mbi dallimet e rëndësishme të përvojave të denoncuara të të gjitha formave të dhunës, përfshirë këtu edhe ngacmimin seksual tek grupet e ndryshme të grave.

Mosha

Aty ku ka dallime sipas moshës, çdoherë gratë më të reja janë ato të cilat më së shpeshti i ndajnë përvojat e ngacmimit dhe dhunës.

Shtirja individuale e dhunës fizike nga jo-partneri nga mosha 15 vjeçare nuk dallon për nga mosha, edhe pse gratë e moshës prej 18-29 vjeçare ka më shumë gjasa të tregojnë se kanë përjetuar dhunë në 12 muajt para sondazhit sesa shkalla mesatare (4% kundrejt 2%). Edhe pse nuk ekzistojnë dallime të evidentuara në prevalencën e dhunës fizike dhe/ose seksuale nga partneri aktual, përafërsisht rreth dyfish më shumë gra të reja (18-39) deklaruan se kanë përjetuar përvoja të këtitlla me partnerin e mëparshëm nga mosha 15 vjeçare, prej atyre që janë në moshë mbi 40 vjeçare (16% kundrejt 9%).

Prevalenca e përcaktuar e dhunës psikologjike e ushtruar nga partnerët është më e lartë tek gratë e reja. Për shembull, më shumë se gjysma (53%) e grave në moshë prej 18-29 vjeçare të cilat në të kaluarën kanë pasur partnerë deklaruan se kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës psikologjike nga ana e partnerit aktual ose partnerit të mëparshëm në krahasim me pak më shumë se një të tretën e grave (36%) prej atyre në moshë mbi 60 vjeçare.

Gratë në moshë prej 18 deri 39 vjeçare kishin më shumë gjasa të tregojnë se kanë përjetuar ndonjë formë të ngacmimit seksual sesa gratë në moshë mbi 40 vjeçare. Kjo vlen edhe për përvojat nga mosha 15 vjeçare (40% kundrejt 22%), si dhe për përvojat në 12 muajt para sondazhit (17% kundrejt 5%). Mund të presupozohet se gjatë gjithë jetës, gratë e moshuara kanë qenë viktimat të ngacmimit, madje po aq shpesh sa edhe gratë e reja. Dyfish më shumë gra të moshuara nga gratë e reja të cilat thanë se kanë pasur një ose më shumë përvoja të ngacmimit mbase e vë në dukje ndryshimin e pikëpamjeve në lidhje me atë që është e pranueshme.

Incidentet e ndjekjes po ashtu janë me numër më të madh tek grupmosha më e re si nga mosha 15 vjeçare (11% kundrejt 7% mesatarisht), ashtu edhe në 12-të muajt para sondazhit (5% kundrejt 2%). Ashtu si edhe me ngacmimin seksual, ky mund të jetë një reflektim i dallimeve të gjeneratave sa u përket pikëpamjeve ndaj këtyre llojeve të sjelljes.

Statusi i lidhjes

Të dhënat u analizuan në lidhje me atë nëse e anketuara ka partner aktual (për momentin është në martesë, bashkëjeton pa qenë në martesë ose është në lidhje pa bashkëjetuar), në të kaluarën ka pasur partner (definicionet e njëjta si partneri aktual) ose asnjëherë nuk ka pasur partner intim.

Gratë të cilat në të kaluarën kanë pasur partner kishin më shumë gjasa prej atyre të cilat nuk kanë pasur, të tregojnë se kanë përjetuar ngacmim seksual nga mosha 15 vjeçare (49% kundrejt 20%) dhe në 12 muajt para anketës (18% kundrejt 6%). Ato kishin po ashtu më shumë gjasa të tregojnë se kanë përjetuar dhunë fizike dhe seksuale nga jo-partneri. Nga mosha 15 vjeçare, 13% e grave të cilat në të kaluarën kanë pasur partner, deklaruan se kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jo-partneri në krahasim me 4% prej atyre të cilat në të kaluarën nuk kanë pasur partner. Prevalenca e dhunës fizike dhe/ose seksuale nga jo-partneri në 12 muajt para sondazhit po ashtu është më e lartë tek ky grup (4% kundrejt 1%). Pastaj, gratë të cilat kanë pasur ish-partnerë kishin më shumë gjasa të tregojnë se kanë përjetuar dhunë fizike nga partneri aktual (9%) prej atyre të cilat nuk kanë pasur ish-partner (5%). Prevalenca këtu nuk dallon nga ajo që ka të bëjë me kohën në 12 muajt para sondazhit.

Arsimi

Gjatë sondazhit, gratë u pyetën për nivelin më të lartë të arsimit që e kanë kryer, dhe u kategorizuan në tri grupe: ato me arsim fillor, të mesëm dhe të lartë. Rreth 8% e grave të anketuara nuk kishin arsim formal.

Ngacmimi seksual ishte më shpesh i apostrofuar prej atyre me arsim të lartë. Më shumë se një e treta (35%) nga ato me arsim të mesëm dhe 44% nga ato me arsim të lartë kanë pasur një ose më shumë përvoja të kësaj natyre nga mosha 15 vjeçare. Kjo është kundrejt atyre me 13% të cilat nuk kanë arsim formal ose kanë vetëm arsim fillor. Gratë me nivele më të larta të arsimit kishin më shumë gjasa të tregojnë se kanë përjetuar ndjekje nga mosha 15 vjeçare (10% me arsim të lartë kundrejt 1% pa arsim formal).

Shkalla e atyre të cilat zbuluan dhunë fizike nga jo-partneri është më e lartë tek gratë me nivel të arsimit më të lartë nga mesatarja, si për dhunë të përjetuar nga mosha 15 vjeçare (9% tek ato me arsim të lartë, kundrejt 6% nga numri i përgjithshëm) ashtu edhe në 12 muajt para sondazhit (4% kundrejt 2%).

Nga ana tjetër, ato me nivel më të ulët të arsimit kishin më shumë gjasa të hedhin dritë mbi atë se kanë përjetuar dhunë nga partneri aktual. Pak më shumë se gjysma e grave të cilat nuk kanë arsim formal deklaruan se kanë pasur së paku një përvojë të dhunës psikologjike, përfshirë këtu edhe nga partneri aktual (52%), në krahasim me 35% prej atyre me arsim të lartë. Dhuna fizike nga partneri aktual është po ashtu mjaft e pranishme tek ato pa arsim sesa tek ato me arsim të lartë (12% kundrejt 4%).

Statusi i punës dhe profesioni

Gratë të cilat marrin pagë ose janë të vetëpunësuar (40%) ose janë studente/nxënëse/në trajnim⁵⁹ (47%) kishin gjasa dukshëm më të mëdha sesa mesatarja (30%) të tregojnë se kanë përjetuar ngacmim seksual nga mosha 15 vjeçare, ndërsa tek ato gra, aktiviteti kryesor i të cilave janë punët e shtëpisë, gjasat janë dukshëm më të ulëta (9%). Elementi i moshës ose i arsimit mund të kontribuojë në këto dallime, por po ashtu është e mundshme që gratë e punësuar dhe studentet/nxënëset të jenë më të ekspozuara ndaj sjelljeve të këtylla, nëse janë më shpesh në shoqëri me të tjerë.

59 Duke e pasur parasysh bazën e vogël (n = 52), këto të dhëna duhet të interpretohen me kujdes.

7. Përvojat e dhunës tek grupet e caktuara të grave

Dhuna fizike nga jo-partneri po ashtu është apostrofuuar më shumë nga nxënëset/studentet, me ç'rast 12% deklaruan se këtë lloj të dhunës e kanë përjetuar nga mosha 15 vjeçare. Kjo është më shumë sesa prevalenca mesatare (6%) dhe ajo që u theksua prej atyre të moshës nga 18-29 vjeçare, në grupmoshën në të cilën bëjnë pjesë thuaja se të gjitha nxënëset.

Prevalenca e dhunës psikologjike nga partneri aktual është më e ulët nga mesatarja tek gratë e punësuara (35%) dhe veçanërisht në krahasim me gratë e papunësuara, prej të cilave 50% deklaruan se kanë pasur së paku një përvojë, në krahasim me 47% prej atyre që i kryejnë obligimet e shtëpisë.

Të ardhurat

Gratë, të cilat morën pjesë në këtë sondazh, u analizuan sipas katër grupeve të të ardhurave: ato të cilat jetojnë komodë me të ardhurat aktuale (të familjes), ato të cilat ia dalin në krye, ato të cilat ballafaqohen me vështirësi dhe ato të cilat ballafaqohen me shumë vështirësi që t'ia dalin në krye. Zakonisht, gratë e dy kategorive të fundit, veçanërisht ato të cilat jetojnë në familje me financa shumë të kufizuara, deklaruan se kanë përjetuar më shumë dhunë.

Gratë të cilat e kanë vështirë të jetojnë me të ardhurat e tyre aktuale të familjes kanë tre deri katër herë më shumë gjasa të tregojnë se kanë përjetuar dhunë fizike dhe ose seksuale nga partneri aktual prej atyre që jetojnë në komoditet (20% kundrejt 6%). Prevalenca e dhunës psikologjike nga partneri aktual është shumë më e lartë tek ato të cilat ballafaqohen me vështirësi me të ardhurat aktuale të familjeve të tyre (57% kundrejt 39% të cilat jetojnë në komoditet), ndërkohë që e njëjta vlen edhe për dhunën seksuale nga partneri i mëparshëm (13% kundrejt 1%).

Grupe të pakicave

Gratë, po ashtu, u pyetën a e konsiderojnë vetveten si pjesë të *pakicës etnike, pakicës imigrante, pakicës fetare, pakicës seksuale, pakicës nga aspekti i aftësisë së kufizuar, refugjatë ose person i shpërngulur ose i rikthyer në vendin ku ato kanë jetuar në kohën e sondazhit*. Në përgjithësi, 8% deklaruan se i përkasin pakicës etnike lokale dhe 6% deklaruan se i përkasin pakicës fetare (një numër shumë i vogël u prononcuan se janë pjesë e njërit nga grupet e lartpërmendura). Krahasimi i këtyre dy grupeve me mesataren ose me ato të cilat nuk i përkasin grupit minoritar, tregon se gratë e pakicës etnike kanë shumë gjasa që të përjetojnë dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jo-partneri, si nga mosha 15 vjeçare (12% kundrejt 7% mesatarisht) ashtu edhe në 12 muajt para sondazhit (5% kundrejt 2%). Sa i përket dhunës nga partneri, dhuna psikologjike nga partneri aktual është më e shpeshtë (52% kundrejt 42%), por dallimet janë të papërfillshme.

Veç tjera, të dhënat u **analizuan edhe sipas gjuhës në të cilën u realizua anketa**, me ç'rast u mundësua krahasimi midis grave të cilat flasin në gjuhën maqedonase dhe të atyre që flasin në gjuhën shqipe.

Gratë të cilat flasin në gjuhën shqipe raportuan një nivel më të ulët të ngacmimit seksual, ndjekjes, dhunës në fëmijëri, të dhunës nga jo-partneri dhe dhunës fizike nga partneri intim. Prevalenca e prezantuar e dhunës psikologjike dhe seksuale nga partneri intim është e ngjashme ndërmjet grave të cilat flasin në gjuhën shqipe dhe grave të cilat flasin në gjuhën maqedonase.

Gratë romë, të cilat morën pjesë në sondazhet cilësore, deklaruan se shumë lloje të dhunës fizike konsiderohen si të pranueshme në komunitetin rom, meqë gruaja i përket bashkëshortit dhe se bashkëshorti ka të drejtë ta godasë me shuplakë. Ato, mes tjerash, theksuan se disa lloje të dhunës fizike perceptohen si shenjë e dashurisë së zjarrtë ose pasionante, veçanërisht tek vajzat e reja dhe se kjo sjellje e bën lidhjen pozitive.

Vendbanimi

Të dhënat u analizuan sipas asaj nëse gratë jetojnë në mjedise urbane ose rurale. Siç mund të shihet në Tabelën 7.1, prevalenca e prezantuar e shumicës së formave të dhunës është më e lartë tek gratë të cilat jetojnë në mjediset urbane sesa tek gratë të cilat jetojnë në mjedise rurale. Për shembull, 37% e grave të cilat jetojnë në mjedise urbane deklaruan se janë abuzuar seksualisht nga mosha 15 vjeçare, në krahasim me 18% të atyre të cilat jetojnë në mjedise rurale. Prevalenca e ndjekjes, dhuna fizike nga partneri intim dhe dhuna në fëmijëri është po ashtu më e lartë tek gratë të cilat jetojnë në mjedise urbane.

Tabela 7.1: Prevalenca e dhunës që nga mosha 15 vjeçare (duke përjashtuar dhunën në fëmijëri), sipas vendbanimit

	Mjedisi urban %	Mjedisi rural %
Ngacmim seksual	37	18
Dhunë fizike nga jo partner	6	6
Dhunë seksuale nga jo partner	2	1
Ndjekje	9	3
Dhunë psikologjike nga partner intim	42	48
Dhunë fizike nga partner intim	10	6
Dhunë seksuale nga partner intim	3	3
Dhuna në fëmijëri	11	6

BAZA: Të gjitha gratë në Maqedoninë e Veriut të grup moshës 18-74 vjeçare që jetojnë në mjedis urban (1,117) ose në mjedis rural (793), ose gratë nga mjedisi urban (1,046) ose mjedisi rural (732) që kanë pasur ndonjëherë partner

BURIM: Sondazh i drejtuar nga OSCE për dhunën ndaj grave (2018)

Dhuna fizike dhe psikologjike më tepër paraqitet nga gratë partnerët e të cilave nuk kanë pasur arsim formal

Gratë me fëmijë

Gratë pa fëmijë kanë përvojë dukshëm të ndryshme sa i përket ngacmimit seksual në krahasim me gratë me fëmijë: 46% e grave pa fëmijë kanë përjetuar ngacmim seksual nga mosha 15 vjeçare në krahasim me 25% të grave me fëmijë, ndërsa 22% e grave me fëmijë kanë përjetuar ngacmim seksual në 12 muajt para sondazhit, në krahasim me 7% të atyre që nuk kanë fëmijë. Ndjekja është po ashtu më e pranishme tek ato gra të cilat nuk kanë fëmijë (5% prej atyre me fëmijë, në krahasim me 13% prej atyre pa fëmijë). Ngjashëm me këtë, 10% e grave pa fëmijë kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jo-partneri, në krahasim me 6% të grave me fëmijë. Prevalenca e dhunës nga partnerët aktual nuk dallon ndërmjet atyre me dhe pa fëmijë, por dhuna paraprake fizike nga partneri më shpesh zbulohet prej grave të cilat nuk kanë fëmijë (15% kundrejt 9% nga ato të cilat kanë fëmijë).

Karakteristikat e partnerit

U mbledhën informata lidhur me moshën, arsimin, marrëdhënien e punës dhe për përvoja dhe sjellje të caktuara të partnerit të respondenteve. Dy fushat në të cilat dallimet janë mjaft konsekuente në lidhje me prevalencën e dhunës është niveli i arsimit të partnerit dhe shkalla deri në të cilën partneri konsumon alkool.

Së këtëjmi, numri i partnerëve të cilët nuk kanë arsim formal është i ulët (baza nga 49). Dhunën psikologjike më shpesh e përmendën gratë partnerët e të cilave nuk kanë arsim formal (66%) kundrejt mesatares (42%). Nga ana tjetër, ky numër bie në 34% te gratë partnerët e të cilave kanë arsim të lartë. E njëjta vlen edhe për dhunën fizike, si nga mosha 15 vjeçare (15% e atyre partnerët e të cilave nuk kanë arsim formal kundrejt 6% të atyre partnerët e të cilave kanë së paku arsim fillor) ashtu edhe në 12 muajt para sondazhit (7 % kundrejt 2%).

Gratë, partnerët e të cilave asnjëherë nuk konsumojnë alkool, mesa duket, kanë më pak gjasa të përjetojnë dhunë nga partneri intim, sesa ato gra partnerët e të cilave konsumojnë alkool dhe kjo ka të bëjë me të gjitha format e dhunës: psikologjike, fizike dhe seksuale.



8. Konkluzionet kryesore dhe rekomandimet

Rezultatet e anketës dhe të sondazhit cilësor vënë në dukje tre konkluzione kryesore dhe rekomandime për zgjidhjen e tyre, në mënyrë që të reduktohet dhuna ndaj grave në këtë vend:

1) Dhuna ndaj grave është pranuar gjerësisht si diçka normale dhe nuk denoncohet

Sipas përvojave të cilat i kanë zbuluar gratë në këtë sondazh, thuaja se gjysma e grave (45%) ballafaqohet me dhunë nga partneri intim. Thuaja se një nga dhjetë gra (9%) janë ballafaquar me dhunë fizike nga ana e partnerit, ndërsa 44% kanë përjetuar dhunë psikologjike. Megjithatë, gratë e përfshira me sondazhin cilësor deklaruan se në shoqëri nuk është mjaft e qartë se çka nënkupton dhuna ndaj grave. Disa forma të dhunës fizike, siç është goditja me shuplakë dhe dhuna seksuale konsiderohen si normale, ndërsa dhuna psikologjike aspak nuk konsiderohet si dhunë. Gratë e përfshira në këtë sondazh deklaruan se besojnë se thuaja se në çdo marrëdhënie intime mes partnerëve ekziston ndonjë lloj dhune.

Thuaja se gjysma (48%) e grave të anketuara pajtohen se dhuna në familje është çështje private, ndërsa përafërsisht tri nga dhjetë gra (28%) mendojnë se dhuna shpeshherë nxitet nga viktima. Përdhunimin martesor, i cili konsiderohet si diçka normale, legjislacioni e trajton në mënyrë të diferencuar nga përdhunimi prej personit të panjohur, ndërsa Kodi Penal kërkon nga viktima të parashtrojë padi private, në vend që ta ndjek sipas detyrës zyrtare. Meqë që të dëshmohet përdhunimi fillimisht duhet të dëshmohet se është përdorur forcë ose është përdorur kërcënim për zbatimin e forcës, gratë vështirë vendosin ta denoncojnë rastin, veçanërisht kur veprën e ka ushtruar partneri në marrëdhënie intime.

Edhe pse një e treta e grave (32%) thanë se ndihen shumë mirë ose mirë të informuara, ndërsa 31% se janë pak të informuara lidhur me atë se çka duhet të bëjnë në rast të dhunës, vetëm 2% nga gratë e mbijetuara nga dhuna nga partneri aktual dhe 21% nga gratë e mbijetuara nga dhuna e partnerit të mëparshëm e kanë denoncuar dhunën në polici. Turpi dhe mosbesimi ndaj policisë i pengon gratë që ta denoncojnë veprën. Ekspertët e anketuar, po ashtu, shprehën bindje se personeli i cili punon në shërbimet përkatëse (polici, shërbimet sociale dhe punonjësit shëndetësorë) nuk kanë njohuri adekuate dhe mirëkuptim. Ekspertët u prononcuan se nuk mjafton që personeli në shërbimet përkatëse të marrë pjesë në trajnim të njëfishtë për dhunën gjinore. Në vend të kësaj, ekspertët u prononcuan për një qasje më sistematike në drejtim të përmirësimit të njohurive dhe praktikave të punës së shërbimeve profesionale.

Në këndvështrimet përfundimtare nga viti 2018, Komiteti i CEDAW rekomandoi të miratohet strategji gjithëpërfshirëse për eliminimin e stereotipave gjinore dhe të praktikave të dëmshme ndaj grave. Kjo strategji duhet t'i përfshijë materialet arsimore dhe ta përfshijë sistemin arsimor, prindërit dhe shoqërinë civile. Nga ana tjetër, shteti duhet t'i shqyrtojë dispozitat neutrale gjinore në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, me qëllim të përfshirjes së dimensioneve gjinore të dhunës në familje. Komiteti, veç tjerash, kërkoi nga shteti ta ndryshojë Kodin Penal, me qëllim që të sigurohet ndjekja penale e përdhunimeve martesore dhe përkufizimi i përdhunimit të bazohet në mungesën e pajtimit.

2) Mungesa e strehëzave dhe qëndrueshmëria e shërbimeve ekzistuese

Si nevoja më të mëdha të pa përmbushura të cilat i identifikuan gratë është mungesa e ndihmës financiare dhe të strehëzave afatgjata. Gratë dhe ekspertët kryesorë në sondazhin cilësor ranë dakord se nuk ka **numër të mjaftueshëm të strehëzave për gratë**. Edhe pse u hapën disa strehëza të reja ku grave u ofrohet mbrojtje shëndetësore dhe policore (klinika për referimin e sulmit seksual), akoma ekziston mungesë e qendrave të cilat do ta siguronin strehimin. Strehëzat për gra fillimisht janë vendosur në qytetet e mëdha dhe nuk janë të disponueshme për të gjitha gratë e vendit. Vetëm rreth një e treta e grave të anketuara janë të njoftuara për shërbimet e specializuara të disponueshme për mbështetje. Ekspertët theksuan se jo vetëm që nuk ka numër të mjaftueshëm të strehëzave, por edhe se kapaciteti i strehëzave ekzistuese shpeshherë është i vogël.

Ekspertët dhe gratë që morën pjesë në sondazhin cilësor, po ashtu, e komentuan qëndrueshmërinë e strehëzave për gra, meqë ato kryesisht financohen me donacione dhe madje nuk do të jenë të qëndrueshme në afat të gjatë. Ekspertët konsiderojnë se strehëzat duhet të financohen nga organizata siç është OSBE dhe KB, me qëllim që këto shërbime të sigurohen në mënyrë konsistente.

Gratë e anketuara, veç tjerash, identifikuan një numër të madh të pengesave shitesë për qasje deri te strehëzat, pengesa këto të cilat duhet të shmangen. Ato e përfshijnë sigurimin e hyrje-daljes deri te strehëzat në çdo kohë, konfidencialitetin për lokacionin e strehëzave dhe përmirësimin e kohëzgjatjes dhe shtrirjes së shërbimeve në mënyrë që të rritet probabiliteti që gruaja ta braktis partnerin i cili ka ushtruar dhunë ndaj saj.

Komiteti i CEDAW rekomandoi të rritet numri i strehëzave në të gjitha zonat gjeografike dhe gratë të kenë qasje në shërbime konsulente, rehabilitim, mbështetje shëndetësore dhe psikologjike.

3) Nevoja për mbështetje më të madhe dhe veprim të fokusuar për ndihmë të grave nga grupet e pakicave dhe nga zonat rurale

Pikëpamjet dhe normat gjinore, të përcaktuara tek gratë shqiptare dhe rome, janë më tradicionale në krahasim me popullatën e përgjithshme. Për shembull, 57% e grave të cilat flasin shqip ishin të mendimit se miqtë e tyre do të pajtohen se bashkëshortja e mirë i nënshtrohet bashkëshortit, madje edhe atëherë kur ajo nuk pajtohet me atë (në krahasim me 37% në përgjithësi), ndërkaq, gjasat janë më të mëdha që të mos pajtohen se dikush tjetër jashtë familjes duhet të ndërhyjë në raste të dhunës (53% mesatarisht nga 29%). Për atë se dhuna në familje është çështje private, ky është një qëndrim i cili më shpesh haset tek gratë të cilat flasin në gjuhën shqipe (67%) sesa tek gratë të cilat flasin në gjuhën maqedonase (42%). Gratë rome, të cilat morën pjesë në sondazhin cilësor, deklaruan se shumica e formave të dhunës janë pjesë e jetës së tyre të përditshme. Pranimi më i gjerë i dhunës ndaj grave në këto komunitete dhe trajtimi i dhunës si çështje private mund t'i pengojnë këto grupe të grave të referohen dhe ta pranojnë ndihmën. Nga ana tjetër, ato gjithnjë e më shumë janë të ekspozuara në rrezik për shkak të qëndrimeve ndaj dhënësve të shërbimeve. Gratë, të cilat morën pjesë në sondazhin cilësor, po ashtu shprehën bindje se, gratë të cilat jetojnë në mjedise rurale, dhe/ose nuk punojnë dhe në këtë mënyrë nuk janë të pavarura nga aspekti financiar, janë më të ekspozuara ndaj rrezikut për shkak të distancës ose largësisë së tyre nga shërbimet për mbështetje. Këto gra me gjasë nuk do të kenë mundësi t'i kërkojnë shërbimet për mbështetje që do t'u nevojiteshin.

Komiteti i CEDAW veçanërisht e theksoi pozitën e vështirë të pjesëtareve të pakicave dhe kërkoi nga shteti të ndër marrë masa të përkohshme dhe të përhershme, në mënyrë që të sigurohet arsimi, punësimi, strehimi dhe qasja deri te shërbimet shëndetësore për gratë rome, si dhe të promovojë tolerancë dhe pjesëmarrje të barabartë të romeve në jetën publike. Veçanërisht, rekomandohet zgjidhja e formave të kryqëzuara të diskriminimit me të cilat ballafaqohen gratë rome, pakicat e tjera, gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë nga mjediset rurale.

Rekomandime:

Gjetjet e lartpërmendura të sondazhit i vënë në dukje rekomandimet e mëtutjeshme konkrete për zgjidhjen e dhunës ndaj grave:

Monitorimi i legjislacionit dhe harmonizimi i tij me Konventën e Stambollit Për parlamentin dhe Qeverinë:

1. Të silllet një ligj i ri për dhunën me bazë gjinore në pajtim me standardet e Konventës të Stambollit,
2. Të ndryshohen ligjet përkatëse (e drejta familjare, ligji për polici, ligji për mbrojtje shëndetësore) që të përshtaten me dispozitat e Ligjit të ri për dhunë me bazë gjinore, pasi të silllet,
3. Të ndryshohet Kodi Penal për ndjekjen e përdhunimit martesor *ex-officio*. Të analizohet nëse të gjitha dispozitat e tjera në Kodin Penal janë të harmonizuara me standardet e Konventës të Stambollit,
4. Të përfshihen të dhëna nga sondazhi i zbatuar nga OSBE në Plan Veprimin Nacional për zbatimin e Konventës së Stambollit,
5. Të krijohet një pozitë e veçantë në institucionet që do t'i dedikohet çështjeve që kanë të bëjnë me dhunën me bazë gjinore;

Bashkëpunimi, trajnimi dhe qasja shumësektoriale Për Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale

6. Të sigurohet bashkërenditje midis dhënësve të shërbimeve dhe integrim i shërbimeve në sistemin e bashkëpunimit me më shumë faktorë,
7. Të organizohen trajnime dhe aktivitete për ndërgjegjësim për punonjësit social, në mënyrë që t'u ndihmojnë që t'i ndryshojnë pikëpamjet e tyre dhe sjelljen sa i përket dhunës ndaj grave, si dhe të sigurohet mbështetje profesionale për të mbijetuarat;

Për Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme

8. Të realizohet trajnim i vazhdueshëm, afatgjatë dhe i qëndrueshëm për dhunën gjinore për dhënësit e shërbimeve, përfshirë këtu edhe trajnim për shkaqet e dhunës me bazë gjinore ndaj grave, ndërtim të kapaciteteve, trajnim të llojit "peer-to-peer" dhe trajnim për aftësi të buta (gjyqësor, zyra e Prokurorit Publik, gjyqtarë, avokatë, bashkë me punëtorët socialë, punonjësit shëndetësorë dhe policinë),
9. Të sigurohet trajnim sistematik për Ligjin e ri për dhunën gjinore dhe për ligje të tjerë të ndërlidhura, si dhe ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Penal që duhet të miratohen në vitin 2019,
10. Të mendojnë t'i drejtohen OSBE-së për mbështetje më të madhe për trajnimin dhe ndërgjegjësimin e gjyqësorit dhe efektivëve policorë:

Shërbime të specializuara për gra, duke i përfshirë këtu edhe grupet e grave të pafavorizuara dhe aktivitetet për ndërgjegjësim

Për Qeverinë dhe Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale në bashkëpunim me organizatat joqeveritare

11. Të sigurohen mjete financiare buxhetore të rregullta dhe të mjaftueshme për strehëzat e grave,
12. Të sigurohet cilësi, konsistencë dhe qasje në shërbimet në strehëzat e grave,
13. Të sigurohet ndihmë financiare dhe mbështetje afatgjatë, paraqitje në Agjencinë e Punësimit dhe strehim për të mbijetuarat nga DHNG dhe për fëmijët e tyre;
14. Të sigurohen shërbime relevante për grupet e pafavorizuara të grave, duke i përfshirë edhe gratë e pakicave,
15. Të zbatohet fushatë për ndërgjegjësim sa i përket dhunës ndaj grave, shkaqeve dhe pasojave dhe mbështetjes në dispozicion,
16. Të realizohet fushata në nivel lokal për përhapjen e informacioneve midis grupeve të pafavorizuara të grave dhe të komuniteteve të tyre lidhur me atë se si të parandalohet dhuna dhe ku të kërkohet ndihmë. Këto fushata duhet t'i përshtaten grupit të synuar dhe të përfshijnë organizim të tryezave lokale, diskutime për grupe të vogla dhe punëtori tematike për zejtarë dhe aktivitete sociale. Këshillat lokale për parandalim (grupe konsulente të qytetarëve) duhet të përfshihen në aktivitetet për ndërgjegjësim dhe për aktivitete arsimore, të cilat duhet t'i drejtojnë liderët e bashkësisë lokale dhe të OJQ-ve lokale:

Për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

17. Të zbatohen programe arsimore në shkolla dhe institucione parashkollore për stereotipet gjinore dhe për marrëdhënie të shëndetshme, me fokus mbi barazinë gjinore.



Anekse

Aneksi 1: Sondazhi dhe puna cilësore në terren

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) kërkoi nga Ipsos të zbatojë anketë cilësore dhe sasiore për dhunën ndaj grave në shtatë vende-anëtare⁶¹ të OSBE dhe në Kosovë.⁶² Ky është sondazhi i parë krahasues i këtij lloji në këtë fushë dhe qëllimi është të shfrytëzohet për përmirësimin e krijimit të politikave në të ardhmen nga ana e palëve të interesuara nacionale dhe ndërkombëtare, të cilat punojnë në zbatimin e politikave dhe programeve në rajon. Ky raport i prezanton gjetjet për Maqedoninë e Veriut.

Pyetjet kryesore të sondazhit të projektit janë si vijon:

- Në çfarë niveli është shkalla e dhunës të cilën e përjetojnë gratë në situata konflikti dhe jo-konflikti?
- Cilave forma të dhunës u janë ekspozuar gratë në situata konflikti dhe jo-konflikti?
- Kush janë autorët e dhunës ndaj grave në situata konflikti dhe jo-konflikti?
- Cilat janë pasojat nga dhuna?
- A i denoncojnë gratë përvojat e tyre në polici ose në organe apo organizata të tjera?
- A ekzistojnë dallime midis pasojave të grave varësisht nga mosha, arsimi, statusi profesional, a kanë përjetuar ato konflikt ose a mund të përcaktohen si persona të zhvendosur të brendshëm ose si migrantë?
- Cilat janë qëndrimet shoqërore ndaj DHNG dhe DHNG në situata konflikti?

61 Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Moldavia dhe Ukraina.

62 Çdo përmendje e Kosovës, pavarësisht nëse ka të bëjë me territorin, institucionet apo popullatën, në këtë tekst duhet të kuptohet në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit për Siguri të Kombeve të Bashkuara.

Sondazhi i përfshin këto elemente:

- Anketë sasiore midis mostrës reprezentativ nga 1.910 gra në moshë prej 18 deri 74 vjeçare e cila u realizua nga 2 prilli deri më 1 gusht të vitit 2018.
- U shfrytëzua dizajni i mostrës të rastit shumë fazësh, i stratifikuar. Korniza e mostrës, lista e territoreve të vendeve zgjedhore nga viti 2016, u siguroa nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Maqedonisë së Veriut. Me këtë u siguroa mbulim prej 99%. Korniza e mostrës i përfshin të gjitha njësitë në Maqedoninë e Veriut. Për shkak të aspektit praktik të punës në terren, njësitë për marrjen e mostrave primare (NjMMP) me më pak se 70 votues u përjashtuan nga zgjedhja, për shkak të distancës dhe izolimit të tyre. Ata mbulojnë 1% të popullatës.
- Korniza e mostrës u stratifikua sipas rajonit dhe madhësisë së sipërfaqes së banimit. Pastaj, NjMMP u zgjedhën në kuadër të çdo stratumi me probabilitet proporcional me madhësinë. Gjithsej u zgjedhën 175 NjMMP, ndërsa në kuadër të çdo modeli të NjMMP u përzgjedh numër i selektuar i adresave në mënyrë që të realizohen 10 intervista në kuadër të secilës NjMMP. Adresat u zgjedhën përmes qasjes “shëtitje e rastësishme” (random walk) njëkohësisht me realizimin e intervistave. Kur në adresën e përzgjedhur u gjendën më shumë se një familje, familja u përzgjedh sipas zgjedhjes së rastësishme, përmes shfrytëzimit të listës elektronike për kontakt. Në çdo familje të zgjedhur, u përzgjedh një grua që të anketohet. E anketuara u përzgjedh sipas zgjedhjes së rastësishme nga lista e grave që i përmbushnin kushtet e anketës në familjen e zgjedhur, përkatësisht të gjitha gratë në moshë prej 18 deri 74 vjeçare ishin listuar sipas moshës në listën elektronike të kontaktit. Atëherë, lista e kontaktit, sipas zgjedhjes së rastësishme zgjedhi një grua me ndihmën e gjeneratorit të zgjedhjes së rastësishme.
- Intervistat u realizuan kokë-më-kokë nga punonjëse gra të trajnuara në mënyrë speciale për në terren (shih: Aneksin 2 në vijim për më shumë detaje rreth trajnimit dhe protokolleve).
- Shkalla e përgjigjes ishte 49%, ndërsa pranueshmëria mesatare e vërtetë ishte 91%. Rëndësia u përlllogarit në dy faza A) pesha e dizajnit për marrjen e mostrave dhe B) pesha e stratifikimit. Pesha e dizajnit e reflektoi probabilitetin për zgjedhjen e të anketuarve, ndërsa testet për post-stratifikimin u përlllogaritën në mënyrë që të kompensohen pyetjet e papërgjigjura. Rajoni, niveli i urbanizimit dhe grupmoshat u shfrytëzuan për post-stratifikim.
- Për shkak të dallimeve të metodologjisë, mostrës dhe pyetësorit, rezultatet e këtij sondazhi nuk do të jenë drejtpërdrejt të krahasueshme me sondazhet e tjera nacionale të zbatuara në Maqedoninë e Veriut.
- Nëntë diskutime në fokus grupe (FG), përfshirë këtu edhe grupe me gra të grupeve etnike minoritare dhe gra me përvojë konflikti, që u mbajtën nga data 12 deri në 22 qershor të vitit 2018.

Tabela A1.1: Përbërja e fokus grupeve

FG	Vendi	Numri i pjesëmarrësve	Grupmosha	Përkatësia etnike	Numri i grave të ndikuara nga konflikti	Numri me fëmijë	Numri i të punësuarave
1	Shkup	8	35-54	maqedonase	3	8	6
2	Manastir	8	35-54	maqedonase	0	8	6
3	Shtip	8	18-34	maqedonase	0	3	5
4	Shkup	8	18-34	maqedonase	1	3	3
5	Shkup	8	20-45	rome	0	7	4
6	Shkup	8	20-45	rome	0	5	2
7	Tetovë	8	35-54	shqiptare	7	8	6
8	Tetovë	8	18-34	shqiptare	3	2	4
9	Shkup	8	35-54	maqedonase	3	8	6

Sondazhi i drejtuar nga OSBE për dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut

- Katër intervista të thelluara me të mbijetuarat nga dhuna, përfshirë këtu edhe një grua me aftësi të kufizuar në gusht – shtator të vitit 2018.

Tabela A1.2: Profili i pjesëmarrësve në intervistën e detajuar

ID	Grupmosha	Statusi i punës	Ka fëmijë	Gjendja mjekësore / me aftësi të kufizuar
1	55+	E punësuar	Po	Jo
2	55+	Punon si pastruese në familje (zyrtarisht e papunësuar)	Po	Po
3	18–34	E punësuar	Jo	Jo
4	18–34	E papunësuar	Po	Jo

- Pesë intervista me ekspertët kryesorë të cilat u dizajnuan që të sigurojnë pasqyrë të pyetjeve që kanë të bëjnë me dhunën dhe dhunën në lidhje me konflikte të cilat u realizuan në qershor-korrik të vitit 2017 pastaj edhe një rreth prej 11 intervistave me ekspert kryesorë të cilat u realizuan në qershor-gusht të vitit 2018 që të hulumtohen ndryshimet e rrethit të parë dhe të sigurohen rekomandime për OSBE.

Anketa u dizajnuar që të jetë reprezentative në nivel nacional për gratë në Maqedoninë e Veriut në moshë prej 18 deri 74 vjeçare. Ndarja sipas të dhënave demografike është pasqyruar në vijim.

Tabela A1.3: Profili i ponderuar dhe jo i ponderuar i mostrës

Mosha	Të ponderuara %	Të paponduara%	Të paponduara n
18-29	21	13	254
30-39	20	17	326
40-49	19	19	360
50-59	18	24	460
60+	21	27	510
Statusi i punës			
Me punë të paguar	32	30	564
E vetëpunësuar	4	3	64
Ndihmon në biznesin familjar (e papaguar)	2	2	34
E papunësuar	23	21	408
Nxënëse, studente, në trajnim	5	3	52
Nuk punon për shkak të sëmundjes ose aftësisë së kufizuar	0	1	11
Kryen obligime shtëpiake dhe kujdeset për anëtarët e familjes	20	23	440
Pensioniste	13	17	330
Obligimi i detyrueshëm ushtarak/punë e dobishme shoqërore/ tjetër	0.4	0.4	7
Arsimi			
Nuk ka arsim formal	8	9	171
Arsim fillor	23	25	486
Arsim i mesëm	51	49	927
Arsim i lartë	19	17	326
Vendbanimi			
Mjedisi urban	63	58	1,117
Mjedisi rural	37	42	793
Të prekura nga konflikti			
Po	19	19	364
Jo	81	81	1,910

Toleranca gjatë marrjes së mostrave

Meqë të dhënat bazohen në mostrën, dhe jo në popullatën e përgjithshme, ndërsa përqindja e rezultateve (ose vlerësimeve) janë objekt i tolerancës gjatë marrjes së mostrave, jo të gjitha dallimet ndërmjet rezultateve janë të rëndësishme nga aspekti statistikor në nivel të besimit prej 95%. Kur përlogariten intervale të besimit, duhet të merret parasysh madhësia efektive e mostrës.

Madhësia efektive e mostrës (ose efekti i dizajnit, koncept i ndërlidhur) është ndërlidhur me vlerësimet individuale dhe për këtë shkak ka dallime në vlerësimet. Që të përlogariten efektet e dizajnit për madhësinë e përgjithshme të mostrës u përdor formula e cila bazohej në proporcionin si vijon:

Efekti i dizajnit = (madhësia e paponderuar e mostrës) * (shuma e peshave katrore) / (katrori nga shuma e peshave)⁶³

